



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3338/7 prot.

Datë 28.01.2025

V E N D I M
Nr. 145/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 28.01.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes, për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Victoria - Al” SHPK, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-28211-11-05-2024, me objekt Loti 1 “*Uniformë zjarrduruese*”, me fond limit 27,880,050 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 06.12.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.

Vazhdimin me shqyrtimin në themel, të pjesës tjetër të ankesës.

Modifikimin e dokumenteve të procedurës së mësipërme të prokurimit.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Victoria - Al” SHPK me NIPT (K81531041T) dhe adresë: Rruga “Muhamet Gjollësja”, Pallati 58, Shkalla 1, Ap.3, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Tiranë, me adresë: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 06.11.2024, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-28211-11-05-2024, me objekt Loti 1 “*Uniformë zjarrduruese*”, me fond limit 27,880,050 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 06.12.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.

II.2. Në datën 12.11.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si edhe pranë autoritetit kontraktor, është administruar ankimi elektronik me nr. A2024/4781, dhe nr. 3338/2024 prot., datë 13.11.2024, i operatorit ekonomik “Victoria AL” SHPK, me anë të së cilit kërkohet modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi. Konkretisht operatori ekonomik ankimues pretendon:

1. NE shtojcen 8, Kriteret e Vecanta per Kualifikim, pika 2.4.2 nga ana e Autoritetit Kontraktor eshte kerkuar ideshmi per rezultatet e testimeve zyrtare (raporte testimi), te leshuara nga institucione te autorizuar, qe vertetojne pajtueshmerine e produkteve me specifikimet teknike, te materialeve perberese te produkteve te uniformes zjarrduruese te personelit operues (zjarrfikes), perkatesisht uniformes mbrojtese nga zjarri (xhaketa dhe pantallonat) + kapuái mbrojtjes per zjarrfikesin + Dorezat per mbrojtje nga zjarri.

(Raporte testimi per copen e perdorur per artikullin moster, lendes se pare qe shoqeron ate dhe ajo qe i bashkengjitet flete-analizes duhet te jene detyrimisht te njejta).

NE argumentimin e dhene nga Autoriteti Kontraktor deklarohet se kjo kerkese eshte vendosur sipas percaktimit te bere ne mbeshtetje te VKM-se Nr. 285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te Prokurimit publik, i ndryshuar, neni 40, pika 6, germa c) ku cilesohet se: Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kerkoje operatoreve ekonomike te dorezojne deshmi, qe tregojne se ata i plotesojne kerkesat minimale, te percaktuara ne dokumentet e tenderit, si:

C) deshmi per rezultatet e testimeve zyrtare, te leshuara nga institucione te autorizuar, qe vertetojne pajtueshmerine e produkteve me specifikimet teknike.

Paraprakisht, duhet theksuar se gjendemi perpara nje procedure prokurimi mallrash me nje specifike te vecante, per te cilen VKM Nr. 1153, date 24.12.2020 i per miratimin e uniformes, shenjave dalluese perkatese, Flamurit dhe stemes se sherbimit te mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimi percakton qartazi cilat jane elementet/produktet e uniformes Zjarrduruese, cilat duhet te jene specifikimet teknike si dhe normat e standartet perkatese nderkombetare per secilin element te uniformes zjarrduruese.

Referuar VKM-se produktet perberese te uniformes Zjarrduruese jane:

- 1. UNIFORMA MBROJTESE NGA ZJARRI (XHAKETA & PANTALLONAT)*
- 2. DOREZAT PER MBROJTJE NGA ZJARRI*
- 3. KAPUCI MBROJTJES PER ZJARRFIKESIN*
- 4. HELMETA PER ZJARRFIKES & SISTEMI PER NDRICIM*

5. CIZMET MBROJTESE NGA ZJARRI

Nga ana e Autoritetit Kontraktor, kërkesa për paraqitjen e raporteve të testimi rezultojnë e paqarte pasi fillimisht kerkohen raporte testimi të materialeve perberese të produkteve të uniformes zjarrrdurese por nga ana tjetër përcakton vetëm 3 nga 5 produktet e uniformes, konkretisht uniformen mbrojtëse nga zjarri (xhaketa dhe pantallonat) + kapuë mbrojtëse për zjarrfikësin + Dorezat për mbrojtje nga zjarri. Po nga Autoriteti kontraktor deklarohet se: Raporte testimi për copën e përdorur për artikullin mostër, lëndës së parë që shoqëron atë dhe ajo që i bashkëngjitet fletë-analizës duhet të jenë detyruesisht të njëjta.

Fillimisht, referuar VKM Nr. 1153, datë 24.12.2020, konkretisht për uniformën mbrojtëse nga zjarri (xhaketa dhe pantallona) e cila përben vetëm njërin nga elementet e uniformes zjarrrdurese (numri rendor 1) termi i përdorur nga AK “Raporte testimi për copën nuk është i saktë, pasi sic cilesohet në VKM materialet perberese të uniformes përfaqësojnë shtresën e jashtme, materialin për pengimin e depërimit të fluideve, materialin barts për saldimin e qepjeve, astarin, Pengesat absorbuese. Sa më sipër, termi i përdorur nga AK “copën” nuk gjendet në asnjë rresht të VKM-së për produktin uniforme mbrojtëse nga zjarri (xhaketa dhe pantallona). Nga ana tjetër, Uniforma mbrojtëse nga zjarri (xhaketa dhe pantallona), përveç shtresave, përmbajnë materiale të ndryshme si: mbrojtëset (mbushjet ose jasteket mbrojtëse) si dhe aksesoret për qepje, rripa, perforcues, zinxhirë, Shiritat velcro për mberthyerje (mbyllje) etj

NE rastin konkret gjendemi përpara një kriteri të paqarte dhe diskriminues në momentin e interpretimit nga ana e një operatori ekonomik i cili kërkon të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi.

NE nenin 2 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 për prokurimin publikë përcaktohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është c) të nxirret pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; d) të nxirret konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; e) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jo-diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; f) të ndalojë që në nenin 3 (Parimet ligjore) citohet në mënyrë të drejtpërdrejtë se: e) Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jo-diskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar?”

Paqartësia në hartimin e këtij kriteri për kualifikim themelor, ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në paraqitjen e një oferte të rregullt, transparente dhe proporcionale nga ana e operatorëve ekonomikë, duke krijuar në këtë mënyrë ngushtim artificial të konkurrencës midis operatorëve ekonomikë në shkëlqje haptazi të parimeve bazë të përcaktuara në nenin 3 të LPP.

Paqartësia e shprehur në këtë kriter kualifikues bie ndesh në mënyrë të drejtpërdrejtë me përcaktimet ligjore të parashikuara në nenin 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 për prokurimin publikë, dhe konkretisht, theksojmë se Autoriteti Kontraktor nuk duhet të shmangë ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është

ngushtuar artificialisht kur prokurimi pergatitet me qellimin per te favorizuar ose demtuar ne menyre te padrejte operatore ekonomike te caktuar.

Paraprakisht, sikurse kemi informuar me heret njeherazi edhe AK-ne edhe KPP-ne ne ankesat tona te perseritura te cilat lidhen me objektin e kesaj procedure, te gjitha elementet/produktet e Uniformes Zjarrduruese prodhohen jashte vendit tone. Ato certifikohen konform normave dhe standarteve te miratuara nderkombetare.

NE VKM Nr. 1153, date 24.12.2020 "Per miratimin e uniformes, shenjave dalluese perkatese, Flamurit dhe stemes se sherbimit te mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimie percaktohet shprehimisht:

1. UNIFORMA MBROJTESE NGA ZJARRI (XHAKETA & PANTALLONAT)

Xhaketa dhe pantallonat per mbrojtje nga zjarri, duhet te jene te punuara dhe te certifikuara ne perputhje me standardin EN 469:2005, niveli 2 i mbrojtjes.

Perverc kesaj, xhaketa per mbrojtje nga zjarri duhet te plotesoje edhe standardin EN 469:2005, Shtojca B.

Prodhuesit ose subjekti qe i trajton keto produkte eshte i detyruar te paraqese certifikatat e vlefshme te produktit.

2. DOREZAT PER MBROJTJE NGA ZJARRI

Duhet te jene te certifikuara ne harmoni me standardet: EN 659:2003

3. KAPUCI MBROJTES PER ZJARRFIKESIN

Kapuci mbrojtjes duhet te jete i certifikuar ne harmoni me standardet EN13911:2005 & EN 11493

4. HELMETA PER ZJARRFIKES & SISTEMI PER NDRI«IM

Helmata per perdorim nga zjarrfikesit per mbrojtje kunder zjarrit e gjate nderhyrjeve operuese duhet te jete ne perputhje me standardet nderkombetare EN 443:2008 dhe EN 14458.

5. «IZMET MBROJTESE NGA ZJARRI

Duhet te jene te certifikuara sipas standardeve EN ISO 15090:2012 F2A HI3 P T CI AN SRC EN ISO.

Gjate shqyrtimit te kriterave te vecanta per kualifikim rezulton se sipas pikes 2.4.4 eshte kerkuar paraqitja e certifikatave konform standarteve perkatese te specifikuara ne pikat 1,2,3,4,5 te elementeve te Uniformave Zjarrduruese te percaktuara, si Aertifikata te detyrueshme ne VKM Nr. 1153, date 24.12.2020 iper miratimin e uniformes, shenjave dalluese perkatese, Flamurit dhe stemes se sherbimit te mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimie.

Pajisja e produkteve me Certifikatat perkatese kryhet mbeshtetur ne testimin e produkteve dhe materialeve per prodhimin e tyre sipas perkatesise standardeve/specifikimeve teknike dhe ekzaminimin e dokumentacionit te dosjes teknike per cdo produkt. Pra certifikata e vlefshme e produktit konform standarteve te percaktuara ne VKM eshte dokumenti permbledhes dhe shterues i cili verteton pajtueshmerine e produkteve me specifikimet teknike.

Pra kerkesa e AK-se per raporte testimi vetem per 3 nga elementet e uniformes zjarrduruese, perkatesisht uniformes mbrojtese nga zjarri (xhaketa dhe pantallonat) + kapuci mbrojtjes per zjarrfikesin + Dorezat per mbrojtje nga zjarrie rezulton si kerkese jo e plote pasi Uniforma zjarrduruese perbehet nga 5 elementet e mesiperme sipas pikave 1,2,3,4,5. Nga ana tjeter kerkesa

per raporte testimi rezulton e publikuar nga ana e Autoritetit kontraktor pasi paraqitja e Certifikatave te ketyre produkteve (sipas pikes 2.4.4) eshte dokumenti final i cili verteton pajtueshmerine e produkteve me specifikimet teknike.

Mbeshtetur ne VKM Nr. 1153, date 24.12.2020 i per miratimin e uniformes, shenjave dalluese perkatese, Flamurit dhe stemes se sherbimit te mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimie dhe sa mesiper kerkohet sakesimi dhe modifikimi i ketij kriteri kualifikues.

2. NE shtojcen 6, SPECIFIKIMET TEKNIKE: LOTI 1: i uniforma zjarrduruese, ne lidhje me produktin cizme mbrojtese nga Zjarri rezulton se: eshte kerkuar qe cizmet duhet te jene te prodhuara nga materiali lekure e zeze me kualitet te larte, nderkohe qe ne listimin fillestar te produkteve te dhene nga Autoriteti Kontraktor rezulton qe ngjyra e «izmeve Zjarrduruese te jete Ngjyra Blu.

Per pasoje kemi nje mosperputhje midis ngjyres se Cizmeve Zjarrduruese te dhene ne listen fillestare te Specifikimeve Teknike nga Autoriteti Kontraktor dhe ngjyres te po ketyre Cizmeve te dhene ne parashtrimin e specifikimeve teknike qe duhet te permbajne keto te fundit.

Per pasoje kjo diference midis ngjyres se Cizmeve Zjarrduruese, te hartuar ne specifikimet teknike krijon konfuzion dhe mund te coje ne paraqitjen e nje oferte dhe te nje mostre te gabuar ne lidhje me kete produkt. Nga ana tjeter, kjo mosperputhje e ngjyres eshte penalizuese per operatoret ekonomike pasi referuar kerkesave per kualifikim, konkretisht pika 2.4.7 operatoret ekonomik ofertues, duhet te paraqese te paketuara dhe te protokolluara mostra per te gjithë artikujt objekt prokurimi, si me poshte:

A) nga nje moster fizike per objektet e uniformes (produkt te gatshem) qe do te prokurohenqe perfshin te gjitha detajet, llojin e materialit dhe pjeseve perberese te tyre, punimin dhe permasat e caktuara ne specifikimet teknike. Mungesa e mostres dhe e lendes se pare qe shoqeron ato eshte kusht i kualifikues.

Pra, Autoriteti Kontraktor ne hartimin e specifikimeve teknike krijon konfuzion ne kundershim me sa parashikuar ne nenin 2 te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 i per prokurimin publike percaktohet

Shprehimisht se: i qellim i ketij ligji eshte c) te nxise pjesemarrjen e operatoreve ekonomike ne procedurat e prokurimit publik; d) te nxise konkurrencen ndermjet operatoreve ekonomike; d) te

Siguroje nje trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per te gjithë operatoret ekonomike, pjesemarrjes ne procedurat e prokurimit publik?E, nderkohe qe ne nenin 3 (Parimet ligjore) citohet ne menyre te drejteperdrejte se: e) Autoritetet dhe entet kontraktore garantojne trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per operatoret ekonomike, si dhe veprojne me transparence e ne menyre proporcionale. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet te shmangin fushen e zbatimit te keti ligji ose te ngushtojne ne menyre artificiale konkurrencen. Konkurrenca konsiderohet se eshte ngushtuar artificialisht kur prokurimi pergatitet me qellimin per te favorizuar ose demtuar ne menyre te padrejte operatore ekonomike te caktuar?E

Theksojme gjithashtu se ne 36 te LPP-se citohet shprehimisht se: 2. Specifikimet teknike duhet te mundesojne trajtim te barabarte per te gjitha kandidatet dhe ofertuesit dhe te mos sherbejne si pengesa per konkurrencen e hapur ne prokurimin publik. 3. Specifikimet teknike duhet te pershkruajne qarte kerkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar: a) kerkesave funksionale ose te performances, perfshire karakteristikat mjedisore, me kusht qe parametrat te jene te sakte ne menyre qe t'u japin mundesi ofertuesve te percaktojne objektin e kontrates dhe autoriteteve ose enteve kontraktore te japin kontraten?E

Mbeshtetur ne sa mesiper kerkohet sakesimi dhe modifikimi i shtojces 6 ne lidhje me produktin Cizme Zjarrduruese, konkretisht duke dhene nje specifikim te qarte dhe te njetrajtshem ne lidhje Me ngjyren e cizmeve Zjarrduruese.

3. NE shtojcen 8, Kriteret e Vecanta per Kualifikim, pika 2.4.3 nga ana e Autoritetit Kontraktor eshte kerkuar qe Operatori ekonomik duhet te paraqese autorizim/et e prodhues/ve ose distributor/ve te autorizuar (ne kete rast duhet te provohet lidhja midis prodhuesit dhe distributorit nepermjet nje autorizimi mes tyre) per te gjitha mallrat objekt prokurimi per te cilat nuk eshte vete prodhues. Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit dhe/ose distributorit te autorizuar si: telefon, fax, email, ẽbsite, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.

Operatori ekonomik duhet te paraqese nje deklarate ku te deklaroje prodhuesit e te gjitha mallrave objekt prokurimi me te dhenat e kontaktit.

Nga ana e Autoritetit Kontraktor ne argumentimin e ketij kriteri per kualifikim deklarohet se: Ky kriter eshte vendosur ne perputhje me piken 4, te nenit 77 te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 ẽper prokurimin publike dhe piken 8, te nenit 40, te VKM Nr. 285, date 19.05.2021 ẽper miratimin e rregullave te prokurimit publike. Autorizimi i prodhuesit eshte nje dokument i rendesishem, pasi pervecse tregon origjinen e mallrave qe kerkohen ne procedure, na garanton se ofertuesi eshte i Autorizuar per ofrimin tek AK te ketyre mallrave. Autoriteti kontraktor, duke qene se eshte perfituesi direkt i kontrates objekt prokurimi, eshte ne te drejten e tij te garantohet per besueshmerine, cilesine dhe kapacitetet e operatoreve ekonomike ofertues. NE kete kontekst, eshte domosdoshmerisht ne dobi te perfituesve finale dhe produkteve/sherbimeve me cilesore, pra garanci per zbatimin me rigorozitet te furnizimit te mallit. NE kete menyre provohet dhe aftesia reale e operatorit ekonomik per te realizuar kontraten ne cilesi, sasi e kohe. Kjo garanci lidhet njekohesisht edhe me treguesit cilesore te mallrave qe kerkohen te blihen e qe jane prodhuar ne Standardet apo prodhues te zyrtarizuar?..

Sikurse kemi theksuar dhe me siper, te gjitha produktet e parashikuara ne Lotin I, pjese perberese e uniformes zjarrduruese, prodhohen jashte shqiperise ne perputhje me specifikimet teknike te hartuara nga Autoriteti Kontraktor. Ato testohen dhe ẽertifikohen konform normave dhe standarteve te miratuara nderkombetare. Duhet theksuar se gjendemi perpara nje procedure prokurimi mallrash me nje specifike te vecante, te percaktuara me VKM dhe sigurimi i tyre kryhet nepermjet importit duke marre parasysh specifikun e vecante te produkteve te kerkuara. Sqarojme se ne mometin e hartimit te ketij kriteri per kualifikim nga ana e Autoritetit Kontraktor

duhet te kerkohet gjithashtu Katalog ose skede Teknike e modelit konkret qe ofrohet per cdo produkt, pasi i njejti prodhues mund te prodhoje modele te ndryshme te produkteve qe kerkohen, me karakteristika te ndryshme dhe me certifikime te ndryshme. Sa me siper paraqitja e Katalogut ose skeda teknike te prodhuesit eshte nje element thelbesor ku tregohen karakteristikat teknike te produkteve te ofruara, te cilat duhet te permbushin plotesisht specifikimet teknike te kerkuara nga autoriteti kontraktor dhe te ofruara nga operatori ekonomik. Nje kerkese saktesisht e tille eshte parashikuar nga i njejti AK edhe ne proceduren e prokurimit me objekt iblerje AUTOMJETE Zjarrfikese Nr. REF-13327-07-16-2024 zhvilluar me 16/08/2024.

Sa me siper, lidhur me kerkesen per paraqitjen e deklarates me te dhenat e prodhuesve, duhet te cilesohet perkatesisht modeli produktit qe do te ofrohet si dhe origjina e tij.

Duke qene se keto produkte, sic kemi deklaruar, importohen te gatshe nga jashte shqiperise ne Perputhje me specifikimet teknike, nga ana e Autoriteti Kontraktor duhet te specifikohet si element shtese ne piken 2.4.3 edhe paraqitja e Skedave Teknike si dhe deklarimi i origjines si element thelbesor ne vleresimin e ofertave te paraqitura nga operatoret ekonomike ofertues ne Lotin I te kesaj procedure prokurimi.

4. NE shtojcen 8, Kriteret e Vecanta per Kualifikim pika 2.4.5 nga Autoriteti kontraktor eshte parashikuar si vijon: Operatori ekonomik per te asistuar stafin e AK gjate procesit te prodhimit/ qepjeve/ permasave apo modifikimeve per realizimin e uniformes se punonjesit te sherbimit zjarrfikes, duhet te kete ne stafin e tij, jo me pak se 10 (dhjete) punonjes per 3 muajt e fundit?.

Paraprakisht duhet vene ne pah se ne argumentimin e dhene nga Autoriteti kontraktor ne lidhje me numrin e punonjesve deklarohet se:

Operatori ekonomik per te asistuar stafin e AK gjate procesit te prodhimit/ qepjeve/ permasave apo modifikimeve per realizimin e uniformes se punonjesit te sherbimit zjarrfikes, duhet te kete ne stafin e tij:

Per Lotin 1: jo me pak se 10 (dhjete) punonjes per 3 muajt e fundit

Per Lotin 1: jo me pak se 5 (pese) punonjes per 3 muajt e fundit

Nga ana e Autoritetit Kontraktor, ne argumentimin e dhene kerkohet ne menyre te perseritur per Lotin 1 nje here 10 punonjes dhe heren e dyte 5 punonjes. Kjo con menjehere ne nje konfuzion tek operatoret ekonomike pjesemarres te cilet do t'i referohen argumentimit te autoritetit kontraktor si element thelbesor per te verifikuar nese keto kriteret jane hartur ne mbeshtetje me legjislacionin per prokurimin publik. Konkretisht ne neni 2 te LPP-se citohet shprehimisht se Autoriteti Kontraktor duhet: dh) te siguroje integritet, besim publik dhe transparence ne procedurat e prokurimit publik. Mbeshtetur ne deklarimin e numrit te punonjesve ne argumentimin e kriterëve te vecanta per kualifikim nga ana e autoritetit kontraktor gjendemi perpara nje suate konfuze dhe te paqarte e cila do te krijonte paqartesi ne operatoret ekonomike pjesemarres ne lidhje me numrin e punonjesve te kerkuar ne kete procedure prokurimi, ne momentin kur do te lexohen argumentimet e dhena nga Autoriteti Kontraktor ne mbeshtetje te kriterit te vecante per kualifikim pika 2.4.5.

NE vijim te ketij argumentimi nga Autoriteti Kontraktor deklarohet se: kerkesa eshte hartuar ne perputhje me VKM nr. 285, date 19.05.2021 per miratimin e rregullave te prokurimit publik, Neni 40 kerkesa te vecanta per kontratat e mallrave, pika 5 i per te provuar pershtatshmerine per te kryer veprimtarine profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor

Kerkon: C) fuqine punetore te operatorit ekonomik te nevojshem per ekzekutimin e objektit te prokurimit, si dhe..Objekti i procedures se prokurimit "Uniforma dhe veshje specialee perfshin ne vetvete edhe procesin e prodhimit te uniformes se MZSH-se, sherbimit zjarrfikes, pra permban ne vetvete elemente sherbimi per te cilen eshte e nevojshme qe nga ofertuesit e mundshem ekonomike te disponohet edhe nje staf i cili te beje te mundur realizimin me sukses te ketij procesi per realizimin e uniformes se punonjesit te sherbimit zjarrfikes me ane te se ciles ata perfaqesojne institucionin e Bashkise Tirane. Specialistet/ punonjesit e kerkuar jane te nevojshem per procesin e prodhimit/ qepjeve apo modifikimeve ne rast se do te jete e nevojshme te mallrave objekt prokurimi.

Po ne lidhje me kete argumentim te dhene, theksojme paraprakisht se ne kriterin e vecante per kualifikim, pika 2.4.5 auditerisht nga Autoriteti Kontraktor eshte kerkuar vetem nje numer prej 10 punonjesish, duke mos specifikuar ne asnje moment cilesine te cilen duhen te disponojne keta te fundit sic pretendohet ne argumentimin e ketij kriteri, konkretisht ku deklarohet se:

Specialistet/punonjesit e kerkuar jane te nevojshem per procesin e prodhimit/ qepjeve apo modifikimeve ne rast se do te jete e nevojshme te mallrave objekt prokurimi. Kjo le shteg per nje interpretim te vete operateve ekonomike pasi ne listen e punonjesve perfshihet cdo lloj punonjesi si sanitare, punonjesit e sherbimit, shofere etj., duke sjelle konfuzion dhe paqartesi ne hartimin e ofertes ekonomike. Pra kriteri i hartuar bie vete ndesh me argumentimin e dhene nga autoriteti kontraktor i cili i drejtohet nje kategorie te vecante punonjesisht.

NE nenin 2 te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 i per prokurimin publike percaktohet shprehimisht se: i qellim i ketij ligji eshte c) te nxise pjesemarrjen e operateve ekonomike ne procedurat e prokurimit publik; c) te nxise konkurrencen ndermjet operateve ekonomike; d) te siguroje nje trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per te gjithë operatet ekonomike, pjesemarrës ne procedurat e prokurimit publik?E, nderkohe qe ne nenin 3 (Parimet ligjore) citohet ne menyre te Drejteperdrejte se:e?Autoritetet dhe entet kontraktore garantojne trajtim te barabarte dhe Jodiskriminues per operatet ekonomike, si dhe veprojne me transparence e ne menyre Proporcionale. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet te shmangin fushen e zbatimit te ketij Ligji ose te ngushtojne ne menyre artificiale konkurrencen. Konkurrenca konsiderohet se eshte ngushtuar artificialisht kur prokurimi pergatitet me qellimin per te favorizuar ose demtuar ne menyre te padrejte operate ekonomike te caktuar? E nderkohe elementi thelbesor i cili duhet te kundërshtohet ne kete kriter kualifikimi eshte vete parashikimi i stafit prej 10 punonjesve ne listepagesat e operateve ekonomike, ne momentin kur te gjithë operatet ekonomike ne shqiperi, sic eshte permendur edhe me siper duke marre parasysh specifiken e produkteve te kerkuara Uniformat zjarreduruese, i importojne keto produkte dhe nuk i prodhojne ne vendin tone. Argumenti i dhene nga AK se objekti i procedures se prokurimit i uniforma dhe veshje

specialee perفشin ne vetvete edhe procesin e prodhimit te uniformes se MZSH-se, sherbimit zjarrfikes, pra permбан ne vetvete elemente sherbimi per te cilen eshte e nevojshme qe nga ofertuesit e mundshem ekonomike te disponohet edhe nje staf i cili te beje te mundur realizimin me sukses te ketij procesi per realizimin e uniformes se punonjesit te sherbimit zjarrfikes me ane te se ciles ata perfaqesojne institucionin e bashkise tiranee nuk qendron pasi te gjitha produktet importohen te gatshme ne Shqiperi. Nga ana tjeter asnje operator ekonomik nuk mund te nderhyje apo te kryeje modifikime te ketyre produkteve pasi cenohet drejteperdrejt certifikimi i tyre.

Percaktimi i numrit te punonjesve prej 10 punonjesish eshte i ekzagjeruar dhe ndikon ne menyre te drejteperdrejte ne pjesemarrjen e operatoreve ekonomike duke limituar konkurrencen, pasi automatikisht te drejton ose ne nje Operator Ekonomik te paracaktuar duke krijuar nje trajtim te pabarabarte dhe diskriminues per te gjithë operatoret ekonomike pjesemarres ne procedurat e prokurimit public ose duke i detyruar pjesemarresit ne kete procedure prokurimi drejt bashkimit te operatoreve ekonomike. Kjo e fundit limiton ne menyre te drejteperdrejte pjesemarrjen e operatoreve ekonomike ne kete procedure prokurimi, konkretisht te shoqerive te cilat i importojne keto produkte pasi nuk prodhohen ne Shqiperi.

Pra gjendemi perballe nje situate ku ndikohet ne menyre te drejteperdrejte dhe artificiale ne pjesemarrjen e operatoreve te tjere ekonomike, te cilet jane te interesuar te marrin pjese ne kete procedure prokurimi, duke i importuar keto produkte ne menyre qe te ofertojne ne menyre te pavarur, duke krijuar nje situate diskriminuese, si dhe duke cenuar ne menyre te drejteperdrejte pararimin e barazise te pecaktuar ne nenet 2 dhe 3 dhe konkretisht ne nenin 2 te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 i per prokurimin publike percaktohet shprehimisht se: i qellim i ketij ligji eshte c) te nxise pjesemarrjen e operatoreve ekonomike ne procedurat e prokurimit publik; C) te nxise konkurrencen ndermjet operatoreve ekonomike; d) te siguroje nje trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per te gjithë operatoret ekonomike, pjesemarres ne procedurat e prokurimit publik, nderkohe qe ne nenin 3 (Parimet ligjore) citohet ne menyre te drejteperdrejte se: e) Autoritetet dhe entet kontraktore garantojne trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per operatoret ekonomike, si dhe veprojne me transparence e ne menyre proporcionale. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet te shmangin fushen e zbatimit te ketij ligji ose te ngushtojne ne menyre artificiale konkurrencen. Konkurrenca konsiderohet se eshte ngushtuar artificialisht kur prokurimi pergatitet me qellimin per te favorizuar ose demtuar ne menyre te padrejte operatore ekonomike te caktuar.

Duhet shtuar gjithashtu se ne Lotin 1, po te verifikohet sasia e levrimit te Uniformave Zjarrduruese eshte v 150 complete dhe jane kerkuar 10 punonjes, nderkohe qe ne Lotin 2 i veshje Pune ku perفشihen, kostumet e dimrit, te veres, xhupa, kemishat, kravatat, kepuce etj. Me sasi relativisht me te madhe, te cilat theksojme se prodhohen ne Shqiperi jane kerkuar vetem 5 punonjes.

Nga ana e Autoritetit kontraktor cuditerisht, nuk eshte dhene asnje argumentim Teknik dhe ligjor ne lidhje me percaktimin e numrit te punonjesve te parashikuar per secilin nga Lotet, nderkohe

qe te gjitha Produktet e Lotit I importohen te gatshme dhe vijne te paketuara si produkt i perfunduar ndersa produktet e Lotit II mund te prodhohen edhe ne shqiperi.

Pra, ritheksojme serish se nga ana e Autoritetit Kontraktor, nuk eshte dhene asnje justifikim ne lidhje me numrin e ndryshem te numrit te punonjesve te kerkuar ne Lotin I, duke marre parasysh vete faktin se te gjitha produktet te kerkuar ne Lotin I importohen te gatshme ne shqiperi. NE nenin 2 te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 i per prokurimin publike percaktohet shprehimisht se: qellim i ketij ligji eshte c) te nxise pjesemarrjen e operatoreve ekonomike ne procedurat e prokurimit publik; c) te nxise konkurrencen ndermjet operatoreve ekonomike; d) te siguroje nje trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per te gjitha operatoret ekonomike, pjesemarres ne procedurat e prokurimit publik?E, nderkohe qe ne nenin 3 (Parimet ligjore) citohet ne menyre te drejteperdrejte se: Autoritetet dhe entet kontraktore garantojne trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per operatoret ekonomike, si dhe veprojne me transparence e ne menyre proporcionale. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet te shmangin fushen e zbatimit te ketij ligji ose te ngushtojne ne menyre artificiale konkurrencen. Konkurrenca konsiderohet se eshte ngushtuar artificialisht kur prokurimi pergatitet me qellimin per te favorizuar ose demtuar ne menyre te padrejte operatore ekonomike te caktuar, Po ne lidhje me kete kriter eshte konstatuar se nga Autoriteti Kontraktor ne Procesverbalin per argumentimi dhe botimin e Kriereve te Vecanta per Kualifikim, nuk eshte dhene asnje argumentim ne lidhje me numrin e punonjesve te kerkuar nga Autoriteti Kontraktor ne kete procedure Prokurimi.

Nga ana tjeter, rikujtojme Autoritetin Kontraktor se ne proceduren e zhvilluar po nga ky Autoritet me objekt i blerje AUTOMJETE zjarrfikese Nr. REF-13327-07-16-2024 zhvilluar me 16/08/2024, nuk ka patur nje kerkese te tille kualifikimi sic eshte disponimi i punonjesve pavaresisht se publikisht dihet qe ne Shqiperi ka prodhues te ketyre mjeteve.

Theksojme se ne VKM Nr. 285 i per rregullat e prokurimit publike te ndryshuar, Neni 78, pika 2 cilesohet se: i hartimi i kerkeseve per kualifikim, qe lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret per shpalljen e ofertes fituese (nese eshte rasti) dhe Ado informacion tjeter specifik i nevojshem, behen nga specialisti i fushes, anetar i njesise se prokurimit. NE varesi te objektit te prokurimit, nese nuk eshte vleresuar e nevojshme caktimi i nje specialisti fushes, hartimi i kerkeseve si me siper behet nga njesia e prokurimit. NE Ado rast, hartimi i tyre duhet te argumentohet teknikisht dhe ligjerisht, si dhe te dokumentohet ne nje procesverbal te mbajtur nga personat e ngarkuar per pergatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet ne dispozicion personit/ave pergjegjes per prokurimin, i cili/te cilet e ben/bejne pjese te dosjes se tenderit. Seti perfundimtar i dokumenteve te tenderit nenshkruset ne cdo faqe nga anetaret e njesise se prokurimit.

Mbeshtetur ne sa mesiper nga ana e autoritetit kontraktor kerkohet modifikimi i kriterit kualifikues 2.4.5 te parashikuara ne kriteret e vecanta per kualifikim, duke modifikuar numrin e punonjesve te kerkuar per proceduren e Lotit I si dhe te modifikoje Procesverbalin per argumentim dhe botimin e Kriereve te Vecanta per Kualifikim, duke paraqitur argumentimet perkatese ne lidhje me Numrin e punonjesve te kerkuar ne Lotin I "Uniforma Zjarrdurese". Te riformulohet ky kriter duke hequr kerkesen per te asistuar stafin e AK gjate procesit te

prodhimin/ qepjeve/ permasave apo modifikimeve per realizimin e uniformes se punonjesit te sherbimit zjarrfikese.

5. NE shtojcen 8, Kriteret e Vecanta per Kualifikim, pika 2.4.6 nga Autoriteti Kontraktor eshte parashikuar qe: Operatori ekonomik duhet te kete ne pronesi ose me qera keto pajisje:

? 1 (nje) makineri qendisje;

? 1 (nje) linje stampimi me serigrafi (makineri stampimi, furre tharje stampimi dhe prese per ngjitjen e logove)

Per permbushjen e ketij kriteri operatori ekonomik duhet te paraqese dokumentat qe vertetojne pronesine e tyre ose marrjen me qera te tyre: (fature tatimore te shitblerje/aktet e zhdoganimit, Origjinale ose fotokopje te noterizuar, ose cdo lloj akti tjeter ligjor qe verteton pronesine ose kontrate qeraje te noterizuar). Per makinerite me qera duhet te pergatitet kontrata e qerase e lidhur para noterit, me afat per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt prokurimi, e shoqeruar me dokumentacionin qe verteton pronesine e qeradhenesit (fatura tatimore ose zhdoganimi ose cdo lloj tjeter ligjor qe verteton pronesine e qeradhenesit).

Theksojme, se ky kriter dhe vete argumentimi i dhene nga Autoriteti Kontraktor sherbejne vetem per Veshjet e punes sipas Lotit II te cilat mund te prodhohen ne vendin tone dhe jo per uniformat zjarrduruese te cilat importohen te perfunduara e te paketuara duke u shoqeruar me certifikimin konform normave dhe standarteve te miratuara nderkombetare si dhe me skeden teknike e cila eshte element thelbesor ne percaktimin e plotesimit te te gjithë specifikimeve teknike te kerkuara nga Autoriteti Kontraktor per keto produkte specifike te deklaruar ne kete procedure prokurimi. NE lidhje me kete argumentim te dhene, theksojme paraprakisht se ne kriterin e vecante per Kualifikim, pika 2.4.6 nga Autoriteti Kontraktor eshte kerkuar Operatori ekonomik duhet te kete ne Pronesi ose me qera keto pajisje: 1 (nje) makineri qendisje; 1 (nje) linje stampimi me serigrafi (makineri stampimi, furre tharje stampimi dhe prese per ngjitjen e logove)

NE rastin konkret duhet sqaruar se edhe ne lidhje me kete kriter kualifikues te hartuar nga Autoriteti Kontraktor, duhet theksuar se produktet e parashikuara ne Lotin I, jane produkte te cilat importohen, pasi nuk prodhohen ne shqiperi. Keto produkte vijne te perfunduara dhe te konfeksionuara dhe per pasoje nuk mund te kryhen nderhyrje ne lidhje me keto produkte te perfunduara. Sqarojme se nderhyrja ne keto Uniforma cenon origjinen dhe certifikimin e tyre. Nga ana e Autoritetit Kontraktor, ne argumentimin e ketij kriteri per kualifikim deklarohet se:

Referuar specifikimeve teknike dhe kerkesave te percaktuara nga Autoriteti Kontraktor per realizimin e ketij objekti prokurimi dhe realizimin e proceseve te punes sa me siper cituar lind e nevojshme edhe disponimi i makinerive te kerkuara duke qene se vete projekti eshte nje nderthurje e zerave te mallit me ato te sherbimit sikunder jane procesi i dizenjimit dhe prodhimin te uniformes se MZSH-se, sherbimit zjarrfikese, ndaj eshte e nevojshme qe nga ofertuesit e mundshem ekonomike te disponohen edhe pajisjet/ makinerite per te bere te mundur realizimin me sukses te ketij procesi per realizimin e uniformes. Pajisjet/ makinerite e kerkuara jane te nevojshme per procesin e prodhimin/ qepjeve apo modifikimeve ne rast se do te jete e nevojshme te mallrave objekt prokurimi?

Argumentimi i dhene nga AK, si me siper, nuk qendron pasi:

A) Referuar Procesverbalit te hartuar nga AK, per Argumentimin dhe miratimin e Specifikimeve Teknike dhe Kriterëve per kualifikim, Tipi i kontrates eshte Mallra. Pra Autoriteti Kontraktor bie ndesh me argumentimin e tij pasi nuk kemi te bejme me sherbime.

B) Te gjithë elementet/produktet e uniformes Zjarrdurese, sipas VKM Nr. 1153, date 24.12.2020 për miratimin e uniformes, shenjave dalluese perkatese, Flamurit dhe stemes se Sherbimit te mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimie si me poshte:

- 1. UNIFORMA MBROJTESE NGA ZJARRI (XHAKETA & PANTALLONAT)*
- 2. DOREZAT PER MBROJTJE NGA ZJARRI*
- 3. KAPUCI MBROJTES PER ZJARRFIKESIN*
- 4. HELMETA PER ZJARRFIKES & SISTEMI PER NDRI«IM*
- 5. CIZMET MBROJTESE NGA ZJARRI*

Jane produkte te cilat prodhohen, certifikohen jashte vendit tone dhe importohen ne shqiperi si Produkte te gatshme te shoqeruara me certifikaten perkatese dhe me certifikaten e origjines.

C) Dizenjimi, prodhimi dhe certifikimi i tyre jane te percaktuara qartesisht ne VKM Nr. 1153, Date 24.12.2020.

D) Nuk mund te kryhet asnje lloj dizenjimi apo modifikimi mbi produktet e Uniformes Zjarrdurese pasi bie ndesh me VKM Nr. 1153, date 24.12.2020 si dhe cenohet origjina dhe certifikimi i tyre.

Parashikimi i ketij kriteri nga Autoriteti Kontraktor rezulton i ekzagjeruar dhe ndikon ne menyre te drejteperdrejte ne pjesmarrjen e operatoreve ekonomike duke limituar konkurrencen, automatikisht te drejton ose ne nje Operator Ekonomik te paracaktuar, duke krijuar nje trajtim te pabarabarte dhe diskriminues per te gjithë operatorët ekonomike, pjesemarrës ne procedurat e prokurimit publik, si duke i detyruar pjesemarrësit ne kete procedure prokurimi drejt bashkimit te operatoreve ekonomike. Kjo e fundit limiton ne menyre te drejteperdrejte pjesemarrjen e operatoreve ekonomike ne kete procedure prokurimi, konkretisht te shoqerive te cilat i importojne keto produkte dhe nuk i prodhojne ne shqiperi.

Pra edhe ne rastin e hartimit te ketij kriteri nga ana e Autoritetit Kontraktor gjendemi perballe nje suate ku ndikohet ne menyre te drejteperdrejte dhe artificiale ne pjesemarrjen e operatoreve ekonomike, te cilet jane te interesuar te marrin pjese ne kete procedure prokurimi, por i importojne keto produkte qe te ofertojne ne menyre te pavarur, duke krijuar nje suate diskriminuese, si dhe duke cenuar ne menyre te drejteperdrejte pararimin e barazise te pecaktuar ne nenet 2 dhe 3 dhe Konkretisht ne nenin 2 te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 për prokurimin publike percaktohet Shprehimisht se: “Qellim i ketij ligji eshte c) te nxise pjesemarrjen e operatoreve ekonomike ne procedurat e prokurimit publik; c) te nxise konkurrencen ndermjet operatoreve ekonomike; d) te siguroje nje trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per te gjithë operatorët ekonomike, pjesemarrës ne procedurat e prokurimit publik, nderkohe qe ne nenin 3 (Parimet ligjore) citohet ne menyre te drejteperdrejte se: Autoritetet dhe entet kontraktore garantojne trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per operatorët ekonomike, si dhe veprojne me transparence e ne menyre proporcionale. Autoritetet

dhe entet kontraktore nuk duhet te shmangin fushen e zbatimit te ketij Ligji ose te ngushtojne ne menyre artificiale konkurrencen. Konkurrenca konsiderohet se eshte ngushtuar artificialisht kur prokurimi pergatitet me qellimin per te favorizuar ose demtuar ne menyre te padrejte operatore ekonomike te caktuar.

Mbeshtetur ne sa mesiper nga ana e Autoritetit Kontraktor kerkohet modifikim i kriterit kualifikues, lidhur me kerkesen per makineri, mbeshtetur ne argumentimet e dhena nga ana jone si dhe duke marre parasysh faktin e importimit te Uniformave Zjarrduruese nga operatore ekonomike qe operojne ne kete sektor te vecante te tregut dhe se asnje operator ekonomik nuk mund te nderhyje apo te kryeje modifikime te ketyre produkteve pasi cenohet drejtperdrejt VKM dhe certifikimi i tyre.

6. NE shtojcen 8, Kriteret e Vecanta per Kualifikim pika 2.4.7 nga Autoriteti kontraktor eshte parashikuar si vijon: operatoret ekonomik ofertues, duhet te paraqese te paketuara dhe te protokolluara mostra per te gjitha artikujt objekt prokurimi, si me poshte:

A) nga nje moster fizike per objektet e uniformes (produkt te gatshem) qe do te prokurohen qe perfshin te gjitha detajet, llojin e materialit dhe pjeseve perberese te tyre, punimin dhe permasat e caktuara ne specifikimet teknike. Mungesa e mostres dhe e lendes se pare qe shoqeron ato eshte kusht s'kualifikues.

B) Mostrat do te paraqiten ne daten dhe oren e hapjes se ofertave prane Autoritetit Kontraktor Drejtoria e Prokurimeve Administrative dhe sherbimeve, Bashkia tirane, me adrese: Sheshi Skenderbej, Nd. 2e, tirane.

C) Mostrat e paraqitura duhet te kene te trupezuar nje etikete te qepur, e cila te permbaje: moster emri i artikullite, Objektin e porcedures/ Lotin per te cilin oferton, daten e zhvillimit te tenderit, Emrin e prodhuesit/ofertuesit, nenshkrimin dhe vulen e operatorit ekonomik, te identifikueshme me numrin rendor perkates ne etikete (sipas numrit rendor te tabelave, psh: Loti 2: Veshje Pune, Nr.1- Kapele, referuar ishtojca 3e/ shtojces 7).

Mosparaqitja e mostrave sipas kerkesave te mesiperme perben kusht s'kualifikimi per vazhdimin e Procedurave.

Ne rastin konkret, nga ana jone jane kundershthohet pika a) dhe c) e parashikuar ne kriterin 2.4.7 te siperpermendur nga ana e Autortieti kontraktor, i cili deklaroi qe a) Mungesa e mostres dhe e Lendes se pare qe shoqeron ato eshte kusht s'kualifikues dhe c) mostrat e paraqitura nga operatoret Ekonomike te duhet te kene te trupezuar nje etikete te qepur, e cila te permbaje: moster emri i Artikullit, Objektin e procedures/Lotin per te cilin oferton, daten e zhvillimit te tenderit, emrin e Prodhuesit/ofertuesit, nenshkrimin dhe vulen e operatorit ekonomik, te identifikueshme me numrin rendor perkates ne etikete (sipas numrit rendor te tabelave, psh: Loti 1: Nr.1- Uniforme Zjarrduruese, referuar shtojca 3e/ shtojces 7).

NE rastin konkret duhet ritheksuar serish se edhe ne lidhje me kete kriter kualifikues te hartuar nga Autoriteti Kontraktor, te gjitha produktet e parashikuara ne Lotin I, jane produkte te cilat importohen si produkte te gatshme, pasi nuk prodhohen ne shqiperi. Keto produkte vijne te perfunduara dhe te paketuara/ambalazhuara dhe per pasoje nuk mund te kryhen nderhyrje ne

keto produkte te gatshme. Sqarojme se keto produkte te importuara permbushin te gjitha specifikimet e kerkuara nga Autoriteti Kontraktor, vetem kur paraqiten me certifikaten e produktit, origjines si dhe skeden teknike ku jane te specifikuar te gjithë elementen qe perbejne ne rastin konkret Uniformat Zjarrduruese.

Autoriteti kontraktor, nuk ka dhene asnje argumentimin ne percaktimin e kerkeses per paraqitjen e lendes se pare qe shoqeron mostren. Kjo kerkese rezulton krejtesisht e ekzagjeruar dhe e pamundur praktikisht pasi Uniforma Zjarrduruese ka ne perberje te saj disa produkte si:

UNIFORMA MBROJTESE NGA ZJARRI (XHAKETA & PANTALLONAT), DOREZAT PER MBROJTJE NGA ZJARRI, KAPU«I MBROJTES PER ZJARRFIKESIN, HELMETA PER ZJARRFIKES & SISTEMI PER NDRI«IM, «IZMET MBROJTESE NGA ZJARRI. Sikurse percaktohet qartesisht edhe ne VKM Nr. 1153, date 24.12.2020 iper miratimin e uniformes, Shenjave dalluese perkatese, Flamurit dhe stemes se sherbimit te mbrojtjes nga zjarri dhe Shpetimi, por edhe ne Specifikimet e Autoritetit kontraktor, secili nga produktet e Uniformes Zjarrduruese ka ne perberje te tij disa lloje materialesh si lende te pare.

Psh ne rastin e helmetaes per zjarrfikes duhet te jete e perbere me elementet si me poshte:

1. Xham transparent me ngjyre lumineshence,
2. Amortizues te punuar nga poliuretani
3. Materiale kompozite (fibra karboni), dhe poliuretanit (e integruar ne poliuretan)
4. Pjesa e brendshme e helmetaes duhet te jete e punuar nga materiale kompozite SMC
5. Mbrojtes qafe te punuar prej fibrave karbonike dhe te trajtuara me alumin.
6. Rripi i mjekres duhet te jete nga materiali nomex etj etj

Psh ne rastin e UNIFORMA MBROJTESE NGA ZJARRI (XHAKETA & PANTALLONAT) duhet Te jete e perbere me elementet si me poshte:

1. Materiali i shtreses se jashtme duhet te jete perzierje te fijeve aramidi 100% (me nje permbajtje prej se paku 23 % paraaramid dhe 2% fije karboni ngjyre blu te erret)
2. Materiali per pengimin e depertimit te fluideve, duhet te jete membrane mikroporoze PTFE, me shtresa fine te polimereve te nje performance te larte ne materialin bartes me perberje 50% aramid dhe 50 % melamin te mbyllur, shkumezime silikoni per mbajtje distance ose ekuivalente.
3. Materiali bartes per saldimin e qepjeve duhet te jete membrane mikroporze dykomponenteshe nga politetraflouretileni i ekspanduar.
4. Membrane ajrosese (angl.: breathable) PTFE, e mbeshjtelle ne te dyja anet nga aramid i Petezuar, i qendrueshem ne larje dhe pastrim kimik.
5. Astar te perhershëm rezistent ndaj zjarrit Nomex 50%.....
6. Mbrojteset (mbushjet ose jasteket mbrojtës) nga materiale perhere te qendrueshme ne Flake, nga plastike joabsorbues qe nuk thithin lageshti gjate gjithë jetes
7. Zinxhiri i xhaketes duhet te jete i pajisur me patente paniku, si dhe dhembe metalik me Madhesi prej 8mm.
8. Penjte per qepje, materiali metaaramid per te gjitha qepjet, kurse ngjyra duhet te jete Identike me ngjyren e materialit te jashtem

9. Pjesa e perparme, e poshtme, e pantallonave, ne zonen e gjunjeve duhet te jete e pajisur Me perforcime nga materiali me perberje silikon/karbon.

Lehtesisht lind pyetja cilen nga keto lende te para duhet te dorezohen bashke me mostren e Produktit te gatshem HELMETA PER ZJARRFIKES apo UNIFORMA MBROJTESE NGA ZJARRI (XHAKETA & PANTALLONAT). Qartazi, sikurse kemi argumentuar edhe me siper, ne Perputhje edhe me VKM kemi te bejme me disa lende te para te cilat gjate te procesit te prodhimit Integrohen dhe japin produktin e gatshem final. Analiza e mesiperme vlen per te gjitha produktet te cilat jane pjese e Uniformes Zjarrrdurese.

Nga ana tjeter, duhet sqaruar se termi i perdorur nga AK ãte kene te trupezuar nje etikete te qepur, e cila te permbaje: moster emri i artikullit, Objektin e procedures/Lotin per te cilin oferton, daten e zhvillimit te tenderit???..e nuk eshte i qarte dhe ndikon drejtpersedrejt ne skualifikimin e operatoreve ekonomike.

Trupezimi i etiketes me te dhenat e kerkuara nga AK, me ane te qepjes ne mostrat e dorezuara do Tí bente keto mostra te paperdorshme ne nje procedure prokurimi tjeter ose ne momentin kur keto produkte te paraqitura prane Autoritetit Kontraktor do te riperdoreshin nga operatoret ekonomike Importues per qellime te tjera. Nga ana tjeter, duke qene se Uniformat Zjarrrdurese per specifikat e arashikuara kane kosto te larte per blerjen e tyre, sikurse parashikohet edhe nga vete AK ne percaktimin e fondit limit prej 185867 leke/uniforme zjarrrdurese, trupezimi i etiketes se qepur do te sillte dem ekonomik te pajustifikuar per operatoret pjesemarres.

Trupezimi i etiketes te qepur, sikurse Autoriteti e kerkon, detyron operatoret ekonomik te nderhyjne ne produktin e gatshem duke cenuar prodhimin dhe certifikimin e tij.

Kerkesa e Autoritetit do te ishte e sakte vetem nese ne ambalazhin/paketimin e secilit produkt do te ngjitej nje leter informuese me te dhenat e kerkuara nga Autoriteti.

Kerkesa e Autoritetit per paraqitjen e mostres me etikete te trupezuar, limiton serish ne menyre te drejteperdrejte pjesemarrjen e operatoreve ekonomike ne kete procedure prokurimi, konkretisht te hoqerive te cilat i importojne keto produkte. Kjo kerkese mund te sherbeje vetem per produktet e Lotit II Veshjet e punes te cilat prodhohen ne Shqiperi.

Pra edhe ne rastin e hartimit te ketij kriteri nga ana e Autoritetit Kontraktor gjendemi perballe nje Situate ku ndikohet ne menyre te drejteperdrejte dhe artificiale ne pjesemarrjen e operatoreve Ekonomike, te cilet jane te interesuar te marrin pjese ne kete procedure prokurimi, por i importojne keto produkte te cilet kane nje kosto te larte per operatoret ekonomike pjesemarres, duke krijuar nje situate diskriminuese, si dhe duke cenuar ne menyre te drejteperdrejte pararimin e barazise te pecaktuar ne nenet 2 dhe 3 dhe konkretisht ne nenin 2 te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 ãper Prokurimin publike percaktohet shprehimisht se: ãqellim i ketij ligji eshte c) te nxise pjesemarrjen e operatoreve ekonomike ne procedurat e prokurimit publik; c) te nxise konkurrencen ndermjet operatoreve ekonomike; d) te siguroje nje trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per te gjithë Operatoret ekonomike, pjesemarres ne procedurat e prokurimit publik? E, nderkohe qe ne nenin 3 (Parimet ligjore) citohet ne menyre te drejteperdrejte se: e) Autoritetet dhe entet kontraktore Garantojne trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per operatoret ekonomike, si dhe veprojne me

Transparence e ne menyre proporcionale. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet te shmangin Fushen e zbatimit te ketij ligji ose te ngushtojne ne menyre artificiale konkurrencen. Konkurrenca Konsiderohet se eshte ngushtuar artificialisht kur prokurimi pergatitet me qellimin per te favorizuar Ose demtuar ne menyre te padrejte operatore ekonomike te caktuar?E mbeshtetur ne sa mesiper nga ana e autoritetiti kontraktor modifikimi i kriterit kualifikuese te Parashikuar ne piken 2.4.7 dhe tii kerkohet Autoritetit Kontraktor qe heqe piken ku deklarohet qe mungesa e lendes se pare eshte kusht si kualifikues dhe kerkesa qe mostrat e paraqitura duhet te kene te trupezuar nje etikete te qepur, e cila te permbaje: moster i emri i artikullite, Objektin e Porcedures/ Lotin per te cilin oferton, daten e zhvillimit te tenderit, emrin e prodhuesit/ofertuesit, nenshkrimin dhe vulen e operatorit ekonomik, te identifikueshme me numrin rendor perkates ne etikete si kriter qe cenon ne menyre te drejteperdrejte parimin e barazise te percaktuar ne nenet 2 dhe 3 te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publike”.

II.3. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Me anë të shkresës nr. 39271/5 prot., datë 18.11.2024, protokolluar me tonën me nr. 3338/2 prot., datë 26.11.2024, me objekt “Kërkesë për asistencë”, autoriteti kontraktor, na vë në dijeni, lidhur me kërkesën e tij drejtuar Universitetit Politeknik të Tiranës, si më poshtë:

[...]

Sa më sipër, AK në kuadër të shqyrtimit të saj, në bazë të VKM-së Nr. 188, datë 13.3.20219 [...], kërkojmë nga ana juaj informacion nëse institucioni juaj ka Inxhinier/Ekspert të profilizuar ose jo në fushën e tekstileve për të shqyrtuar ankesën teknikisht dhe nëse po të mund të na vini në dispozicion dy Inxhinier/Ekspert për fushën e sipërcituarm duke marrë në konsideratë natyrën specifike për këtë objekt prokurimi. [...]

II.5. Me anë të shkresës nr. 39271/8 prot., datë 20.12.2024, protokolluar me tonën me nr. 3338/3 prot., datë 26.12.2024, me objekt “Vënie në dispozicion informacioni lidhur me shqyrtimin e ankesës për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje uniforma dhe veshje speciale për MZSH-në; Loti 1 – Uniforma Zjarrëduruese”, autoriteti kontraktor, njofton se:

[...]

Autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë, me anë të shkresës nr.39271 prot., datë 18.11.2024, i është drejtuar Universitetit Politeknik të Tiranës, si organ veprimtaria e të cilit lidhet me objektin e prokurimit, për caktimin e një eksperti në fushën e tekstileve me qëllim shqyrtimine ankesës teknikisht mbi bazën e VKM-së Nr.188, datë 13.03.2018 [...]. Bazuar në nenin 100, pika 3 të VKM-së nr.285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) [...], në

mënyrë që ekspertja e caktuar, së bashku me anëtarët e tjerë të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës, të njihen me të gjithë materialin e përgatitur nga ekspertët e fushës/ grupi i posacëm i hartimit të specifikimeve teknike, po ju informojmë se, nevojitet më tepër kohë në daljen e një vendimi përfundimtar mbi ankesën e paraqitur për procedurën e sipërcituar. . [...]”.

II.6. Në datë 24.01.2024, nëpërmjet postës elektronike, në adresën kpp_info@kpp.gov.al, protokolluar pranë KPP me nr. 3338/4 prot., datë 28.01.2024, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë KPP-së aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ku konstatohet se e ka pranuar pjesërisht atë, si më poshtë:

“[...] Autoriteti Kontraktor, në zbatim të kompetencave dhe të drejtave të tij, si dhe referuar VKM-së Nr.188, datë 13.03.2019 “Për ofrimin nga institucionet publike të arsimit të lartë të shërbimeve, në përputhje me veprimtarinë e tyre, për institucionet e qeverisjes qendore, institucionet në varësi të tyre dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore” (i ndryshuar), ka kërkuar me anë të një shkresë zyrtare, nga Universiteti Politeknik i Tiranës (në vijim “UPT”), ekspert të profilizuar në fushën e tekstileve për të shqyrtuar teknikisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “VICTORIA AL” shpk. Pas caktimit të një eksperti nga ana e UPT-së dhe njohjes së saj me gjithë dokumentacionin për zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe ankesës së operatorit ekonomik, na u komunikua se nuk përputheshin plotësisht me fushën e saj të studimit dhe nuk mund të jepte një vendim lidhur me sa më sipër. Si rrjedhim, AK vendosi ndryshimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave (në vijim “KSHA”) me anëtarë brenda institucionit, në mënyrë që procesi i shqyrtimit të ankesës të mos kishte më vonesa, pasi nevoja për zhvillimin e procedurës nga ana e autoritetit përfitues është maksimizuar, për shkak të konsumit të uniformave që janë në përdorim nga punonjësit e MZSH-së.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, i ngritur me Urdhërin e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, për procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje uniforma dhe veshje speciale për MZSH-në, Loti 1 “Uniforma Zjarreduruese”, me Nr. REF-28211-11-05-2024, me fond limit 27,880,050 (njëzetë e shtatë milionë e tetëqind e tetëdhjetë mijë e pesëdhjetë) lekë pa tvsh, pasi u njoh me ankesën e operatorit ekonomik “VICTORIA AL” sh.p.k mori në shqyrtim ankesën e bërë pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, si edhe njëkohësisht në faqen elektronike të KPP-së, në mbështetje të nenit 110, pika 1 të LPP-së, si edhe nenit 94, nenit 97, pika 1, gërma (a) dhe nenit 100 dhe 101 të RRPP-së.

[...]

1. Pala ankimuese “VICTORIA AL” sh.p.k pretendon si më poshtë vijon:

Konkretisht, në ankesë ngrihen pretendime për modifikim të dokumentave strandarte të tenderit, si më poshtë:

1.1 “Në shtojcën 8, Kriteret e Vecanta për Kualifikim, pika 2.4.2 nga ana e Autoritetit Kontraktor Eshtë kerkuar Deshmi per rezultatet e testeve zyrtare (raporte testimi), te leshuara nga institucione te autorizuar, qe vertetojne pajtueshmerine e produkteve me specifikimet teknike, te materialeve perberese te produkteve te Uniformes zjarreduruese te personelit operues

(zjarrfikes), perkatesisht uniformes mbrojtese nga zjarri (xhaketa dhe pantallonat) + Kapuci mbrojtës për zjarrfikesin + Dorezat për mbrojtje nga zjarri. (Raportë testimi për copën e përdorur për artikullin mostër, lëndës së parë që shoqëron atë dhe ajo që i bashkëngjitet fletë-analizës duhet të jenë detyruesisht të njëjta). Në argumentimin e dhënë nga Autoriteti Kontraktor deklarohet se kjo kërkesë është vendosur sipas përcaktimit të bërë në mbështetje të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, neni 40, pikë 6, germa c) ku cilesohet se: Autoriteti/enti kontraktor mund t'iu kërkojë operatoreve ekonomike të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të leshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. Paraprakisht, duhet theksuar se gjendemi përpara një procedure prokurimi mallrash me një specifike të vecantë, për të cilën VKM Nr. 1153, datë 24.12.2020 “Për miratimin e uniformes, shenjave dalluese perkatese, Flamurit dhe Stemes së shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi” e përcakton qartazi cilat janë elementet/produktet e Uniformes Zjarrduruese, cilat duhet të jenë specifikimet teknike, si dhe normat e standartet perkatese ndërkombëtare për secilin element të uniformes zjarrduruese. Referuar VKM-së produktet përberëse të Uniformes Zjarrduruese janë: 1. UNIFORMA MBROJTESE NGA ZJARRI (XHAKETA & PANTALLONAT) 2. DOREZAT PËR MBROJTJE NGA ZJARRI 3. KAPUCI MBROJTËS PËR ZJARRFIKESIN 4. HELMETA PËR ZJARREFIKES & SISTEMI PËR NDRICIM 5. CIZMET MBROJTESE NGA ZJARRI.

Nga ana e Autoritetit Kontraktor, kështu për paraqitjen e raporteve të testimit rezulton e paqarte pasi fillimisht kerkohen raporte testimi të materialeve përberëse të produkteve të Uniformes zjarrduruese por nga ana tjetër përcakton vetëm 3 nga 5 produktet e uniformes, konkretisht uniformen mbrojtese nga zjarri (xhaketa dhe pantallonat) + Kapuci mbrojtës për zjarrfikesin + Dorezat për mbrojtje nga zjarri. Po nga Autoriteti kontraktor deklarohet se: Raportë testimi për copën e përdorur për artikullin mostër, lëndës së parë që shoqëron atë dhe ajo që i bashkëngjitet fletë-analizës duhet të jenë detyruesisht të njëjta. Fillimisht, referuar VKM Nr. 1153, datë 24.12.2020, konkretisht për Uniformen mbrojtese nga zjarri (xhaketa dhe pantallona) e cila përben vetëm njerin nga elementet e uniformes zjarrduruese (numri rendor 1) termi i përdorur nga AK. Raportë testimi për copën nuk është i saktë, pasi si cilesohet në VKM materialet përberëse të uniformes përfshijnë shtresën e jashtme, materialin për pengimin e depërimit të fluideve, materialin bartes për saldimin e qepjeve, astarin, Pengesat absorbuese. Sa më sipër, termi i përdorur nga AK cope nuk gjendet në asnjë rresht të VKM-së për produktin Uniforme mbrojtese nga zjarri (xhaketa dhe pantallona). Nga ana tjetër, Uniforma mbrojtese nga zjarri (xhakete pantallona), përveç shtresave, përmbajnë materiale të ndryshme si: Mbrojtëset (mbushjet ose jasteket mbrojtës) si dhe aksesoret Penjete për qepje, rripa, perforcues, zinxhire, Shiritat velcro për mberthyerje (mbyllje) etj Në rastin konkret gjendemi përpara një kriteri të paqarte dhe diskriminues në momentin e interpretimit nga ana e një operatori ekonomik i cili kërkon të marrë pjesë në këtë procedure prokurimi.

Ne nenin 2 te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 Per prokurimin publik percaktohet shprehimisht se: “Qellim i ketij ligji eshte c) te nxise pjesemarrjen e operatoreve ekonomike ne procedurat e prokurimit publik;c) te nxise konkurrencen ndermjet operatoreve ekonomike; d) te siguroje nje trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per te gjithë operatorët ekonomike, pjesemarres ne procedurat e prokurimit publik nderkohe qe ne nenin 3 (Parimet ligjore) citohet ne menyre te drejteperdrejte se: Autoritetet dhe entet kontraktore garantojne trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per operatorët ekonomike, si dhe veprojne me transparence e ne menyre proporcionale. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet te shmangin fushen e zbatimit te ketij ligji ose te ngushtojne ne menyre artificiale konkurrencen. Konkurrenca konsiderohet se eshte ngushtuar artificialisht kur prokurimi pergatitet me qellimin per te favorizuar ose demtuar ne menyre te padrejte operatore ekonomike te caktuar e paqartesia ne hartimin e ketij kriteri per kualifikim themelor, ndikon ne menyre te drejteperdrejte ne paraqitjen e nje oferte te rregullt, transparente dhe proporcionale nga ana e operatoreve ekonomike, duke krijuar ne kete menyre ngushtim artificial te konkurrences midis operatoreve ekonomike ne shkelje haptazi te parimeve baze te percaktuara ne nenin 3 te LPP. Paqartesia e shprehur ne kete kriter kualifikues bie ndesh ne menyre te drejteperdrejte me percaktimet ligjore te parashikuara ne nenin 2 dhe 3 te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 Per prokurimin publik, dhe konkretisht, theksojme se Autoriteti Kontraktor nuk duhet te shmange ose te ngushtojne ne menyre artificiale konkurrencen. Konkurrenca konsiderohet se eshte ngushtuar artificialisht kur prokurimi pergatitet me qellimin per te favorizuar ose demtuar ne menyre te padrejte operatore ekonomike te caktuar”.

****Lidhur me sa është pretenduar më sipër ju parashitrojmë arsyetimin e bërë nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave si më poshtë:***

Sikundër është cituar edhe më sipër, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, për efekt të shqyrtimit të ankesës nga operatori ekonomik “VICTORIA AL” sh.p.k administroi materialin e nevojshëm sikurse janë kërkesën për incimin e proçedurës nga Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, dokumentat standarte të tenderit/kriteret për kualifikim, specifikimet teknike për proçedurën e prokurimit me objekt: “Blerje uniforma dhe veshje speciale për MZSH-në, Loti 1 “Uniforma Zjarrëduruese”.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, vlerëson se në asnjë rast dhe për asnjë qëllim AK, Bashkia Tiranë nuk synon të penalizojë apo kushtëzojë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedura prokurimi me kriteret apo specifikime të vendosura nga AK, të cilat nuk mund të përmbushen prej OE, duke respektuar parimin e mosdiskriminimit dhe për të nxitur pjesëmarrjen e OE në procedura prokurimi të zhvilluara nga AK, Bashkia Tiranë.

Pas administrimit të dokumentacionit, si më sipër cituar, KSHA gjykon se:

Nga verifikimi i bërë nga ana e KSHA-së, kriterit për kualifikim 2.4.2 të përcaktuar nga AK, në kriteret e veçanta për kualifikim për procedurën me objekt: “Blerje uniforma dhe veshje speciale për MZSH-në, Loti 1 “Uniforma Zjarrëduruese”, vëren se është përcaktuar si më poshtë vijon:

*“2.4.2 Dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare (raporte testimi), të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike, të materialeve përbërëse të produkteve të Uniformës zjarrduruese të personelit operues (zjarrfikës), përkatësisht *uniformës mbrojtëse nga zjarri (xhaketa dhe pantallonat) + Kapuçi mbrojtës për zjarrfikësin + Dorezat për mbrojtje nga zjarri.*

(Raporte testimi për copën e përdorur për artikullin mostër, lëndës së pare që shoqëron atë dhe ajo që i bashkëngjitet fletë-analizës duhet të jenë detyruesisht të njëjta)”.

Pala ankimuese pretendon se:

“...[Nga ana e Autoritetit Kontraktor, kërkesa për paraqitjen e raporteve të testimit rezultoi në paqarte pasi fillimisht kerkohen raporte testimi të materialeve përbërëse të produkteve të Uniformës zjarrduruese por nga ana tjetër përcakton vetëm 3 nga 5 produktet e uniformes, konkretisht uniformën mbrojtëse nga zjarri (xhaketa dhe pantallonat) + Kapuçi mbrojtës për zjarrfikësin + Dorezat për mbrojtje nga zjarri. Po nga Autoriteti kontraktor deklarohet se: Raporte testimi për copën e përdorur për artikullin mostër, lëndës së pare që shoqëron atë dhe ajo që i bashkëngjitet fletë-analizës duhet të jenë detyruesisht të njëjta.... Në rastin konkret gjendemi përpara një kriteri të paqarte dhe diskriminues në momentin e interpretimit nga ana e një operatori ekonomik i cili kërkon të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi]...”

KSHA për sa më sipër, pas shqyrtimit dhe verifikimit të dokumentacionit, konstaton si më poshtë: Autoriteti Kontraktor ka vendosur kriterin e sipërcituar referuar VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit public” (i ndryshuar), neni 40, pika 6, gërma c), ku cilësohet se:

“Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike”.

Gjithashtu referuar nenit 77 “Kërkesat për kualifikim” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) parashikon se: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomik dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje proporcionale me objektin e kontratës.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim, autoritetet ose entet kontraktore kërkojnë në vecanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin

informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyshin e vlerës së parashikuar të kontratës”.

KSHA gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve të operatorit ekonomik për përmbushjen me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Siç konstatohet në kriterin e sipërcituar, AK ka përcaktuar qartë artikujt që duhet të paraqesin raport-testime, të cilat AK i gjykon të nevojshme duke parë dhe rëndësinë që këto kanë dhe rolin që luajnë në sigurimin e jetës së punonjësve, të cilët do i përdorin ato gjatë punës së përditshme, si edhe duke u përprekur të mos rrisë kostot e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës për të kërkuar raport-testime për të gjithë artikujt përbërës të uniformës zjarrëduese.

Ndërsa, përsa i përket kërkesës se, cila nga pjesët përbërëse të uniformës zjarrëduese duhet të paraqitet raport-testimi, bëjmë me dije se, raport-testimet që duhet të paraqiten nga OE pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, siç shprehet dhe më sipër për copën e përdorur është ajo e lëndës së parë kryesore të ndërtimit të uniformës, jo të lëndëve ndihmëse që plotësojnë uniformën zjarrëduese.

Përsa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

1.2 Së dyti, pala ankimuese pretendon si më poshtë vijon:

“Paraprakisht, sikurse kemi informuar më herët njëherazi edhe AK-në edhe KPP-në në ankesat tona të përsëritura të cilat lidhen me objektin e kësaj procedure, të gjitha elementet/produktet e Uniformes Zjarrëduese prodhohen jashtë vendit tonë. Ato certifikohen konform normave dhe standarteve të miratuara ndërkombëtare.

Në VKM Nr. 1153, datë 24.12.2020 “Për miratimin e uniformës, shenjave dalluese përkatëse, Flamurit dhe Stemës së shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi” përcaktohet shprehimisht:

UNIFORMA MBROJTËSE NGA ZJARRI (XHAKETA & PANTALLONAT)

Xhaketa dhe pantallonat për mbrojtje nga zjarri, duhet të jenë të punuara dhe të certifikuara në përputhje me standardin EN 469:2005, niveli 2 i mbrojtjes.

Përveç kësaj, xhaketa për mbrojtje nga zjarri duhet të plotësojë edhe standardin EN 469:2005, shtojca B.

Prodhuesit ose subjekti që i trajton këto produkte është i detyruar të paraqesë certifikatat e vlefshme të produktit. DOREZAT PËR MBROJTJE NGA ZJARRI

Duhet të jenë të certifikuara në harmoni me standardet: EN 659:2003

KAPUÇI MBROJTËS PËR ZJARRFIKËSIN

Kapuçi mbrojtës duhet të jetë i certifikuar në harmoni me standardet EN13911:2005 & EN 1149-

HELMETA PËR ZJARRFIKËS & SISTEMI PËR NDRIÇIM

Helmeta për përdorim nga zjarrfikësit për mbrojtje kundër zjarrit e gjatë ndërhyrjeve operuese duhet të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare EN 443:2008 dhe EN 14458.

ÇIZMET MBROJTËSE NGA ZJARRI

Duhet të jenë të certifikuara sipas standardeve EN ISO 15090:2012 F2A H13 P T CI AN SRC EN ISO.

Gjatë shqyrtimit të kriterëve të vecanta për kualifikim rezulton se sipas pikes 2.4.4 është kërkuar paraqitja e Çertifikatave konform standarteve përkatëse të specifikuara në pikat 1,2,3,4,5 të elementeve të Uniformave Zjarrduruese të përcaktuara, si çertifikata të detyrueshme në VKM Nr. 1153, datë 24.12.2020 “Për miratimin e uniformës, shenjave dalluese përkatëse, Flamurit dhe Stemës së shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi”.

Pajisja e produkteve me çertifikatat përkatëse kryhet mbështetur në testimin e produkteve dhe materialeve për prodhimin e tyre sipas përkatësisë standardeve/specifikimeve teknike dhe ekzaminimit të dosjes teknike për çdo produkt. Pra, Çertifikata e vlefshme e produktit konform standarteve të përcaktuara në VKM është dokumenti përmbledhës dhe shterues i cili vërteton pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

Pra, kërkesa e AK-se për raporte testimi vetëm për 3 nga elementet e uniformës zjarrduruese, përkatësisht uniformës mbrojtëse nga zjarri (xhaketa dhe pantallonat) + Kapuçi mbrojtës për zjarrfikësin + Dorezat për mbrojtje nga zjarri” rezulton si kërkesë jo e plote pasi Uniforma zjarrduruese përbehet nga 5 elementet e mesipër sipas pikave 1,2,3,4,5. Nga ana tjetër kërkesa për raporte testimi rezulton e dublikuar nga ana e Autoritetit kontraktor pasi paraqitja e Çertifikatave të këtyre produkteve (sipas pikes 2.4.4) është dokumenti final i cili vërteton pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

Mbështetur në VKM Nr. 1153, datë 24.12.2020 “Për miratimin e uniformës, shenjave dalluese përkatëse, Flamurit dhe Stemës së shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi” dhe sa më sipër kërkohet saktësimi dhe modifikimi i këtij kriteri kualifikues”.

KSHA për sa më sipër, pas shqyrtimit dhe verifikimit të dokumentacionit, konstaton si më poshtë:

Përsa i përket prodhimit të uniformave, nga testimi i tregut që, AK ka kryer rezulton që këto produkte të prodhohen brenda Shqipërisë apo të importohen nga jashtë saj, sipas standarteve kombëtare apo ndërkombëtare (SSH).

Për të provuar pajtueshmërinë me specifikimet teknike konform VKM Nr.1153, datë 24.12.2020 “Për miratimin e uniformës, shenjave dalluese përkatëse, Flamurit dhe Stemës së shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi” ashtu siç edhe pranohet nga OE ankimes për këto artikuj janë kërkuar çertifikatat përkatëse që vërtetojnë përputhshmërinë me specifikimet teknike. Grupi i punës/ specialistët e fushës, anëtarë të njësisë së prokurimit, gjykojnë të nevojshme dhe të domosdoshme, që të paktën 3 (tre) nga elementët përbërës të uniformës zjarrduruese (tekstile), t'i nënshtrohen raport-testimeve, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike, të materialeve përbërëse të produkteve të Uniformës zjarrduruese të personelit operues (zjarrfikës), përkatësisht *uniformës mbrojtëse

nga zjarri (xhaketa dhe pantallonat) + Kapuçi mbrojtës për zjarrfikësin + Dorezat për mbrojtje nga zjarri.

Uniformat për mbrojtje nga zjarri janë produkte që përdoren në kushte shumë të rrezikshme. Pavarësisht se, certifikatat mund të japin informacion të vlefshëm për përputhshmërinë me standardet, raportet e testimi janë të nevojshme për të siguruar që çdo element i uniformës është testuar për përdorim të sigurt. Është një masë shtesë për të siguruar mbrojtjen më të lartë të punonjësve që përdorin këto uniforma.

Raportet e testimi janë një formë e verifikimit të vazhdueshëm dhe të drejtpërdrejtë, që mund të ofrojnë më shumë transparencë në lidhje me cilësinë dhe sigurinë e produkteve të përdorura për mbrojtje nga zjarri.

Përsa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

1.3 Së treti, pala ankimuese pretendon si më poshtë vijon:

“Në shtojcën 6, SPECIFIKIMET TEKNIKE: LOTI 1: “UNIFORMA ZJARRDURUESE”, në lidhje me produktin Çizme Mbrojtëse nga Zjarri rezulton se: është kërkuar që Çizmet duhet të jenë të prodhuara nga materiali lëkurë e zezë me kualitet të lartë, ndërkohë që në listimin fillestar të produkteve të dhënë nga Autoriteti Kontraktor rezulton që ngjyra e Çizmeve Zjarrduruese të jetë ngjyra Blu.

Për pasojë kemi një mospërputhje midis ngjyrës së Çizmeve Zjarrduruese të dhënë në Listën fillestare të Specifikimeve Teknike nga Autoriteti Kontraktor dhe ngjyrës të po këtyre Çizmeve të dhënë në parashtrimin e specifikimeve teknike që duhet të përmbajnë këto të fundit.

Për pasojë kjo diferencë midis ngjyrës së Çizmeve Zjarrduruese, të hartuar në specifikimet teknike krijon konfuzion dhe mund të cojë në paraqitjen e një ofertë dhe te nje mostre të gabuar në lidhje me këtë produkt. Nga ana tjetër, kjo mospërputhje e ngjyrës është penalizuese për operatorët ekonomike pasi referuar kërkesave për kualifikim, konkretisht pika 2.4.7 Operatorët ekonomik ofertues, duhet të paraqesë të paketuara dhe të protokolluara mostra për të gjithë artikujt objekt prokurimi, si më poshtë:

a) nga një mostër fizike për objektet e uniformës (produkt të gatshëm) që do të prokurohen që përfshin të gjitha detajet, llojin e materialit dhe pjesëve përbërëse të tyre, punimin dhe përmasat e caktuara në specifikimet teknike. Mungesa e mostrës dhe e lëndës së parë që shoqëron ato është kusht s'kualifikues.

Pra, Autoriteti Kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike krijon konfuzion në kundërshtim me sa parashikuar në nenin 2 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik?”, ndërkohë që në nenin 3 (Parimet ligjore) citohet në mënyrë të drejtëpërdrejtë se: “Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me

transparencë e në mënyrë proporcionale. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar”

Theksojmë gjithashtu se në 36 të LPP-së citoher shprehimisht se: “2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. 3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar: a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën?”

Mbështetur në sa mësipër kërkohet saktësimi dhe modifikimi i shtojces 6 në lidhje me produktin Çizme Zjarrduruese, konkretisht duke dhënë një specifikim të qartë dhe të njëtrajtshëm në lidhje me ngjyrën e Çizmeve Zjarrduruese”.

KSHA për sa më sipër, pas shqyrtimit dhe verifikimit të dokumentacionit, konstaton si më poshtë: Në lidhje me këtë pretendim sqarojmë se ka patur një lapsus ana e AK, në tabelën me të dhëna e ngjyrës, sikurse është e specifikuar qartazi në shtojcën 6 të DST, në përshkrimin e të dhënave dhe specifikimeve teknike për artikullin “Çizme zjarrëduruese”, si pjesë përbërëse e “Uniformës zjarrëduruese”, të cilat duhet të jenë ngjyrë e zezë. AK me lejin për vijimin e hapave të mëtejshëm të procedurës do të përfshijë këtë pikë në shtojcën sqaruese për dokumentat standarte të tenderit.

Përsa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

1.4 Së katërti, pala ankimuese pretendon si më poshtë vijon:

“Në shtojcën 8, Kriteret e Vecanta për Kualifikim, pika 2.4.3 nga ana e Autoritetit Kontraktor është kërkuar që Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim/et e prodhues/ve ose distributor/ve të autorizuar (në këtë rast duhet të provohet lidhja midis prodhuesit dhe distributorit nëpërmjet një autorizimi mes tyre) për të gjitha mallrat objekt prokurimi për të cilat nuk është vetë prodhues. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit dhe/ose distributorit të autorizuar si: telefon, fax, email, ëbsite, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku të deklarojë prodhuesit e të gjitha mallrave objekt prokurimi me të dhënat e kontaktit.

Nga ana e Autoritetit Kontraktor në argumentimin e këtij kriteri për kualifikim deklarohet se: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 4, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 8, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është

përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues. Në këtë kontekst, është domosdoshmërisht në dobi të përfituesve finale dhe produkteve/shërbimeve më cilësore, pra, garanci për zbatimin me rigorozitet të furnizimit të mallit. Në këtë mënyrë provohet dhe aftësia reale e operatorit ekonomik për të realizuar kontratën në cilësi, sasi e kohë. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar?..

Sikurse kemi theksuar dhe më sipër, të gjitha produktet e parashikuara në Lotin I, pjesë përbërëse e Uniformës zjarrduruese, prodhohen jashtë Shqipërisë në përputhje me specifikimet teknike të hartuara nga Autoriteti Kontraktor. Ato testohen dhe Çertifikohen konform normave dhe standarteve të miratuara ndërkombetare. Duhet theksuar se gjendemi përpara një procedure prokurimi mallrash me një specifike të vecantë, të percaktuara me VKM dhe sigurimi i tyre kryhet nëpërmjet importit duke marrë parasysh specifikën e vecantë të produkteve të kërkuara.

Sqarojmë se në mometin e hartimit të këtij kriteri për kualifikim nga ana e Autoritetit Kontraktor duhet të kërkohet gjithashtu Katalog ose Skedë Teknike e modelit konkret që ofrohet për çdo produkt, pasi i njëjti prodhues mund të prodhojë modele të ndryshme të produkteve që kërkohen, me karakteristika të ndryshme dhe me çertifikime të ndryshme. Sa më sipër paraqitja e Katalogut ose skeda teknike të prodhuesit është një element thelbësor ku tregohen karakteristikat teknike të produkteve të ofruara, të cilat duhet të përmbushin plotësisht specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor dhe të ofruara nga operatori ekonomik. Një kërkesë saktësisht e tillë është parashikuar nga i njëjti AK edhe në procedurën e prokurimit me objekt “BLERJE AUTOMJETE ZJARRFIKËSE” Nr. REF-13327-07-16-2024 zhvilluar me 16/08/2024.

Sa më sipër, lidhur me kërkesën për paraqitjen e deklaratës me të dhënat e prodhuesve, duhet të cilësohet përkatësisht modeli produktit që do të ofrohet si dhe origjina e tij.

Duke qenë se këto produkte, sic kemi deklaruar, importohen të gatshëm nga jashtë Shqipërisë në përputhje me specifikimet teknike, nga ana e Autoriteti Kontraktor duhet të specifikohet si element shtesë në pikën 2.4.3 edhe paraqitja e Skedave Teknike si dhe deklarimi i Origjinës si element thelbësorë në vlerësimin e ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë ofertues në Lotin I të kësaj procedure prokurimi”.

KSHA për sa më sipër, pas shqyrtimit dhe verifikimit të dokumentacionit, konstaton si më poshtë: Në lidhje me këtë kërkesë të operatorit ekonomik ankimues, AK nuk e sheh të të domosdoshme paraqitjen e skedave teknike/katalogëve për mallrat objekt prokurimi. Gjykojmë se për vlerësimin e operatorëve ekonomikë janë të mjaftueshme kriteret e vendosura si, certifikatat e produktit dhe Raport-Testimet përkatëse të përmendura në argumentim, për të percaktuar se, mallrat e ofruara përputhen me Specifikimet teknike të VKM-së për uniformat e MZSH.

Në VKM Nr. 1153, datë 24.12.2020 “Për miratimin e uniformës, shenjave dalluese përkatëse, Flamurit dhe Stemës së shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi” është e percaktuar qartë dhe AK nuk mund të devijojë nga këto specifikime teknike kështu që, paraqitja e skedave teknike/katalogëve për këto mallra janë të panevojshëm dhe rrisin kostot e OE pjesëmarrës duke

krijuar konfuzion dhe shërben si bazë për të krijuar devijime nga OE pjesëmarrës ndaj specifikimeve teknike të miratuar në VKM-në e sipërcituar.

Përsa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

1.5 Së pesti, pala ankimuese pretendon si më poshtë vijon:

“Në shtojcën 8, Kriteret e Vecanta për Kualifikim pika 2.4.5 nga Autoriteti kontraktor është parashikuar si vijon: Operatori ekonomik për të asistuar stafin e AK gjatë procesit të prodhimit/ qepjeve/ përmasave apo modifikimeve për realizimin e uniformës së punonjësit të shërbimit zjarrfikës, duhet të ketë në stafin e tij, jo më pak se 10 (dhjetë) punonjës për 3 muajt e fundit. Paraprakisht duhet vënë në pah se në argumentimin e dhënë nga Autoriteti kontraktor në lidhje me numrin e punonjësve deklarohet se:

Operatori ekonomik për të asistuar stafin e AK gjatë procesit të prodhimit/ qepjeve/ përmasave apo modifikimeve për realizimin e uniformës së punonjësit të shërbimit zjarrfikës, duhet të ketë në stafin e tij:

Për Lotin 1: jo më pak se 10 (dhjetë) punonjës për 3 muajt e fundit

Për Lotin 1: jo më pak se 5 (pesë) punonjës për 3 muajt e fundit

Nga ana e Autortetit Kontraktor, në argumentimin e dhënë kerkohet në mënyrë të përsëritur për Lotin 1 një here 10 punonjës dhe herën e dytë 5 punonjës. Kjo çon menjëherë në një konfuzion tek operatorët ekonomikë pjesëmarrës të cilët do t'i referohen argumentimit të autoritetit kontraktor si element thelbësor për të verifikuar nëse këto kritere janë hartur në mbështetje me legjislacionin për prokurimin publik. Konkretisht në neni 2 të LPP-së citohet shprehimisht se Autoriteti Kontraktor duhet: dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Mbështetur në deklarinimin e numrit të punonjësve në argumentimin e kriterëve të vecanta për kualifikim nga ana e autoritetit kontraktor gjendemi përpara një situatë konfuze dhe të paqartë e cila do të krijonte paqartësi në operatorët ekonomikë pjesëmarrës në lidhje me numrin e punonjësve të kerkuar në këtë procedurë prokurimi, në momentin kur do të lexohen argumentimet e dhëna nga Autoriteti Kontraktor në mbështetje të kriterit të vecantë për kualifikim pika 2.4.5.

Në vijim të këtij argumentimi nga Autoriteti Kontraktor deklarohet se: Kërkesa është hartuar në përputhje me VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, Neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, pika 5 “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ??c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit?”, si dhe..Objekti i procedures se prokurimit “Uniforma dhe veshje speciale” përfshin në vetvete edhe procesin e prodhimit të uniformës së MZSH-së, Shërbimit Zjarrfikës, pra përmban në vetvete elemente shërbimi për të cilën është e nevojshme që nga ofertuesit e mundshëm ekonomike të disponohet edhe një staf i cili të bëjë të mundur realizimin me sukses të këtij procesi për realizimin e uniformës së punonjësit të shërbimit zjarrfikës me anë të së cilës ata përfaqësojnë institucionin e Bashkisë Tiranë. Specialistët/ punonjësit e kerkuar

janë të nevojshëm për procesin e prodhimit/ qepjeve apo modifikimeve në rast se do të jetë e nevojshme të mallrave objekt prokurimi.

Po në lidhje me këtë argumentim të dhënë, theksojmë paraprakisht se në kriterin e vecantë për kualifikim, pika 2.4.5, çuditërisht nga Autoriteti Kontraktor është kërkuar vetëm një numër prej 10 punonjësish, duke mos specifikuar në asnjë moment cilësinë, të cilën duhen të disponojnë këta të fundit sic pretendohet në argumentimin e këtij kriteri, konkretisht ku deklarohet se: “Specialistët/punonjësit e kërkuar janë të nevojshëm për procesin e prodhimit/ qepjeve apo modifikimeve në rast se do të jetë e nevojshme të mallrave objekt prokurimi. Kjo lë shteg për një interpretim të vetë operatorëve ekonomikë pasi në listen e punonjësve përfshihet cdo lloj punonjësi si sanitare, punonjesit e shërbimit, shoferë etj., duke sjellë konfuzion dhe paqartësi në hartimin e ofertës ekonomike. Pra kriteri i hartuar bie vetë ndesh me argumentimin e dhënë nga autoriteti kontraktor i cili i drejtohet një kategorie të vecantë punonjësish.

Në nenin 2 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ?ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik?”, ndërkohë që në nenin 3 (Parimet ligjore) citohet në mënyrë të drejtëpërdrejtë se: “?Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar?”

Ndërkohë, elementi thelbësor i cili duhet të kundërshtohet në këtë kriter kualifikimi është vetë parashikimi i stafit prej 10 punonjësve në listëpagesat e operatorëve ekonomikë, në momentin kur të gjithë Operatorët ekonomikë në Shqipëri, sic është përmendur edhe më sipër duke marrë parasysh specifikën e produkteve të kërkuara Uniformat Zjarrëduruese, i importojnë këto produkte dhe nuk i prodhojnë në vendin tone. Argumenti i dhene nga AK se?. “Objekti i procedures se prokurimit “Uniforma dhe veshje speciale” përfshin në vetvete edhe procesin e prodhimit të uniformës së MZSH-së, Shërbimit Zjarrfikës, pra përmban në vetvete elemente shërbimi për të cilën është e nevojshme që nga ofertuesit e mundshëm ekonomike të disponohet edhe një staf i cili të bëjë të mundur realizimin me sukses të këtij procesi për realizimin e uniformës së punonjësit të shërbimit zjarrfikës me anë të së cilës ata përfaqësojnë institucionin e Bashkisë Tiranë” nuk qëndron pasi të gjitha produktet importohen te gatshme në Shqipëri. Nga ana tjetër asnjë operator ekonomik nuk mund të ndërhyjë apo të kryejë modifikime të këtyre produkteve pasi çënohet drejtperdrejt certifikimi i tyre.

Përcaktimi i numrit të punonjësve prej 10 punonjësish është i ekzagjeruar dhe ndikon në mënyrë të drejtëpërdrejtë në pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë duke limituar konkurrencën, pasi automatikisht te drejton ose në një Operator Ekonomik të paracaktuar duke krijuar një trajtim të pabarabartë dhe diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e

prokurimit public ose duke i detyruar pjesëmarrësit në këtë procedure prokurimi drejt bashkimit të Operatorëve Ekonomikë. Kjo e fundit limiton në mënyrë të drejtëpërdrejtë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në këtë procedure prokurimi, konkretisht të shoqërive të cilat i importojnë këto produkte pasi nuk prodhohen në Shqipëri.

Pra gjendemi përballë një situatë ku ndikohet në mënyrë të drejtëpërdrejtë dhe artificiale në pjesëmarrjen e operatorëve të tjerë ekonomikë, të cilët janë të interesuar të marrin pjesë në këtë procedure prokurimi, duke i importuar këto produkte në mënyrë që të ofertojnë në mënyrë të pavarur, duke krijuar një situatë diskriminuese, si dhe duke çënuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë parimin e barazisë të pëcaktuar në nenin 2 dhe 3 dhe konkretisht në nenin 2 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ?ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik?”, ndërkohë që në nenin 3 (Parimet ligjore) citohet në mënyrë të drejtëpërdrejtë se: “?Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar?”.

Duhet shtuar gjithashtu se në Lotin 1, po të verifikohet sasia e lëvrimin të Uniformave Zjarrduruese është v 150 komplete dhe janë kërkuar 10 punonjës, ndërkohë që në Lotin 2 “Veshje Pune” ku përfshihen, kostumet e dimrit, të verës, xhupa, këmbë, kravatat, kepuce etj. me sasi relativisht me të madhe, të cilat theksojmë se prodhohen në Shqipëri janë kërkuar vetëm 5 punonjës.

Nga ana e Autoritetit kontraktor cuditërisht, nuk është dhënë asnjë argumentim Teknik dhe ligjor në lidhje me përcaktimin e numrit të punonjësve të parashikuar për secilin nga Lotet, ndërkohë që të gjitha Produktet e Lotit I importohen të gatshme dhe vijnë të paketuara si produkt i përfunduar ndërsa produktet e Lotit II mund të prodhohen edhe në Shqipëri.

Pra, ritheksojmë sërish se nga ana e Autoritetit Kontraktor, nuk është dhënë asnjë justifikim në lidhje me numrin e ndryshëm të numrit të punonjësve të kërkuar në Lotin I, duke marrë parasysh vetë faktin se të gjitha produktet të kërkuar në Lotin I importohen të gatshme në Shqipëri. Në nenin 2 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ?ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik?”, ndërkohë që në nenin 3 (Parimet ligjore) citohet në mënyrë të drejtëpërdrejtë se: “?Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. Autoritetet

dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar?”

Po në lidhje me këtë kriter është konstatuar se nga Autoriteti Kontraktor në Procesverbalin për argumentimi dhe botimin e Kriteve të Vecanta për Kualifikim, nuk është dhënë asnjë argumentim në lidhje me numrin e punonjësve të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në këtë procedurë prokurimi.

Nga ana tjetër, rikujtojmë Autoritetin Kontraktor se në procedurën e zhvilluar po nga ky Autoritet me objekt “BLERJE AUTOMJETE ZJARRFIKËSE” Nr. REF-13327-07-16-2024 zhvilluar me 16/08/2024, nuk ka patur një kërkesë të tillë kualifikimi sic është disponimi i punonjësve pavarësisht se publikisht dihet që ne Shqipëri ka prodhues të këtyre mjeteve.

Theksojmë se në VKM Nr. 285 “Për rregullat e prokurimit publik” të ndryshuar, Neni 78, pika 2 cilësohet se: “Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në varësi të objektit të prokurimit, nëse nuk është vlerësuar e nevojshme caktimi i një specialisti fushe, hartimi i kërkesave si më sipër bëhet nga njësi e prokurimit. Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit. Seti përfundimtar i dokumenteve të tenderit nënshkruhet në çdo faqe nga anëtarët e njësisë së prokurimit”.

Mbështetur në sa më sipër nga ana e autoritetit kontraktor kërkohet modifikimi i kriterit kualifikues 2.4.5 të parashikuara në kriteret e vecanta për kualifikim, duke modifikuar numrin e punonjësve të kërkuar për procedurën e Lotit I si dhe të modifikojë Procesverbalin për argumentim dhe botimin e Kriteve të Vecanta për Kualifikim, duke paraqitur argumentimet perkatëse në lidhje me Numrin e Punonjësve të kërkuar në Lotin I “Uniforma Zjarrdurruese”. Të riformulohet ky kriter duke hequr kërkesën? “për të asistuar stafin e AK gjatë procesit të prodhimit/ qepjeve/ përmasave apo modifikimeve për realizimin e uniformës së punonjësit të shërbimit zjarrfikës”.

KSHA për sa më sipër, pas shqyrtimit dhe verifikimit të dokumentacionit, konstaton si më poshtë:

Ky kriter është përcaktuar referuar VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, pika 5, ku citohet se: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit...”, si dhe pika 8: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Sqarojmë se, një numër minimal punonjësish tregon aftësinë e operatorit ekonomik për të përballuar me burime njerëzore të mjaftueshme kërkesat e kontratës, sidomos në projekte komplekse, si ajo e uniformave zjarrfikëse.

Ky kriter garanton që operatori ekonomik ofertues ka kapacitete të mjaftueshme për të kryer furnizimin në kohë dhe në cilësinë e kërkuar për përmbushjen e kontratës.

Gjithashtu, numri i punonjësve është vendosur për të asistuar AK gjatë fazës së marrjes së masave, përgatitjen e uniformave sipas kërkesave të AK, konfeksionimi i tyre, transporti pranë magazinës së AK, etj.

Në seksionin 2, “Kriteret e vecanta për kualifikim”, pika 2.4 Kërkesa të tjera të vecanta për kualifikim, nën-pika 2.4.5 Operatori ekonomik për të asistuar stafin e AK gjatë procesit të prodhimit/ qepjeve/ përmasave apo modifikimeve për realizimin e uniformës së punonjësit të shërbimit zjarrfikës, duhet të ketë në stafin e tij, jo më pak se 10 (dhjetë) punonjës për 3 muajt e fundit të modifikohet në **7 punonjës për 3 muajt e fundit**, në mënyrë që të krijohet mundësia për pjesëmarrje sa më të lartë në këtë procedurë prokurimi.

Në procesverbalin e miratimit dhe argumentimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve të vecanta të kualifikimi, si me poshtë është bërë një lapsus:

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

2.4.5 Operatori ekonomik për të asistuar stafin e AK gjatë procesit të prodhimit/ qepjeve/ përmasave apo modifikimeve për realizimin e uniformës së punonjësit të shërbimit zjarrfikës, duhet të ketë në stafin e tij:

Për Lotin 1: jo më pak se 10 (dhjetë) punonjës për 3 muajt e fundit

Për Lotin 1: jo më pak se 5 (pesë) punonjës për 3 muajt e fundit

Pra, në rreshtin e dytë duhet të saktësohet si vijon:

[“Për Lotin 2”:.....**]AK me lejimin për vijimin e hapave të mëtejshëm të procedurës do të përfshijë këtë pikë në shtojcën sqaruese për dokumentat strandarte të tenderit.**

Përsa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

1.6 Së gjashti, pala ankimuese pretendon si më poshtë vijon:

“Në shtojcën 8, Kriteret e Vecanta për Kualifikim, pika 2.4.6 nga Autoriteti Kontraktor është parashikuar që: Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qera këto pajisje:

1 (një) makineri qëndisje;

1 (një) linjë stampimi me serigrafi (makineri stampimi, furrë tharje stampimi dhe presë për ngjitjen e logove).

Për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentat që vertetojnë pronësinë e tyre ose marrjen me qera të tyre: (faturë tatimore të shitblerje/aktet e zhdoganimit, origjinale ose fotokopje të noterizuar, ose cdo lloj akti tjetër ligjor që vërteton pronësinë ose kontratë qeraje të noterizuar). Për makineritë me qera duhet të përgatitet kontrata e qerasë e lidhur para noterit, me afat për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt prokurimi, e shoqëruar me dokumentacionin që vërteton pronësinë e qeradhënësit (fatura tatimore ose zhdoganimi ose cdo lloj tjetër ligjor që vërteton pronësinë e qeradhënësit).

Theksojmë, se ky kriter dhe vetë argumentimi i dhënë nga Autoriteti Kontraktor shërbejnë vetëm për Veshjet e punës sipas Lotit II të cilat mund të prodhohen në vendin tonë dhe jo për uniformat zjarreduruese të cilat importohen të përfunduara e të paketuara duke u shoqëruar me certifikimin konform normave dhe standarteve të miratuara ndërkombetare, si dhe me skedën teknike e cila është element thelbësor në përcaktimin e plotësimit të të gjithë specifikimeve teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor për këto produkte specifike të deklaruara në këtë procedurë prokurimi.

Në lidhje me këtë argumentim të dhënë, theksojmë paraprakisht se në kriterin e vecantë për kualifikim, pika 2.4.6 nga Autoriteti Kontraktor është kërkuar Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qera këto pajisje: 1 (një) makineri qëndisje; 1 (një) linjë stampimi me serigrafi (makineri stampimi, furrë tharje stampimi dhe presë për ngjitjen e logove)

Në rastin konkret duhet sqaruar se edhe në lidhje me këtë kriter kualifikues të hartuar nga Autoriteti Kontraktor, duhet theksuar se produktet e parashikuara në Lotin I, janë produkte të cilat importohen, pasi nuk prodhohen në Shqipëri. Këto produkte vijnë të përfunduara dhe të konfeksionuara dhe për pasojë nuk mund të kryhen ndërhyrje në lidhje me këto produkte të përfunduara. Sqarojmë se ndërhyrja në këto Uniforma cënon origjinën dhe certifikimin e tyre.

Nga ana e Autoritetit Kontraktor, në argumentimin e këtij kriteri për kualifikim deklarohet se: Referuar specifikimeve teknike dhe kërkesave të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor për realizimin e këtij objekti prokurimi dhe realizimin e proceseve të punës sa më sipër cituar lind e nevojshme edhe disponimi i makinerive të kërkuara duke qenë se, vetë projekti është një ndërthurje e zërave të mallit me ato të shërbimit sikundër janë procesi i dizenjimit dhe prodhimit të uniformës së MZSH-së, Shërbimit Zjarrfikës, ndaj është e nevojshme që nga ofertuesit të mundshëm ekonomike të disponohen edhe pajisjet/ makineritë për të bërë të mundur realizimin me sukses të këtij procesi për realizimin e uniformës. Pajisjet/ makineritë e kërkuara janë të nevojshme për procesin e prodhimit/ qepjeve apo modifikimeve në rast se do të jetë e nevojshme të mallrave objekt prokurimi?

Argumentimi i dhënë nga AK, si më sipër, nuk qëndron pasi:

a) Referuar Procesverbalit të hartuar nga AK, për Argumentimin dhe miratimin e Specifikimeve Teknike dhe Kriteve për kualifikim, Tipi i kontratës është Mallra. Pra Autoriteti kontraktor bie ndesh me argumentimin e tij pasi nuk kemi të bëjmë me shërbime.

b) Te gjithë elementet/produktet e Uniformës Zjarrduruese, sipas VKM Nr. 1153, datë 24.12.2020 “Për miratimin e uniformës, shenjave dalluese përkatëse, Flamurit dhe Stemës së shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi” si më poshtë:

1. UNIFORMA MBROJTËSE NGA ZJARRI (XHAKETA & PANTALLONAT)
2. DOREZAT PËR MBROJTJE NGA ZJARRI
3. KAPUÇI MBROJTËS PËR ZJARRFIKËSIN
4. HELMETA PËR ZJARRFIKËS & SISTEMI PËR NDRIÇIM
5. ÇIZMET MBROJTËSE NGA ZJARRI

janë produkte të cilat prodhohen, çertifikohen jashtë vendit tonë dhe importohen në Shqipëri si produkte të gatshme të shoqëruara me Çertifikatën përkatëse dhe me Çertifikatën e origjinës.

c) Dizenjimi, prodhimi dhe çertifikimi i tyre janë të përcaktuara qartësisht në VKM Nr. 1153, datë 24.12.2020.

d) Nuk mund të kryhet asnjë lloj dizenjimi apo modifikimi mbi produktet e Uniformes zjarrduruese pasi bie ndesh me VKM Nr. 1153, datë 24.12.2020 si dhe çënohet origjina dhe Çertifikimi i tyre.

Parashikimi i këtij kriteri nga Autoriteti Kontraktor rezulton i ekzagjeruar dhe ndikon në mënyrë të drejtëpërdrejtë në pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë duke limituar konkurrencën, automatikisht të drejton ose në një Operator Ekonomik të paracaktuar, duke krijuar një trajtim të pabarabartë dhe diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik, si duke i detyruar pjesëmarrësit në këtë procedure prokurimi drejt bashkimit të Operatorëve Ekonomikë. Kjo e fundit limiton në mënyrë të drejtëpërdrejtë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në këtë procedure prokurimi, konkretisht të shoqërive të cilat i importojnë këto produkte dhe nuk i prodhojnë në shqipëri.

Pra edhe në rastin e hartimit të këtij kriteri, nga ana e Autoritetit Kontraktor gjendemi përballë një situatë ku ndikohet në mënyrë të drejtëpërdrejtë dhe artificiale në pjesëmarrjen e operatorëve ekonomike, të cilët janë të interesuar të marrin pjesë në këtë procedure prokurimi, por i importojnë këto produkte që të ofertojnë në mënyrë të pavarur, duke krijuar një situatë diskriminuese, si dhe duke çënuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë parimin e barazisë të përcaktuar në nenet 2 dhe 3 dhe konkretisht në nenin 2 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik?”, ndërkohë që në nenin 3 (Parimet ligjore) citohet në mënyrë të drejtëpërdrejtë se: “?Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar?”.

Mbështetur në sa mësipër nga ana e Autoritetit Kontraktor kërkohet modifikim i kriterit kualifikues, lidhur me kërkesën për makineri, mbështetur në argumentimet e dhëna nga ana jonë si dhe duke marrë parasysh faktin e importimit të Uniformave Zjarrduruese nga operatorë ekonomikë që operojnë në këtë sektor të vecantë të tregut dhe se asnjë operator ekonomik nuk mund të ndërhyjë apo të kryejë modifikime të këtyre produkteve pasi çënohet drejtpërdrejt VKM dhe çertifikimi i tyre”.

KSHA për sa më sipër, pas shqyrtimit dhe verifikimit të dokumentacionit, konstaton si më poshtë: Në lidhje me këtë argumentim, KSHA sqaron se nuk mund të konsiderohet fakt i pakundërshtueshëm se të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës do të importojnë mallrat objekt prokurimi. Nga testimi i tregut që, grupi i punës/specialistët e fushës kanë realizuar rezulton se, një pjesë e konsiderueshme e operatorëve që kanë në objektin e veprimtarisë së tyre prodhimin e këtyre mallrave, i prodhojnë ato brenda vendit, si rrjedhojë nuk mund të merren në konsideratë vetëm operatorët ekonomikë që i importojnë këto produkte. Megjithatë, vendosja e këtij kriteri nuk çënon VKM-në përkatëse të përcaktimit të uniformës zjarrëduruese apo certifikimin e mallrave, pasi nuk do të ndërhyhet në strukturën e uniformës por do të vendoset logo e AK, sic është kërkuar në DST.

Përfshirja e këtyre pajisjeve, si kusht në kriteret e vecanta të kualifikimit siguron që, operatorët ekonomik të kenë kapacitetin e nevojshëm prodhues për të përmbushur sasi të kërkuara. Kjo shmanget rreziqet e vonës dhe garanton që prodhuesi ka mjetet për të përballuar me sukses realizimin dhe përmbushjen në kohë dhe sipas afateve të procedurës, objekt prokurimi.

Në mënyrë që t'i vijë në ndihmë OE pjesëmarrës që importojnë këto mallra, sic pretendon se është edhe operatori që ka paraqitur ankesën, KSHA vendos që, për kriterin e vendosur në seksionin 2, “Kriteret e vecanta për kualifikim”, pika 2.4.6 “Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qera këto pajisje:

- ☐ 1 (një) makineri qëndisje;
- ☐ 1 (një) linjë stampimi me serigrafi (makineri stampimi, furrë tharje stampimi dhe presë për ngjitjen e logove)

Për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre ose marrjen me qera të tyre: (faturë tatimore të shitblerje/aktet e zhdoganimit, origjinale ose fotokopje të noterizuar, ose cdo lloj akti tjetër ligjor që vërteton pronësinë ose kontratë qeraje të noterizuar). Për makineritë me qera duhet të përgatitet kontrata e qerasë e lidhur para noterit, me afat për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt prokurimi, e shoqëruar me dokumentacionin që vërteton pronësinë e qeradhënësit (fatura tatimore ose zhdoganimi ose cdo lloj tjetër ligjor që vërteton pronësinë e qeradhënësit)”, ta modifikojë për t'i dhënë mundësi cdo OE pjesëmarrës jo prodhues, si më poshtë:

“2.4.6 Operatori ekonomik ofertues/ prodhues i uniformave duhet të ketë në pronësi ose me qera këto pajisje:

- 1 (një) makineri qëndisje;
- 1 (një) linjë stampimi me serigrafi (makineri stampimi, furrë tharje stampimi dhe presë për ngjitjen e logove)

Për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentat që vertetojnë pronësinë e tyre ose marrjen me qera të tyre: (faturë tatimore të shitblerje/aktet e zhdoganimit, origjinale ose fotokopje të noterizuar, ose cdo lloj akti tjetër ligjor që vërteton pronësinë ose kontratë qeraje të noterizuar). Për makineritë me qera duhet të përgatitet kontrata e qerasë e lidhur para noterit, me afat për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt prokurimi, e shoqëruar me dokumentacionin që vërteton pronësinë e qeradhënësit (fatura tatimore ose zhdoganimi ose cdo lloj tjetër ligjor që vërteton pronësinë e qeradhënësit).

(Në rastin kur OE pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi nuk është prodhues i artikujve, atëherë duhet të paraqesë dokumentacionin për këto pajisje nga prodhuesi i cili ka marrë autorizimin përkatës për tregtimin e tyre).

Përsa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimes qëndron.

1.7 Së shtati, pala ankimuese pretendon si më poshtë vijon:

“Në shtojcën 8, Kriteret e Vecanta për Kualifikim pika 2.4.7 nga Autoriteti kontraktor është parashikuar si vijon: Operatorët ekonomik ofertues, duhet të paraqesë të paketuara dhe të protokolluara mostra për të gjithë artikujt objekt prokurimi, si më poshtë:

a) nga një mostër fizike për objektet e uniformës (produkt të gatshëm) që do të prokurohen që përfshin të gjitha detajet, llojin e materialit dhe pjesëve përbërëse të tyre, punimin dhe përmasat e caktuara në specifikimet teknike. Mungesa e mostrës dhe e lëndës së parë që shoqëron ato është kusht s'kualifikues.

b) Mostrat do të paraqiten në datën dhe orën e hapjes së ofertave pranë Autoritetit Kontraktor Drejtoria e Prokurimeve Administrative dhe Shërbimeve, Bashkia Tiranë, me adresë: Sheshi Skënderbej, Nd. 2”, Tiranë.

c) Mostrat e paraqitura duhet të kenë të trupëzuar një etiketë të qepur, e cila të përmbajë: mostër “emri i artikullit”, Objektin e Procedurës/ Lotin për të cilin oferton, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e prodhuesit/ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik, të identifikueshme me numrin rendor përkatës në etiketë (sipas numrit rendor të tabelave, psh: Loti 2: Veshje Pune, Nr.1- Kapele, referuar “Shtojca 3”/ shtojcës 7).

Mosparaqitja e mostrave sipas kërkesave të mësipërme përbën kusht s'kualifikimi për vazhdimin e procedurave.

Në rastin konkret, nga ana jonë janë kundërshtohet pika a) dhe c) e parashikuar në kriterin 2.4.7 të sipërpërmendur nga ana e Autortietit kontraktor, i cili deklaron që a) Mungesa e mostrës dhe e lëndës së parë që shoqëron ato është kusht s'kualifikues dhe c) mostrat e paraqitura nga operatorët ekonomikë të duhet të kenë të trupëzuar një etiketë të qepur, e cila të përmbajë: mostër “emri i artikullit”, Objektin e Procedurës/Lotin për të cilin oferton, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e prodhuesit/ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik, të

identifikueshme me numrin rendor përkatës në etiketë (sipas numrit rendor të tabelave, psh: Loti 1: Nr.1- Uniforme zjarrduruese, referuar “Shtojca 3”/ shtojcës 7).

Në rastin konkret duhet ritheksuar sërish se edhe në lidhje me këtë kriter kualifikues të hartuar nga Autoriteti Kontraktor, të gjitha produktet e parashikuara në Lotin I, janë produkte të cilat importohen si produkte të gatshme, pasi nuk prodhohen në Shqipëri. Këto produkte vijnë të përfunduara dhe të paketuara/ambalazhuara dhe për pasojë nuk mund të kryhen ndërhyrje në këto produkte të gatshme. Sqarojmë se këto produkte të importuara përmbushin të gjitha specifikimet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor, vetëm kur paraqiten me certifikatën e produktit, origjinës si dhe skedën teknike ku janë të specifikuar të gjithë elementët që përbëjnë në rastin konkret Uniformat Zjarrduruese.

Autoriteti kontraktor, nuk ka dhene asnjë argumentimin në përcaktimin e kërkesës për paraqitjen e lëndës së parë që shoqëron mostren. Kjo kërkesë rezulton krejtësisht e ekzagjeruar dhe e pamundur praktikisht pasi Uniforma Zjarrduruese ka në përbërje të saj disa produkte si: UNIFORMA MBROJTËSE NGA ZJARRI (XHAKETA & PANTALLONAT), DOREZAT PËR MBROJTJE NGA ZJARRI, KAPUÇI MBROJTËS PËR ZJARRFIKËSIN, HELMETA PËR ZJARRFIKËS & SISTEMI PËR NDRIÇIM, ÇIZMET MBROJTËSE NGA ZJARRI. Sikurse përcaktohet qartësisht edhe në VKM Nr. 1153, datë 24.12.2020 “Për miratimin e uniformës, shenjave dalluese përkatëse, Flamurit dhe Stëmës së shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi” por edhe në Specifikimet e Autoritetit kontraktor, secili nga produktet e Uniformes Zjarrduruese ka në përbërje të tij disa lloje materialesh si lende të pare.

Psh në rastin e helmetes për zjarrfikës duhet të jete e përbere me elementet si me poshte:

1. xham transparent me ngjyrë lumineshence,
2. amortizues të punuar nga poliuretani
3. materiale kompozite (fibra karboni), dhe poliuretanit (e integruar në poliuretan)
4. pjesa e brendshme e helmetës duhet të jetë e punuar nga materiale kompozite SMC
5. mbrojtës qafe të punuar prej fibrave karbonike dhe të trajtuara me alumin.
6. Rripi i mjekrës duhet të jetë nga materiali nomex etj etj

Psh në rastin e UNIFORMA MBROJTËSE NGA ZJARRI (XHAKETA & PANTALLONAT) duhet të jete e përbere me elementet si me poshte:

1. materiali i shtresës së jashtme duhet të jetë përzierje të fijeve aramidi 100% (me një përmbajtje prej se paku 23 % paraaramid dhe 2% fije karboni ngjyrë blu të errët)
2. Materiali për pengimin e depërtimit të fluideve, duhet të jetë membranë mikroporoze PTFE, me shtresa fine të polimereve të një performace të lartë në materialin bartës me përbërje 50% aramid dhe 50 % melamin të mbyllur, shkumëzime silikonit për mbajtje distance ose ekuivalente.
3. Materiali bartës për saldimin e qepjeve duhet të jetë membranë mikroporze dykomponentëshe nga politetraflouretileni i ekspanduar.
4. membranë ajrosëse (angl.: breathable) PTFE, e mbështjellë në të dyja anët nga aramid i petëzuar, i qëndrueshëm në larje dhe pastrim kimik.
5. astar të përhershëm rezistent ndaj zjarrit Nomex 50%.....

6. *Mbrojtëset (mbushjet ose jastëkët mbrojtës) nga materiale përherë të qëndrueshme në flakë, nga plastike joabsorbues që nuk thithin lagështi gjatë gjithë jetës*

7. *Zinxhiri i xhaketës duhet të jetë i pajisur me patentë paniku, si dhe dhëmbë madhësi prej 8mm.*

8. *Penjtë për qepje, materiali metaaramid për të gjitha qepjet, kurse ngjyra duhet të jetë identike me ngjyrën e materialit të jashtëm*

9. *Pjesa e përparme, e poshtme, e pantallonave, në zonën e gjunjëve duhet të jetë e pajisur me përforcime nga materiali me përbërje silikon/karbon.*

Lehtesisht lind pyetja cilen nga keto lende te para duhet te dorezohen bashke me mostren e produktit te gatshem HELMETA PËR ZJARRFIKËS apo UNIFORMA MBROJTËSE NGA ZJARRI (XHAKETA & PANTALLONAT)? Qartazi, sikurse kemi argumentuar edhe me siper, ne perputhje edhe me VKM kemi te bejme me disa lende te para te cilat gjate procesit te prodhimit integrohen dhe japin produktin e gatshem final. Analiza e mesiperme vlen per te gjitha produktet te cilat jane pjese e Uniformes Zjarrduruese.

Nga ana tjetër, duhet sqaruar se termi i perdorur nga AK “të kenë të trupëzuar një etiketë të qepur, e cila të përmbajë: mostër “emri i artikullit”, Objektin e Procedurës/Lotin për të cilin oferton, datën e zhvillimit të tenderit???” nuk është i qartë dhe ndikon drejtpërdrejt në skualifikimin e operatorëve ekonomike.

Trupëzimi i etiketes me te dhenat e kerkuara nga AK, me anë të qepjes në mostrat e dorezuara do t'i bënte këto mostra të papërdorshme në një procedure prokurimi tjetër ose në momentin kur këto produkte të paraqitura pranë Autoritetit Kontraktor do të ripërdoreshin nga operatorët ekonomikë importues për qëllime të tjera. Nga ana tjetër, duke qene se Uniformat Zjarrduruese për specifikat e parashikuara kanë kosto të lartë për blerjen e tyre, sikurse parashikohet edhe nga vete AK ne percaktimin e fondit limit prej 185867 leke/uniforme zjarrduruese, trupëzimi i etiketes se qepur do te sillte dem ekonomik te pajustifikuar per operatoret pjesemarres.

Trupëzimi i etiketes te qepur, sikurse Autoriteti e kerkon, detyron operatoret ekonomik te nderhyjne ne produktin e gatshem duke cenuar prodhimin dhe certifikimin e tij.

Kerkesa e Autoritetit do te ishte e sakte vetem nese ne ambalazhin/paketimin e secilit produkt do te ngjitej nje leter informuese me te dhenat e kerkuara nga Autoriteti.

Kerkesa e Autoritetit per paraqitjen e mostres me etikete te trupëzuar, limiton sërish në mënyrë të drejtëpërdrejtë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në këtë procedure prokurimi, konkretisht të shoqërive të cilat i importojnë këto produkte. Kjo kerkese mund te sherbeje vetem per produktet e Lotit II Veshjet e punes te cilat prodhohen ne Shqiperi.

Pra edhe në rastin e hartimit të këtij kriteri nga ana e Autoritetit Kontraktor gjendemi përballë një shtate ku ndikohet në mënyrë të drejtëpërdrejtë dhe artificiale në pjesëmarrjen e operatorëve ekonomike, të cilët janë të interesuar të marrin pjesë në këtë procedure prokurimi, por i importojnë këto produkte të cilët kanë një kosto të lartë për operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke krijuar një shtate diskriminuese, si dhe duke cenuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë pararimin e barazisë të pëcaktuar në nenet 2 dhe 3 dhe konkretisht në nenin 2 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet shprehimisht se: “Qëllim i

këtij ligji është c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik?”, ndërkohë që në nenin 3 (Parimet ligjore) citohet në mënyrë të drejtëpërdrejtë se: “Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar?”.

Mbështetur në sa më sipër nga ana e autoritetit kontraktor modifikimi i kriterit kualifikuese të parashikuar në pikën 2.4.7 dhe t'i kërkohet Autoritetit Kontraktor që heqë pikën ku deklarohet që mungesa e lendes se pare eshte kusht s'kualifikues dhe kërkesa qe mostrat e paraqitura duhet të kenë të trupëzuar një etiketë të qepur, e cila të përmbajë: mostër “emri i artikullit”, Objektin e Procedurës/ Lotin për të cilin oferton, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e prodhuesit/ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik, të identifikueshme me numrin rendor përkatës në etiketë si kriter që cënon në mënyrë të drejtëpërdrejtë parimin e barazisë të përcaktuar në nenet 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

KSHA për sa më sipër, pas shqyrtimit dhe verifikimit të dokumentacionit, konstaton si më poshtë: Në lidhje me këtë argument të operatorit ekonomik ankimues, sqarojmë se nga ana e grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike është bërë sërish një lapsus, i cili do të modifikohet si më poshtë:

Në pikën a) të Kriterit 2.4.7. bëhet modifikimi si më poshtë:

“a) nga një mostër fizike për objektet e uniformës (produkt të gatshëm) që do të prokurohen që përfshin të gjitha detajet, llojin e materialit dhe pjesëve përbërëse të tyre, punimin dhe përmasat e caktuara në specifikimet teknike. **Mungesa e mostrës është kusht s'kualifikues**”.

Përsa i përket pikës c) të Kriterit 2.4.7. bëhet modifikimi si më poshtë:

“c) Mostrat e paraqitura duhet të kenë një etiketë, e cila të përmbajë: mostër “emri i artikullit”, Objektin e Procedurës/Lotin për të cilin oferton, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e prodhuesit/ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik, të identifikueshme me numrin rendor përkatës në etiketë (sipas numrit rendor të tabelave, psh: Loti 2: Veshje Pune, Nr.1- Kapele, referuar “Shtojca 3”/ shtojcës 7)”.

Përsa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës pas vlerësimit të ankesës dhe pretendimit të operatorit ekonomik ankimues “**VICORIA AL**” sh.p.k, arrin në konkluzion se:

Pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “VICORIA AL” sh.p.k, qëndrojnë pjesërisht dhe vendosi:

VENDOSI:

- 1. Të pranojë pjesërisht ankesën e Operatorit ekonomik “VICTORIA AL” shpk, për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje uniforma dhe veshje speciale për MZSH-në, Loti 1 “Uniforma Zjarrëduruese” me Nr REF-28211-11-05-2024, me fond limit 27,880,050 (njëzetë e shtatë milionë e tetëqind e tetëdhjetë mijë e pesëdhjetë) lekë pa tvsh, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 06.12.2024, nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë.*
- 2. Autoriteti Kontraktor do të vërë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar (nëse ka) brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.*
- 3. Një kopje e vendimit i komunikohet me shkrim ankimesve dhe Komisionit të Prokurimit Publik.*

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, si dhe informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “1. Mbeshtetur ne sa mesiper kerkohet sakesimi dhe modifikimi i shtojces 6 ne lidhje me produktin Cizme Zjarrduruese, konkretisht duke dhene nje specifikim te qarte dhe te njetrajtshem ne lidhje Me ngjyren e cizmeve Zjarrduruese.”; pretendimin se “Nga ana e Autortetit Kontraktor, ne argumentimin e dhene kerkohet ne menyre te perseritur per Lotin 1 nje here 10 punonjes dhe heren e dyte 5 punonjes. Kjo con menjehere ne nje konfuzion tek operatoret ekonomike pjesemarres te cilet do t’i referohen argumentimit te autoritetit kontraktor si element thelbesor per te verifikuar nese keto kriteret jane hartur ne mbeshtetje me legjislacionin per prokurimin publik.”; pretendimin se “...kerkohet Autoritetit Kontraktor te heqe piken ku deklarohet qe mungesa e lendes se pare eshte kusht sikuallifikues dhe kerkesa qe mostrat e paraqitura duhet te kene te trupezuar nje etikete te qepur, e cila te permbaje: moster emri i artikullite, Objektin e Procedures/ Lotin per te cilin oferton, daten e zhvillimit te tenderit, emrin e prodhuesit/ofertuesit, nenshkrimin dhe vulen e operatorit ekonomik, te identifikueshme me numrin rendor perkates ne etikete si kriter qe cenon ne menyre te drejteperdrejte parimin e barazise te percaktuar ne nenet 2 dhe 3 te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publike” , Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në datë 24.01.2024, nëpërmjet postës elektronike, në adresën kpp_info@kpp.gov.al, protokolluar pranë KPP me nr. 3338/4 prot., datë 28.01.2024, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë KPP-së aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ku konstatohet se e ka pranuar pjesërisht atë, si më poshtë:

[...]

KSHA për sa më sipër, pas shqyrtimit dhe verifikimit të dokumentacionit, konstaton si më poshtë: Në lidhje me këtë pretendim sqarojmë se ka patur një lapsus ana e AK, në tabelën me të dhëna e ngjyrës, sikurse është e specifikuar qartazi në shtojcën 6 të DST, në përshkrimin e të dhënave dhe specifikimeve teknike për artikullin “Çizme zjarrëduruese”, si pjesë përbërëse e “Uniformës zjarrëduruese”, të cilat duhet të jenë ngjyrë e zezë. AK me lejin për vijimin e hapave të mëtejshëm të procedurës do të përfshijë këtë pikë në shtojcën sqaruese për dokumentat strandarte të tenderit.

Përsa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

[...]

Në procesverbalin e miratimit dhe argumentimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve të vecanta të kualifikimi, si më poshtë është bërë një lapsus:

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

2.4.5 Operatori ekonomik për të asistuar stafin e AK gjatë procesit të prodhimit/ qepjeve/ përmasave apo modifikimeve për realizimin e uniformës së punonjësit të shërbimit zjarrfikës, duhet të ketë në stafin e tij:

Për Lotin 1: jo më pak se 10 (dhjetë) punonjës për 3 muajt e fundit

Për Lotin 1: jo më pak se 5 (pesë) punonjës për 3 muajt e fundit

Pra, në rreshtin e dytë duhet të saktësohet si vijon:

[“Për Lotin 2”:.....**]**AK me lejin për vijimin e hapave të mëtejshëm të procedurës do të përfshijë këtë pikë në shtojcën sqaruese për dokumentat strandarte të tenderit.

[...]

KSHA për sa më sipër, pas shqyrtimit dhe verifikimit të dokumentacionit, konstaton si më poshtë: Në lidhje me këtë argument të operatorit ekonomik ankimues, sqarojmë se nga ana e grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike është bërë sërish një lapsus, i cili do të modifikohet si më poshtë:

Në pikën a) të Kriterit 2.4.7. bëhet modifikimi si më poshtë:

“a) nga një mostër fizike për objektet e uniformës (produkt të gatshëm) që do të prokurohen që përfshin të gjitha detajet, llojin e materialit dhe pjesëve përbërëse të tyre, punimin dhe përmasat e caktuara në specifikimet teknike. **Mungesa e mostrës është kusht s'kualifikues**”.

Përsa i përket pikës c) të Kriterit 2.4.7. bëhet modifikimi si më poshtë:

“c) Mostrat e paraqitura duhet të kenë një etiketë, e cila të përmbajë: mostër “emri i artikullit”, Objekti e Procedurës/Lotin për të cilin oferton, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e prodhuesit/ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik, të identifikueshme me numrin rendor përkatës në etiketë (sipas numrit rendor të tabelave, psh: Loti 2: Veshje Pune, Nr.1- Kapele, referuar “Shtojca 3”/ shtojcës 7)”.

Përsa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.”

III.1.2. Neni 30 i LPP, i ndryshuar parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.

III.1.3. Neni 115, pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili parashikon shprehimisht se :

“1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën për dokumentet e tenderit dhe në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit kur nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon procedurën për pjesën tjetër të ankesës dhe me mbylljen e shqyrtimit të çështjes duhet të shprehet me vendimmarrje deklarative për pjesën e pranuar sipas parashikimeve të shkronjës “ç” të pikës 2 të nenit 118 të këtij ligji, së bashku me vendimmarrje për pjesën tjetër.”

Për këtë arsye, KPP do të mbyllë shqyrtimin e çështjes në lidhje me këto pjesë të pranuar nga autoriteti kontraktor, për ankesën me nr. A2024/4781, dhe nr. 3338/2024 prot., datë 13.11.2024, të operatorit ekonomik “Victoria AL” SHPK.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Victoria AL” SHPK për modifikimin e kriterit të kualifikimit se “1. NE shtojcen 8, Kriteret e Vecanta per Kualifikim, pika 2.4.2 nga ana e Autoritetit Kontraktor eshte kerkuar ideshmi per rezultatet e testimave zyrtare (raporte testimi), te leshuara nga institucione te autorizuar, qe vertetojne pajtueshmerine e produkteve me specifikimet teknike, te materialeve perberese te produkteve te uniformes zjarrduruese te personelit operues (zjarrfikes), perkatesisht uniformes mbrojtese nga zjarri (xhaketa dhe pantallonat) + kapuái mbrojtës për zjarrfikesin + Dorezat për mbrojtje nga zjarri. (Raporte testimi për copën e përdorur për artikullin mostër, lëndës së parë që shoqëron atë dhe ajo që i bashkëngjitet fletë-analizës duhet të jenë detyruesisht të njëjta).

[...]

Nga ana e Autoritetit Kontraktor, kërkesa për paraqitjen e raporteve të testimit rezulton e paqarte pasi fillimisht kerkohen raporte testimi të materialeve perberese te produkteve te uniformes zjarrduruese por nga ana tjetër përcakton vetëm 3 nga 5 produktet e uniformes, konkretisht uniformen mbrojtese nga zjarri (xhaketa dhe pantallonat) + kapuci mbrojtës për zjarrfikesin + Dorezat për mbrojtje nga zjarri. Po nga Autoriteti kontraktor deklarohet se: Raporte testimi për copën e përdorur për artikullin mostër, lëndës së parë që shoqëron atë dhe ajo që i bashkëngjitet fletë-analizës duhet të jenë detyruesisht të njëjta.

Fillimisht, referuar VKM Nr. 1153, datë 24.12.2020, konkretisht për uniformen mbrojtese nga zjarri (xhaketa dhe pantallona) e cila përben vetëm njërin nga elementet e uniformes zjarrduruese (numri rendor 1) termi i përdorur nga AK “Raporte testimi për copën e nuk është i saktë, pasi sic çilesohet në VKM materialet perberese te uniformes përfshijnë shtresën e jashtme, materialin për pengimin e depërimit të fluideve, materialin bartes për saldimin e qepjeve, astarin, Pengesat absorbuese. Sa më sipër, termi i përdorur nga AK “copën” nuk gjendet në asnjë rresht të VKM-së për produktin uniforme mbrojtese nga zjarri (xhaketa dhe pantallona). Nga ana tjetër, Uniforma mbrojtese nga zjarri (xhakete pantallona), përvec shtresave, përmbajnë materiale të ndryshme si: mbrojtëset (mbushjet ose jashtëkëmbrojtës) si dhe aksesoret penjte për qepje, rripa, perforues, zinxhira, Shiritat velcro për mberthyerje (mbyllje) etj NE rastin konkret gjendemi përpara një kriteri të paqarte dhe diskriminues në momentin e interpretimit nga ana e një operatori ekonomik i cili kërkon të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi.

Paqartësia në hartimin e këtij kriteri për kualifikim themelor, ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në paraqitjen e një oferte të rregullt, transparente dhe proporcionale nga ana e operatoreve ekonomike, duke krijuar në këtë mënyrë ngushtim artificial të konkurrencës midis operatoreve ekonomike në shkëlqje hapazi të parimeve baze të përcaktuara në nenin 3 të LPP.[...], Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 8, Loti 1 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” në pikën 2.4.2 “Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë:

2.4.2 Dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare (raporte testimi), të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike, të materialeve përbërëse të produkteve të Uniformës zjarrduruese të personelit operues (zjarrfikës), përkatësisht *uniformës mbrojtëse nga zjarri (xhaketa dhe pantallonat) + Kapuçi mbrojtës për zjarrfikësin + Dorezat për mbrojtje nga zjarri.

(Raporte testimi për copën e përdorur për artikullin mostër, lëndës së pare që shoqëron atë dhe ajo që i bashkëngjitet fletë-analizës duhet të jenë detyruesisht të njëjta).

III.2.2. Në shtojcën 6 “Formulari i specifikimeve teknike”, të dokumenteve standarde të tenderit është parashikuar si vijon:

SPECIFIKIMET TEKNIKE: LOTI 1: “UNIFORMA ZJARRDURUESE”

1. UNIFORMA ZJARRDURUESE E PERSONELIT OPERUES (ZJARRFIKËS)-150 cope

Nr.	Artikulli	Sasia	Ngjyra
1.	Helmeta zjarrduruese	1	E kuqe, e verdhë
2.	Kapuç mbrojtës poshtë helmetës	1	Blu e errët
3.	Uniforma zjarrduruese Xhaketa zjarrduruese Pantallona zjarrduruese Çizme zjarrduruese Doreza zjarrduruese	1	Blu e errët

**SPECIFIKIMET
HELMETA PËR ZJARRFIKËS & SISTEMI PËR NDRIÇIM**

Helmeta për përdorim nga zjarrfikësit për mbrojtje kundër zjarrit e gjatë ndërhyrjeve operuese duhet të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare EN 443:2008 dhe EN 14458.

Helmeta duhet të jetë e llojit A3B,**, E2C.

Helmeta duhet të jetë e pajisur me një xham transparent me ngjyrë lumineshence (nuanca të buta ngjyrë portokalli), të punuara nga materiali PESU (*polyethersulfone*), për të rezistuar në temperatura të ngritura.

Në pjesën e brendshme duhet të jetë e pajisur me syza, sipas EN 166.

Rezistenca ndaj ndikimeve të jashtme

Helmeta duhet të jetë e pajisur me një amortizues të punuar nga poliuretani, i cili duhet të jetë i integruar në gëzhhojën e helmetës e që nuk mund të hiqet.

Në mes të gëzhhojës, e cila duhet të jetë e punuar nga materiale kompozite (fibra karboni), dhe poliuretanit (e integruar në poliuretan) duhet të jetë e integruar një gëzhhojë e dytë dhe një shkumë izoluese.



Për zjarrfikësin operues



: drejtuesin/komandantin e zjarrfikësit

Pjesa e brendshme e helmetës

- Duhet të jetë e punuar nga materiale kompozite SMC (nuk lejohen pjesë plastike për përforcime).
- Për t'iu përshtatur kokës, rregullimi i madhësisë së helmetës duhet të bëhet përmes një rregullatori i cili duhet të realizojë ndryshimin e madhësisë nga 52–64 cm.
- Gjerësia e jashtme e helmetës duhet të jetë në mes 236 mm–247 mm në zonën e veshëve, gjatësia nuk duhet të tejkalojë 316 mm dhe lartësia nuk duhet të tejkalojë 216 mm.
- Helmeta duhet të jetë ngjyrosur me ngjyrë lumineshence.
- Të dyja anët e helmetës duhet të pajisen me nga një shirit reflektues që shtrihen pothuajse përgjatë gjithë helmetës.
- Gjerësia e shiritit duhet të jetë në mes 24 mm–25 mm.
- Helmeta duhet të jetë e pajisur me një mbrojtës qafe të punuar prej fibrave karbonike dhe të trajtuara me alumin.
- Mbrojtësi duhet të lidhet me helmetën, përmes 3 pikave dhe duhet të jetë i lehtë për t'u hequr dhe instaluar.
- Helmeta duhet të mundësojë përdorimin e papenguar të maskës së aparatit të frymëmarrjes.
- Pesha totale së bashku me mbrojtësin e qafës nuk duhet të jetë më e madhe se 1,4 kg.
- Në pjesën ballore të helmetës duhet të jetë përcaktuar vendi për logo. Madhësia e vendit për logo duhet të jetë e gjerë rreth 65 mm–80 mm, kurse lartësia nga 65 mm–75 mm.
- Logoja e përdoruesit të fundit duhet të jetë e shtypur fabrikisht në anën e përparme të helmetës. Nuk lejohet ngjitja e etiketave të plastikës (*stickers*).
- Helmeta duhet të jetë rezistente në temperaturë deri në 1000°C për një periudhë kohore prej së paku prej 10 sec, në kontakt me fenomenin “*Flash over*”, si dhe i testuar në temperaturë 250°C në një kohëzgjatje prej 30 min.
- Helmeta duhet të ofrojë mbrojtje të plotë të kokës, duke përfshirë edhe qafën dhe fytyrën.
- Rripi i mjekrës duhet të jetë nga materiali nomex dhe i testuar për të mos shkaktuar irritime (alergji).
- Helmeta duhet të jetë e pajisur me llambë ndriçuese xenon dhe mbajtës përkatës, si dhe të mundësojë vendosjen e sistemit të komunikimit.

KAPUÇI MBROJTËS PËR ZJARRFIKËSIN

Kapuçi mbrojtës duhet të jetë i certifikuar në harmoni me standardet

EN13911:2005 & EN 1149-3.

- Struktura/përbërja;
- Strukturë/ndërtim dyshtresor;
- Materiali 100% Aramid;
- Ngjyra: blu e errët.



Madhësia duhet të jetë universale, kapuç me shtresë dopio, shtresë teke që vjen përpara si grykashkë, me një rreth të hapur rreth fytyrës me fund të rrafshët dhe strukturë tegelash, me qepje me fill nomex. Të gjitha të jenë një masë.

Nënkapela duhet të mundësojë vendosjen e papenguar të maskës. Nënkapela duhet të mbulojë në pjesë të madhe gjoksin, supet dhe shpinën.

UNIFORMA MBROJTËSE NGA ZJARRI (XHAKETA & PANTALLONAT)

Xhaketa dhe pantallonat për mbrojtje nga zjarri, duhet të jenë të punuara dhe të certifikuara në përputhje me standardin EN 469:2005, niveli 2 i mbrojtjes.

Përveç kësaj, xhaketa për mbrojtje nga zjarri duhet të plotësojë edhe standardin EN 469:2005, shtojca B.Prodhuesit ose subjekti që i trajton këto produkte është i detyruar të paraqesë certifikatat e vlefshme të produktit.

Në xhaketë, mbrapa, në pjesën e sipërme, do të vendoset një shirit me përmasa në lartësi 15 cm, dhe gjerësi sa ajo ndërmjet gavaturave. Ngjyra e shiritit do të jetë gri metalizato, mbi të cilën do të shkruhet me shkronja shtypi kapitale “MZSH”. Shkrimi do të jetë ngjyrë blu e errët. Përmasat e shkrimit do të jenë në lartësi 10 cm dhe gjerësi shkronje 1.8 cm, në përpjesëtim me masat trupore të uniformave;

Në pjesën e përparme të xhaketës duhet të jenë të qepura horizontalisht në pjesën e gjoksit. Një xhep për vendosjen e radiomarrësit duhet të vendoset në pjesën e përparme, afërsisht rreth 2 cm majtas nga shiriti i përparmë;



Rreth 9 cm mbi xhepin e radiolidhjes, duhet të jetë i vendosur një shirit me dimension 7.5x3 cm i cili do të shërbejë si mbajtës i mikrofonit dhe duhet të jetë nga materiali i sipërm;

Përveç kësaj, në anën e djathtë të pjesës së përparme nën tegelin e qepjes horizontale, duhet të jetë i vendosur mbajtësi i llambës ndriçuese;

- Dimensionet e përafërta të xhepit duhet të jenë 5.5 cm thellësi, gjerësia 8.5 cm dhe lartësia rreth 19 cm. Xhepi në pjesën e sipërme dhe të poshtme është i hapur. Në pjesën e sipërme është i fiksuar me ndihmën e një shiriti me dimension 5.5x11 cm, me shirit velcro.

Pjesa e pasme (shpina)

Pjesa e shpinës duhet të jetë e ndarë horizontalisht në dy seksione.

Mbishkrimet në shpinë duhet të jenë në një ose dy rreshta ku madhësia e shkronjave duhet të jetë rreth 6 cm. Ngjyra e sfondit duhet të jetë e verdhë flourishente, kurse e shkronjave e argjendtë;

Në shirit duhet të shkruhet “MZSH” apo ndonjë mbishkrim tjetër sipas marrëveshjes;

Ngjitja e mbishkrimit në shpinë duhet të bëhet me velcro ose e përhershme;

Xhakët e gjatë, minimumi i gjatësisë së xhaketës do të jetë 92 cm.

Xhepat anësore

Xhepat anësore duhet të jenë të futur brenda dhe të mbuluar me kapakë (me dimension afërsisht 22x7,5 cm). Të dy kapakët në pjesën e poshtme duhet të mbyllet me shirit velcro. Një shirit me një karabinë me kokë rrotulluese duhet të jetë e vendosur në kapakun e xhepit (madhësia rreth 7,5 cm).

Xhaketa duhet të jetë në tërësi e pajisur me astar të përhershëm rezistent ndaj zjarrit. Astarin nuk duhet të jetë i fiksuar në asnjë pikë me tegelat e qepjes.

Në pjesën e përparme, në anën e djathtë të astarit duhet të jetë i vendosur një xhep nga materiali i sipërm (i jashtëm) me përmasa afërsisht 18x2 cm, me kapak i cili mbyllet me shirit velcro me përmasa 2x2 cm. Një hapje për riparim duhet të ndodhet në pjesën e shpinës me gjerësi rreth 54 cm, kurse hapja tjetër në anën e djathtë me gjerësi rreth 28 cm.

Përshkrimi i detajuar në skicë

Duhet të jetë rezistente në temperatura të larta sipas EN 469;

Penjtë të jenë prej materiali kundër lagështisë dhe rezistente ndaj zjarrit;

Gavaturre të gjerë të mëngëve, për veprime të rehatshme;

Me zinxhir të tipit të qëndrueshëm dhe rezistent ndaj zjarrit dhe i mbuluar me kapak;

Jaka dhe bërrylat të jenë me përforcues;

Të ketë xhep të kraharorit për radio, me kapak mbrojtës, si dhe dy xhepa anësorë me kapak.

MATERIALET

Përbërja e materialeve të shtresës së jashtme

Pesha e materialit të shtresës së jashtme duhet të jetë afro 195g/m², që përbën përzierje të fijeve aramidi 100% (me një përmbajtje prej së paku 23 % paraaramid dhe 2% fije karboni ngjyrë blu të errët e ngjashme me RAL 5004) ose ekuivalente.

Ngjyra: blu e errët.

Materiali për pengimin e depërtimit të fluideve.

Duhet të jetë membranë mikroporoze PTFE, me shtresa fine të polimereve të një performancë të lartë në materialin bartës me përbërje 50% aramid dhe 50 % melamin të mbyllur, shkumëzime silikonit për mbajtje distance ose ekuivalente.

Saldimi i qepjeve me shirit dyshtresor.

Materiali bartës për saldimin e qepjeve duhet të jetë membranë mikroporze dykomponentëshe nga politetraflouretileni i ekspanduar.

Testimi i papërshkueshmërisë në mbikalime të qepjeve duhet të bëhet pas 10 trajtimeve (larjeve në temp. 60 °C në harmoni me standardin EN 26330/2A dhe 10 cikleve të pastrimit kimik në harmoni me standardin DIN EN ISO 3175:2000 mm, në kohëzgjatje prej 2 min dhe presion 0,2 bar).

Astari (angl.: *Lining*):

Nomex 50%/viskoze FR 50%, 110 g/m²

Pengesat absorbuese (angl.: *Absorption barriers*)

Duhet të jenë nga një membranë ajrosëse (angl.: *breathable*) PTFE, e mbështjellë në të dyja anët nga aramid i petëzuar, i qëndrueshëm në larje dhe pastrim kimik.

Mbrojtëset (mbushjet ose jastëkët mbrojtës):

Mbushjet mbrojtëse mbi supë shërbejnë si amortizues dhe duhet të jenë të punuara nga materiale përherë të qëndrueshme në flakë, nga plastike joabsorbues që nuk thithin lagështi gjatë gjithë jetës së tyre dhe të jenë të lehta sa më shumë që është e mundur.

Duhet të jenë të testuar sipas standardit EN 532 dhe pas testimit nuk duhet të ketë formim vrimash, nuk duhet të ketë ndezje ose pika të shkrirjes, nuk duhet të ketë ndezje në krye apo në skajet. Rezistenca termike sipas EN 469; shtojca A: pa shkrirje, pa pikim apo ndezje.

Aksesorë të tjerë

Zinxhirët për mbyllje (*Zippers*)

Xhaketa: Zinxhiri i xhaketës duhet të jetë i pajisur me patentë paniku, si dhe dhëmbë metalik me madhësi prej 8mm.

Shiritat velcro për mbërthyerje (mbyllje)

Shiritat velcro duhet të jenë të rezistueshëm ndaj zjarrit, në larje dhe pastrim kimik.

Penjtë për qepje


Duhet të jenë rezistente ndaj flakës, 100% nga materiali meta aramid për të gjitha qepjet, kurse ngjyra duhet të jetë identike me ngjyrën e materialit të jashtëm.

Shiritat reflektues

Shiritat reflektues duhet të jenë një kombinim i ngjyrave verdhë/argjend/verdhë, kurse vetitë e tyre duhet të plotësojnë kërkesat e HuPF 09/99, pika 2.6, 2.5.1.1 dhe 2.6.1.2.

Jaka

Jaka, në pjesën e shpinës duhet të jetë e lartë afërsisht rreth 12 cm, kurse rreth 10 cm në pjesën e përparme. Mbyllja e jakës bëhet me ndihmën e shiritave (copëzave) nga materiali velcro të cilat janë të vendosura nën kapakët frontal për mbulimin e zinxhirit. Gjerësia e jakës duhet të rregullohet me ndihmën e një shiriti. Shiriti duhet të jetë i punuar nga materiali sikurse shtresa e jashtme e xhaketës,



kurse në buzën e sipërme të brendshme të jakës duhet po ashtu të jetë i qepur një shirit që shërben për varjen e xhaketës.

Mëngët

Në mëngë duhet të jenë të qepura mansheta me gjerësi rreth 12 cm. Manshetat duhet të jenë të pajisura me struktura të papërshkueshme nga uji, në të cilat pjesa e brendshme e manshetës nga kyçi i dorës duhet të jetë nga një material i thurur dhe ndodhen brenda mëngës. Duhet të sigurohet pengimi i penetrimit të lagështisë në astarin e brendshëm, i cili duhet të bëhet përmes një inkorporimi funksional të pengesave të lagështisë, të punuara nga materiali sikur shtresa e jashtme e xhaketës.

Mansheta e brendshme nga materiali i thurur, duhet të jetë dyshtresor dhe ketë një hapje të rrumbullakët për vendosjen e gishtit të madh. Materiali i thurur duhet të jetë i punuar në atë mënyrë që të pengojë daljen e fijeve (shthurjen).

Gjatësia përfundimtare duhet të jetë përafërsisht rreth 18 cm, kurse diametri i përafërt rreth 6,5 cm. Materiali i përdorur duhet të jetë nga aramidi kualitativ (93% meta aramid, 5% para aramid, 2% fibra karboni ose të ngjashme). Ngjyra duhet të jetë blu e errët.

Pantallonat

Duhet të jenë të certifikuara në harmoni me standardet EN 469.

Pantallonat e mbrojtjes nga zjarri duhet të jenë me shtrat të lartë, penjtë të jenë prej materiali kundër lagështisë dhe rezistente ndaj zjarrit dhe qemerit të jetë i përshkruar nga brenda me llastik, i përshatshëm të qëndrojnë mirë në bel.

Pantallonat në pjesën e përparme përfundojnë me një brez të gjerë rreth 6 cm, i cila në pjesën e pasme shkon duke u zgjeruar deri në 12 cm për të mbrojtur veshkat.

Brezi duhet të jetë i punuar në të dy anët nga materiali i sipërm (i jashtëm). Të dyja anët duhet të jenë të pajisura me shirita elastikë, 4 cm të gjerë dhe 12 cm të gjatë. Në pjesën e përparme të brezit, djathtas dhe majtas palëve, duhet të jetë i qepur nga një shirit (qepja duhet të bëhet në formë zarfi).

Në skajin e majtë të palës së brezit duhet të jetë i vendosur një shirit me një kopsë që shërben si zgjatje dhe përforsim shtese. Dy shirita me mbërthim velcro janë qepur në mesin e brezit në një distancë prej përafërsisht 7 cm, të qepura në formë zarfi. Mekanizmat për mbërthim ("katramat") të gjera 5 cm, janë të fiksuara me kapëse plastike në shiritat e përparmë dhe të pasmë. Mekanizmat për mbërthim mbahen së bashku në anën e pasme me ndihmën e një kapëseje.


XHEPAT

Xhepat anësor

Pantallonat duhet të pajisen me xhepa ("të fryra"), majtas dhe djathtas mbi nivelin e gjurit. Xhepat janë të drejtë, thellësia e të cilëve arrin rreth 5 cm dhe mbyllen me kapakë me dimensione 6x18 cm dhe mbyllje velcro. Në xhepin e djathtë duhet të jetë shtesë e integruar edhe një xhep për thikë. Në të dy anët e pantallonave, xhepat duhet të jenë të pajisur me fileto në formë shiriti.

Pantallonat gjithashtu në pjesën e sipërme duhet të jenë të pajisur me xhepa.

Këmbët e pantallonave



Pjesa e përparme, e poshtme, e pantallonave, në zonën e gjunjëve duhet të jetë e pajisur me përforcime nga materiali me përbërje silikon/karbon.

Nën këtë material të përforcuar duhet të vendosen “jastëkë” të cilët duhet të kenë formë ergonomike dhe të jenë punuar nga material rezistent në flakë, jo thithës dhe të papërshkueshëm nga uji. Formësimi i jastëkut duhet të jetë në formë ergonomike dhe të mundësojë lëvizje të lehtë dhe të papenguar në të gjitha drejtimet. Diametri afërsisht 14 cm të larta, 22 cm të gjera dhe trashësia rreth 1 cm.

Shiritat reflektues (fosforeshent)

Pantallonat duhet të jenë të pajisura me nga një shirit të vazhdueshëm fosforeshent me gjerësi rreth 7,5 cm të cilët duhet të vendosen horizontalisht nën përforcimin e pjesës së gjurit dhe me nga një shirit të trefishtë reflektues me gjerësi 5 cm, të cilët vendosen anash këmbëve duke filluar nga buza e sipërme e shiritit horizontal që përfundon në pjesën e poshtme të xhepave anësorë.

Rripat mbajtës të pantallonave

Rripat e pantallonave duhet të jenë të prodhuara nga material gomë elastike e gjerë. Mbërthimi i pantallonave duhet të bëhet përmes mbërthyesve të posaçme nga një plastike rezistente në temperatura.

ÇIZMET MBROJTËSE NGA ZJARRI

Duhet të jenë të certifikuara sipas standardeve EN ISO 15090:2012 F2A HI3 P T CI AN SRC EN ISO.

Çizmet duhet të jenë të prodhuara nga materiali lëkurë e zezë me kualitet të lartë, si dhe duhet të jenë të pajisura me veqe anash për veshje më të lehtë dhe të shpejtë.

Në mes të astarit dhe të lëkurës së jashtme çizmet duhet të jenë të pajisura me një membranë të papërshkueshme nga uji dhe rezistente në flakë.

Të jenë të pajisur me shirit reflektues.

Çizmet duhet të jenë rezistente ndaj ujit, nxehsisë, vajrave, derivateve, si dhe të jenë antistatike.



DOREZAT PËR MBROJTJE NGA ZJARRI

Duhet të jenë të certifikuara në harmoni me standardet: EN 659:2003.

Struktura/përbërja:

Strukturë e papërshkueshme nga uji—liner, (angl: “*liner construction*”)

Duhet të jenë absolutisht të papërshkueshëm nga uji dhe të kenë aktivitet të lartë të ajrosjes të cilën duhet t’ia ofrojë membrana;

Duhet të jenë të punuara nga materiale të teknologjisë së lartë;

Mbrojtje ekstreme nga konsumimi në pjesën e brendshme të dorës;

Të garantojë mbrojtje nga të nxehtit dhe të ftohtit;

Pjesa e pasme e dorës të duhet të jetë e punuar në mënyrë të veçantë që të punë optimale pa tension;



lejojë

Duhet të ketë izolim të dyfishtë në zonën e ekspozuar sidomos pjesën e pasme të dorës;
Mbrotje shtesë të gishtave nga materiali kevlar të përforcuar me materiale shtesë.

III.2.3. Neni 2 “Qëllimi i ligjit” , të Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikon se:

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.2.4. Neni 3 Parime të përgjithshme, të Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikon se:

- 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III.2.5. Neni 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon shprehimisht se:

- 1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti 7 kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.*

III.2.6. Në nenin 77, pikat 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.2.7. Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 3, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”.

III.2.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.2.9. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, konstatohet se në pikën 2.4.2 të kriterëve të veçanta, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin “Dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare (raporte testimi), të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike, të materialeve përbërëse të produkteve të Uniformës zjarrduruese të personelit operues (zjarrfikës), përkatësisht *uniformës mbrojtëse nga zjarri (xhaketa dhe pantallonat) + Kapuçi mbrojtës për zjarrfikësin + Dorezat për mbrojtje nga zjarri. (Raporte testimi për copën e përdorur për artikullin mostër, lëndës së pare që shoqëron atë dhe ajo që i bashkëngjitet fletë-analizës duhet të jenë detyruesisht të njëjta)”.

Nisur nga pretendimet e ankimuesit lidhur me kërkesën “Raporte testimi për copën e përdorur”, duke cituar se “termi i përdorur nga AK “Raporte testimi për copën e nuk është i saktë, pasi sic cilesohet në VKM materialet përberëse të uniformës përfaqësojnë shtresën e jashtme, materialin për pengimin e depërimit të fluideve, materialin bartes për saldimin e qepjeve, astarin, Pengesat absorbuese. Sa më sipër, termi i përdorur nga AK “copën” nuk gjendet në asnjë rresht të VKM-se për produktin uniforme mbrojtëse nga zjarri (xhaketa dhe pantallona). Nga ana tjetër, Uniforma mbrojtëse nga zjarri (xhakete pantallona), përveç shtresave, përmbajnë materiale të ndryshme si: mbrojtëset (mbushjet ose jashtëk mbrojtës) si dhe aksesoret penjto për qepje, rripa, përforcues, zinxhire, Shiritat velcro për mberthyerje (mbyllje) etj”, KPP nga verifikimi i dokumentave të tenderit, konkretisht të shtojcës lidhur me specifikimet teknike të produkteve, konstatohet se autoriteti kontraktor për artikujt e uniformës mbrojtëse nga zjarri (xhaketa dhe pantallonat) + Kapuçi mbrojtës për zjarrfikësin + Dorezat për mbrojtje nga zjarri, ka përcaktuar një sërë specifikimesh teknike. Nisur nga lloji i procedurës së prokurimit, dhe artikujt objekt shqyrtimi, gjykojmë se kërkesa për raport testimi të copës, është një kërkesë konfuze e cila krijon paqartësi për operatorët ekonomikë që kanë interes për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimit, pasi materiali që mund të përdoret për prodhimin e këtyre produkteve, mund të jetë i ndryshëm nga prodhuesi të ndryshëm, konkretisht mund të realizohet nga një material i vetëm ose nga një copë e cila në përbërje mund të ketë disa lloje materialesh, për këtë arsye autoriteti kontraktor nuk duhet të kufizojë operatorët ekonomikë duke përcaktuar raport testimi të copës, por të hartojë këtë kërkesë në përputhje me kërkesat në specifikimet teknike të kërkuara për këto artikuj.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues se “Paraprkishtë, sikurse kemi informuar me heret njeherazi edhe AK-ne edhe KPP-ne në ankesat tona të perseritura të cilat lidhen me objektin e kësaj procedure, të gjitha elementet/produktet e Uniformës Zjarrduruese prodhohen jashtë vendit tonë. Ato certifikohen konform normave dhe standarteve të miratuara ndërkombetare.

NE VKM Nr. 1153, datë 24.12.2020 “Për miratimin e uniformës, shenjave dalluese përkatëse, Flamurit dhe stemes së shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimie përcaktohet shprehimisht: 1. UNIFORMA MBROJTESE NGA ZJARRI (XHAKETA & PANTALLONAT)

Xhaketa dhe pantallonat per mbrojtje nga zjarri, duhet te jene te punuara dhe te certifikuara ne perputhje me standardin EN 469:2005, niveli 2 i mbrojtjes.

Pervec kesaj, xhaketa per mbrojtje nga zjarri duhet te plotesoje edhe standardin EN 469:2005, Shtojca B.

Prodhuesit ose subjekti qe i trajton keto produkte eshte i detyruar te paraqese certifikatat e vlefshme te produktit.

2. DOREZAT PER MBROJTJE NGA ZJARRI

Duhet te jene te certifikuara ne harmoni me standardet: EN 659:2003

3. KAPUCI MBROJTES PER ZJARRFIKESIN

Kapuci mbrojtës duhet te jete i certifikuar ne harmoni me standardet EN13911:2005 & EN 11493

4. HELMETA PER ZJARRFIKES & SISTEMI PER NDRICIM

Helmata per perdorim nga zjarrfikesit per mbrojtje kunder zjarrit e gjate nderhyrjeve operuese duhet te jete ne perputhje me standardet nderkombetare EN 443:2008 dhe EN 14458.

5. CIZMET MBROJTJESE NGA ZJARRI

Duhet te jene te certifikuara sipas standardeve EN ISO 15090:2012 F2A HI3 P T CI AN SRC EN ISO.

Gjate shqyrtimit te kriterëve te vecanta per kualifikim rezulton se sipas pikes 2.4.4 eshte kerkuar paraqitja e certifikatave konform standarteve perkatese te specifikuara ne pikat 1,2,3,4,5 te elementeve te Uniformave Zjarrduruese te percaktuara, si Certifikata te detyrueshme ne VKM Nr. 1153, date 24.12.2020 “Per miratimin e uniformes, shenjave dalluese perkatese, Flamurit dhe stemes se sherbimit te mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimie.

Pajisja e produkteve me Certifikatat perkatese kryhet mbeshtetur ne testimin e produkteve dhe materialeve per prodhimin e tyre sipas perkatesise standardeve/specifikimeve teknike dhe ekzaminimin e dokumentacionit te dosjes teknike per cdo produkt. Pra certifikata e vlefshme e produktit konform standarteve te percaktuara ne VKM eshte dokumenti permbledhes dhe shterues i cili verteton pajtueshmerine e produkteve me specifikimet teknike.

Pra kerkesa e AK-se per raporte testimi vetem per 3 nga elementet e uniformes zjarrduruese, perkatesisht uniformes mbrojtese nga zjarri (xhaketa dhe pantallonat) + kapuci mbrojtës per zjarrfikesin + Dorezat per mbrojtje nga zjarri rezulton si kerkese jo e plote pasi Uniforma zjarrduruese perbehet nga 5 elementet e mesiperme sipas pikave 1,2,3,4,5. Nga ana tjeter kerkesa per raporte testimi rezulton e dublikuar nga ana e Autoritetit kontraktor pasi paraqitja e Certifikatave te ketyre produkteve (sipas pikes 2.4.4) eshte dokumenti final i cili verteton pajtueshmerine e produkteve me specifikimet teknike. [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në shtojcën 8, Loti 1 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” në pikën 2.4.2 dhe 2.4.4 “Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë:

2.4.2 Dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare (raporte testimi), të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike, të materialeve përbërëse të produkteve të Uniformës zjarrduruese të personelit operues (zjarrfikës), përkatësisht *uniformës mbrojtëse nga zjarri (xhaketa dhe pantallonat) + Kapuçi mbrojtës për zjarrfikësin + Dorezat për mbrojtje nga zjarri.

(Raporte testimi për copën e përdorur për artikullin mostër, lëndës së pare që shoqëron atë dhe ajo që i bashkëngjitet fletë-analizës duhet të jenë detyruesisht të njëjta).

2.4.4 OE pjesëmarrës duhet të paraqesë certificate konformiteti të rregullores EU 2016/425 ose e përditësuar, për uniformat zjarrduruese (xhakete+pantallona+dorashka+helmet+ cizme zjarrfikëse+kapuc) sipas standarteve të mbrojtjes dhe sigurisë ndaj zjarrit të përcaktuara në specifikimet teknike të DST. Si edhe certifikatën e modulit D sipas rregullores EU 2016/425 lëshuar në emër të prodhuesit për produktet e tekstilit të kategorisë III.

III.3.2. Lidhur me pretendimin se “Pra kërkesa e AK-se për raporte testimi vetëm për 3 nga elementet e uniformes zjarrduruese, përkatësisht uniformes mbrojtëse nga zjarri (xhaketa dhe pantallonat) + kapuci mbrojtës për zjarrfikësin + Dorezat për mbrojtje nga zjarri rezultojnë si kërkesa jo e plotë pasi Uniforma zjarrduruese përbehet nga 5 elementet e mëposhtme sipas pikave 1,2,3,4,5.”, KPP gjykon, se ky në thelb ka të bëjë me shtim të kriterit të kualifikimit dhe jo me pretendim për modifikimin e kriterit, diskriminues, e cili do të shkaktojë skualifikim të padrejtë nga procedura e prokurimit. KPP gjykon se ka një ndarje të qartë mes rolit të tij të paraparë nga ligji si organi më i lartë i shqyrtimit të ankesave në fushën e prokurimeve publike (neni 24 e vijues i LPP-së) dhe autoriteteve kontraktore si organ përgjegjës i zhvillimit të procedurave të prokurimit (neni 21 i LPP-së) dhe njëherazi përgjegjës për hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit publik. Në nenin 110 pika 1 të LPP-së, i ndryshuar parashikohet se “Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë”. KPP gjykon se, që të justifikohet ligjërisht kërkitimi për njohjen ose rivendosjen e një të drejte të shkelur ose të mohuar duhet që të bëhet vetëm prej atij që i përket, sipas ligjit, e drejta e mohuar ose e shkelur prej një të treti dhe vetëm kundër atij që me faktin ose me veprën e tij mohon ose shkel të drejtën e kërkuar (legjitimimi pasiv), duke justifikuar me këtë fakt ose veprim ndërhyrjen e organit administrativ për të ndaluar ose për të zhdukur dëmin e rrjedhur nga ky fakt, ose veprimeve, pra operatori ekonomik ankues duhet të provojë se interesi i tij i ligjshëm është cenuar nga vendime dhe veprime konkrete (reale) të autoritetit kontraktor. Në rastin konkret, KPP gjykon se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar mekanizmat ligjorë për kundërshtimin e kriterëve për kualifikim pranë këtij të fundit, duke dhënë garanci të plota operatorëve ekonomikë ankues se procedurat për fitimin e kontratave publike, do të nënshtrohet kushteve specifike, të cilat duhet të përmbushin parakushtin të parashikuar nga neni 77 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

Në rastin konkret, KPP gjykon se njësia e prokurimit pranë autoritetit kontraktor ka parashikuar kriterin minimal, të gjykuar të nevojshëm për vërtetimin e plotësimit të kapacitetit teknik të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës për realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi. Kuadri ligjor në fuqi, ka paraparë pozitën juridike të Komisionit të Prokurimit Publik, si organ i shqyrtimit të ankesave kundër vendimeve të shprehura me akte administrative (dokumentet e procedurës së prokurimit), duke i dhënë të drejtën ligjore të shprehet mbi kriteret kualifikuese dhe specifikimet teknike në rast se këto të fundit janë hartuar në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, dhe kuadrin ligjor sektorial në fuqi që rregullon kontratën objekt-prokurimi.

Kompetenca e mësipërme është shprehur në disa drejtime në ligjin për prokurimin publik në fuqi, ku nën nenin 118 pika 2 gërma “b” të lex specialis parashikohet se ndër kompetencat e Komisionit të Prokurimit Publik, janë ato të anulimit, plotësisht ose pjesërisht, të një veprimi ose vendimi të autoritetit kontraktor, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha ato kriteret kualifikimi ose llojet e tjera të specifikimeve që bien ndesh me këtë ligj. Në rastin konkret, KPP gjykon se objekti i ankesës së operatorit ekonomik ankimues nuk lidhet me kundërshtimin e një vendimi të shprehur nga ana e autoritetit kontraktor (verifikimin ligjor në rast se kriteri i kualifikimit është në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës, apo në rast se kriteret e kualifikimit janë hartuar në formën e kërkuar nga ligji), por mbi shtimin e kriterëve të kualifikimit në një procedurë prokurimi, pasi përcaktimi i kriterëve të kualifikimit sipas kërkesës nga ankimuesi, konsiderohen kriteret të reja që do të rëndonin pozitën e operatorëve ekonomik të interesuar. Sa më sipër, KPP gjykon, se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar se është në të drejtën e plotë të autoritetit kontraktor të parashikojë kriteret minimale në një procedurë prokurimi dhe në rast se këto të fundit, (vetëm kriteret të shprehura dhe jo ato hipotetike të kërkuara) nuk janë në përputhje me rregullimet ligjore në fuqi, jepet garancia procedurale e paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

Sa më sipër, për sa kohë që autoriteti kontraktor nuk ka gjykuar të vendosë kriteret e kualifikimit sipas propozimit të operatorit ekonomik ankimues, KPP në asnjë rast nuk mund të marrë kompetencat e autoritetit kontraktor (njësisë së prokurimit) të shtojë kriteret kualifikimi në një procedurë të prokurimit publik.

Ndërsa për sa i përket pretendimit të operatorit ekonomik ankimues se “*Nga ana tjetër kërkesa për raporte testimi rezulton e publikuar nga ana e Autoritetit kontraktor pasi paraqitja e Certifikatave të ketyre produkteve (sipas pikes 2.4.4) është dokumenti final i cili verteton pajtueshmerine e produkteve me specifikimet teknike.*”, Komisioni i Prokurimit Publik, nga verifikimi i dokumentave të tenderit, pretendimet e ankimuesit si dhe argumentimi i autoritetit kontraktor në aktin e trajtimit të ankesës, KPP gjykon se, në rastin konkret kemi të bëjmë me dy kërkesa të ndryshme, ku qëllimi dhe përmbushja e tyre nuk realizohet me të njëjtin dokumentacion. Vlen të theksojmë se, autoriteti kontraktor është organi përgjegjës i zhvillimit të procedurave të prokurimit, ku ky i fundit është në të drejtën e tij, për të vendosur kërkesa për

kualifikim me qëllimin për realizimin me sukses dhe cilësi të mallit objekt prokurimit, duke respektuar parimet dhe rregullat e prokurimit publik.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se “*Sa me siper, lidhur me kërkesen për paraqitjen e deklaratës me të dhënat e prodhuesve, duhet të cilesohet perkatesisht modeli produktit që do të ofrohet si dhe origjina e tij.*

Duke qene se keto produkte, sic kemi deklaruar, importohen te gatshe nga jashte shqiperise ne Perputhje me specifikimet teknike, nga ana e Autoriteti Kontraktor duhet te specifikohet si element shtese ne piken 2.4.3 edhe paraqitja e Skedave Teknike si dhe deklarimi i origjines si element thelbësor ne vleresimin e ofertave te paraqitura nga operatorët ekonomike ofertues ne Lotin I te kesaj procedure prokurimi.. [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në shtojcën 8, Loti 1 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” në pikën 2.4.3 “Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë:

2.4.3 *Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim/et e prodhues/ve ose distributor/ve të autorizuar (në këtë rast duhet të provohet lidhja midis prodhuesit dhe distributorit nëpërmjet një autorizimi mes tyre) për të gjitha mallrat objekt prokurimi për të cilat nuk është vetë prodhues. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit dhe/ose distributorit të autorizuar si: telefon, fax, email, ëbsite, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.*

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku të deklarojë prodhuesit e të gjitha mallrave objekt prokurimi me të dhënat e kontaktit.

III.4.2. KPP gjykon, se ky në thelb ka të bëjë me shtim të kriterit të kualifikimit dhe jo me pretendim për modifikimin e kriterit, diskriminues, e cilat do të shkaktonte skualifikim të padrejtë nga procedura e prokurimit. KPP gjykon se ka një ndarje të qartë mes rolit të tij të paraparë nga ligji si organi më i lartë i shqyrtimit të ankesave në fushën e prokurimeve publike (neni 24 e vijues i LPP-së) dhe autoriteteve kontraktore si organ përgjegjës i zhvillimit të procedurave të prokurimit (neni 21 i LPP-së) dhe njëherazi përgjegjës për hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit publik. Në nenin 110 pika 1 të LPP-së, i ndryshuar parashikohet se “*Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë*”. KPP gjykon se, që të justifikohet ligjërisht kërkimi për njohjen ose rivendosjen e një të drejte të shkelur ose të mohuar duhet që të bëhet vetëm prej atij që i përket, sipas ligjit, e drejta e mohuar ose e shkelur prej një të treti dhe vetëm kundër atij që me faktin ose me veprën e tij mohon ose shkel të drejtën e kërkuesin (legjitimimi pasiv), duke justifikuar me këtë fakt ose

veprim ndërhyrjen e organit administrativ për të ndaluar ose për të zhdukur dëmin e rrjedhur nga ky fakt, ose veprimeve, pra operatori ekonomik ankimues duhet të provojë se interesi i tij i ligjshëm është cenuar nga vendime dhe veprime konkrete (reale) të autoritetit kontraktor. Në rastin konkret, KPP gjykon se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar mekanizmat ligjorë për kundërshtimin e kritereve për kualifikim pranë këtij të fundit, duke dhënë garanci të plota operatorëve ekonomikë ankimues se procedurave për fitimin e kontratave publike, do ti nënshtrohet kushteve specifike, të cilat duhet të përmbushin parakushtin të parashikuar nga neni 77 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

Në rastin konkret, KPP gjykon se njësia e prokurimit pranë autoritetit kontraktor ka parashikuar kriterin minimal, të gjykuar të nevojshëm për vërtetimin e plotësimit të kapacitetit teknik të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës për realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi. Kuadri ligjor në fuqi, ka paraparë pozitën juridike të Komisionit të Prokurimit Publik, si organ i shqyrtimit të ankesave kundër vendimeve të shprehura me akte administrative (dokumentet e procedurës së prokurimit), duke i dhënë të drejtën ligjore të shprehet mbi kriteret kualifikuese dhe specifikimet teknike në rast se këto të fundit janë hartuar në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, dhe kuadrin ligjor sektorial në fuqi që rregullon kontratën objekt-prokurimi.

Kompetenca e mësipërme është shprehur në disa drejtime në ligjin për prokurimin publik në fuqi, ku nën nenin 118 pika 2 gërma “b” të lex specialis parashikohet se ndër kompetencat e Komisionit të Prokurimit Publik, janë ato të anulimit, plotësisht ose pjesërisht, të një veprimi ose vendimi të autoritetit kontraktor, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha ato kriteret kualifikimi ose llojet e tjera të specifikimeve që bien ndesh me këtë ligj. Në rastin konkret, KPP gjykon se objekti i ankesës së operatorit ekonomik ankimues nuk lidhet me kundërshtimin e një vendimi të shprehur nga ana e autoritetit kontraktor (verifikimin ligjor në rast se kriteri i kualifikimit është në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës, apo në rast se kriteret e kualifikimit janë hartuar në formën e kërkuar nga ligji), por mbi shtimin e kritereve të kualifikimit në një procedurë prokurimi, pasi përcaktimi i kritereve të kualifikimit sipas kërkesës nga ankimuesi, konsiderohen kriteret të reja që do të rëndonin pozitën e operatorëve ekonomik të interesuar. Sa më sipër, KPP gjykon, se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar se është në të drejtën e plotë të autoritetit kontraktor të parashikojë kriteret minimale në një procedurë prokurimi dhe në rast se këto të fundit, (vetëm kriteret të shprehura dhe jo ato hipotetike të kërkuara) nuk janë në përputhje me rregullimet ligjore në fuqi, jepet garancia procedurale e paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

Sa më sipër, për sa kohë që autoriteti kontraktor nuk ka gjykuar të vendosë kriteret e kualifikimit sipas propozimit të operatorit ekonomik ankimues, KPP në asnjë rast nuk mund të marrë kompetencat e autoritetit kontraktor (njësisë së prokurimit) të shtojë kriteret kualifikimi në një procedurë të prokurimit publik.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.

III.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes se: “Kerkon: C) fuqine punetore te operatorit ekonomik te nevojshem per ekzekutimin e objektit te prokurimit, si dhe..Objekti i procedures se prokurimit “Uniforma dhe veshje specialee perfshin ne vetvete edhe procesin e prodhimit te uniformes se MZSH-se, sherbimit zjarrfikes, pra permban ne vetvete elemente sherbimi per te cilen eshte e nevojshme qe nga ofertuesit e mundshem ekonomike te disponohet edhe nje staf i cili te beje te mundur realizimin me sukses te ketij procesi per realizimin e uniformes se punonjesit te sherbimit zjarrfikes me ane te se ciles ata perfaqesojne institucionin e Bashkise Tirane. Specialistet/ punonjesit e kerkuar jane te nevojshem per procesin e prodhimit/ qepjeve apo modifikimeve ne rast se do te jete e nevojshme te mallrave objekt prokurimi.

Po ne lidhje me kete argumentim te dhene, theksojme paraprakisht se ne kriterin e vecante per kualifikim, pika 2.4.5 cuditerisht nga Autoriteti Kontraktor eshte kerkuar vetem nje numer prej 10 punonjesish, duke mos specifikuar ne asnje moment cilesine te cilen duhen te disponojne keta te fundit sic pretendohet ne argumentimin e ketij kriteri, konkretisht ku deklarohet se:

Specialistet/punonjesit e kerkuar jane te nevojshem per procesin e prodhimit/ qepjeve apo modifikimeve ne rast se do te jete e nevojshme te mallrave objekt prokurimi. Kjo le shteg per nje interpretim te vete operateve ekonomike pasi ne listen e punonjesve perfshihet cdo lloj punonjesi si sanitar, punonjesit e sherbimit, shofere etj., duke sjelle konfuzion dhe paqartesi ne hartimin e ofertes ekonomike. Pra kriteri i hartuar bie vete ndesh me argumentimin e dhene nga autoriteti kontraktor i cili i drejtohet nje kategorie te vecante punonjesisht.

[...]

Percaktimi i numrit te punonjesve prej 10 punonjesish eshte i ekzagjeruar dhe ndikon ne menyre te drejteperdrejte ne pjesemarrjen e operateve ekonomike duke limituar konkurrencen, pasi automatikisht te drejton ose ne nje Operator Ekonomik te paracaktuar duke krijuar nje trajtim te pabarabarte dhe diskriminues per te gjithë operatet ekonomike pjesemarres ne procedurat e prokurimit public ose duke i detyruar pjesemarresit ne kete procedure prokurimi drejt bashkimit te operateve ekonomike. Kjo e fundit limiton ne menyre te drejteperdrejte pjesemarrjen e operateve ekonomike ne kete procedure prokurimi, konkretisht te shoqerive te cilat i importojne keto produkte pasi nuk prodhohen ne Shqiperi. [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.5.1. Në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt - shqyrtimi, autoriteti kontraktor në Shtojcën 8 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit”, për lotin 1, pika 2.4.5 ka përcaktuar, si më poshtë vijon:

2.4.5 Operatori ekonomik për të asistuar stafin e AK gjatë procesit të prodhimit/ qepjeve/ përmasave apo modifikimeve për realizimin e uniformës së punonjesit të shërbimit zjarrfikës, duhet të ketë në stafin e tij, jo më pak se 10 (dhjetë) punonjës për 3 muajt e fundit.

Shënim: ***Kriteri 2.4.5 konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr.9. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari

dorëzimin e dokumentave provuese. Këto dokumenta duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

III.5.2. Në shtojcën 6 “Formulari i specifikimeve teknike”, të dokumenteve standarde të tenderit është parashikuar si vijon:

SPECIFIKIMET TEKNIKE: LOTI 1: “UNIFORMA ZJARRDURUESE”

2. UNIFORMA ZJARRDURUESE E PERSONELIT OPERUES (ZJARRFIKËS)-150 cope

Nr.	Artikulli	Sasia	Ngjyra
1.	Helmeta zjarrduruese	1	E kuqe, e verdhë
2.	Kapuç mbrojtës poshtë helmetës	1	Blu e errët
3.	Uniforma zjarrduruese Xhakët zjarrduruese Pantallona zjarrduruese Çizme zjarrduruese Doreza zjarrduruese	1	Blu e errët

**SPECIFIKIMET
HELMETA PËR ZJARRFIKËS & SISTEMI PËR NDRIÇIM**

Helmeta për përdorim nga zjarrfikësit për mbrojtje kundër zjarrit e gjatë ndërhyrjeve operuese duhet të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare EN 443:2008 dhe EN 14458.

Helmeta duhet të jetë e llojit A3B,**, E2C.

Helmeta duhet të jetë e pajisur me një xham transparent me ngjyrë lumineshence (nuanca të buta ngjyrë portokalli), të punuara nga materiali PESU (*polyethersulfone*), për të rezistuar në temperatura të ngritura.

Në pjesën e brendshme duhet të jetë e pajisur me syza, sipas EN 166.

Rezistenca ndaj ndikimeve të jashtme

Helmeta duhet të jetë e pajisur me një amortizues të punuar nga poliuretani, i cili duhet të jetë i integruar në gëzhhojën e helmetës e që nuk mund të hiqet.

Në mes të gëzhhojës, e cila duhet të jetë e punuar nga materiale kompozite (fibra karboni), dhe poliuretanit (e integruar në poliuretan) duhet të jetë e integruar një gëzhhojë e dytë dhe një shkumë izoluese.



Për zjarrfikësin operues



: drejtuesin/komandantin e zjarrfikësit

Pjesa e brendshme e helmetës

- Duhet të jetë e punuar nga materiale kompozite SMC (nuk lejohen pjesë plastike për përforcime).
- Për t'iu përshtatur kokës, rregullimi i madhësisë së helmetës duhet të bëhet përmes një rregullatori i cili duhet të realizojë ndryshimin e madhësisë nga 52–64 cm.
- Gjerësia e jashtme e helmetës duhet të jetë në mes 236 mm–247 mm në zonën e veshëve, gjatësia nuk duhet të tejkalojë 316 mm dhe lartësia nuk duhet të tejkalojë 216 mm.
- Helmeta duhet të jetë ngjyrosur me ngjyrë lumineshence.
- Të dyja anët e helmetës duhet të pajisen me nga një shirit reflektues që shtrihen pothuajse përgjatë gjithë helmetës.
- Gjerësia e shiritit duhet të jetë në mes 24 mm–25 mm.
- Helmeta duhet të jetë e pajisur me një mbrojtës qafe të punuar prej fibrave karbonike dhe të trajtuara me alumin.
- Mbrojtësi duhet të lidhet me helmetën, përmes 3 pikave dhe duhet të jetë i lehtë për t'u hequr dhe instaluar.
- Helmeta duhet të mundësojë përdorimin e papenguar të maskës së aparatit të frymëmarrjes.
- Pesha totale së bashku me mbrojtësin e qafës nuk duhet të jetë më e madhe se 1,4 kg.
- Në pjesën ballore të helmetës duhet të jetë përcaktuar vendi për logo. Madhësia e vendit për logo duhet të jetë e gjerë rreth 65 mm–80 mm, kurse lartësia nga 65 mm–75 mm.
- Logoja e përdoruesit të fundit duhet të jetë e shtypur fabrikisht në anën e përparme të helmetës. Nuk lejohet ngjitja e etiketave të plastikës (*stickers*).
- Helmeta duhet të jetë rezistente në temperaturë deri në 1000°C për një periudhë kohore prej së paku prej 10 sec, në kontakt me fenomenin “*Flash over*”, si dhe i testuar në temperaturë 250°C në një kohëzgjatje prej 30 min.
- Helmeta duhet të ofrojë mbrojtje të plotë të kokës, duke përfshirë edhe qafën dhe fytyrën.
- Rripi i mjekrës duhet të jetë nga materiali nomex dhe i testuar për të mos shkaktuar irritime (alergji).
- Helmeta duhet të jetë e pajisur me llambë ndriçuese xenon dhe mbajtës përkatës, si dhe të mundësojë vendosjen e sistemit të komunikimit.

KAPUÇI MBROJTËS PËR ZJARRFIKËSIN

Kapuçi mbrojtës duhet të jetë i certifikuar në harmoni me standardet



EN13911:2005 & EN 1149-3.

- Struktura/përbërja;
- Strukturë/ndërtim dyshtresor;
- Materiali 100% Aramid;
- Ngjyra: blu e errët.

Madhësia duhet të jetë universale, kapuç me shtresë dopio, shtresë teke që vjen përpara si grykashkë, me një rreth të hapur rreth fytyrës me fund të rrafshët dhe strukturë tegelash, me qepje me fill nomex. Të gjitha të jenë një masë.

Nënkapela duhet të mundësojë vendosjen e papenguar të maskës. Nënkapela duhet të mbulojë në pjesë të madhe gjoksin, supet dhe shpinën.

UNIFORMA MBROJTËSE NGA ZJARRI (XHAKETA & PANTALLONAT)

Xhaketa dhe pantallonat për mbrojtje nga zjarri, duhet të jenë të punuara dhe të certifikuara në përputhje me standardin EN 469:2005, niveli 2 i mbrojtjes.

Përveç kësaj, xhaketa për mbrojtje nga zjarri duhet të plotësojë edhe standardin EN 469:2005, shtojca B.Prodhuesit ose subjekti që i trajton këto produkte është i detyruar të paraqesë certifikatat e vlefshme të produktit.

Në xhaketë, mbrapa, në pjesën e sipërme, do të vendoset një shirit me përmasa në lartësi 15 cm, dhe gjerësi sa ajo ndërmjet gavaturave. Ngjyra e shiritit do të jetë gri metalizato, mbi të cilën do të shkruhet me shkronja shtypi kapitale “MZSH”. Shkrimi do të jetë ngjyrë blu e errët. Përmasat e shkrimit do të jenë në lartësi 10 cm dhe gjerësi shkronje 1.8 cm, në përpjesëtim me masat trupore të uniformave;

Në pjesën e përparme të xhaketës duhet të jenë të qepura horizontalisht në pjesën e gjoksit. Një xhep për vendosjen e radiomarrësit duhet të vendoset në pjesën e përparme, afërsisht rreth 2 cm majtas nga shiriti i përparmë;

Rreth 9 cm mbi xhepin e radiolidhjes, duhet të jetë i vendosur një shirit me dimension 7.5x3 cm i cili do të shërbejë si mbajtës i mikrofonit dhe duhet të jetë nga materiali i sipërm;

Përveç kësaj, në anën e djathtë të pjesës së përparme nën tegelin e qepjes horizontale, duhet të jetë i vendosur mbajtësi i llambës ndriçuese;

- Dimensionet e përafërta të xhepit duhet të jenë 5.5 cm thellësi, gjerësia 8.5 cm dhe lartësia rreth 19 cm. Xhepi në pjesën e sipërme dhe të poshtme është i hapur. Në pjesën e sipërme është i fiksuar me ndihmën e një shiriti me dimension 5.5x11 cm, me shirit velcro.



Pjesa e pasme (shpina)

Pjesa e shpinës duhet të jetë e ndarë horizontalisht në dy seksione.
Mbishkrimet në shpinë duhet të jenë në një ose dy rreshta ku madhësia e shkronjave duhet të jetë rreth 6 cm. Ngjyra e sfondit duhet të jetë e verdhë flourishente, kurse e shkronjave e argjendtë:
Në shirit duhet të shkruhet “MZSH” apo ndonjë mbishkrim tjetër sipas marrëveshjes;
Ngjitja e mbishkrimit në shpinë duhet të bëhet me velcro ose e përhershme;
Xhaketa e gjatë, minimumi i gjatësisë së xhaketës do të jetë 92 cm.

Xhepat anësore

Xhepat anësore duhet të jenë të futur brenda dhe të mbuluar me kapakë (me dimension afërsisht 22x7,5 cm). Të dy kapakët në pjesën e poshtme duhet të mbyllen me shirit velcro. Një shirit me një karabinë me kokë rrotulluese duhet të jetë e vendosur në kapakun e xhepit (madhësia rreth 7,5 cm).
Xhaketa duhet të jetë në tërësi e pajisur me astar të përhershëm rezistent ndaj zjarrit. Astarin nuk duhet të jetë i fiksuar në asnjë pikë me tegelat e qepjes.
Në pjesën e përparme, në anën e djathtë të astarit duhet të jetë i vendosur një xhep nga materiali i sipërm (i jashtëm) me përmasa afërsisht 18x2 cm, me kapak i cili mbyllet me shirit velcro me përmasa 2x2 cm. Një hapje për riparim duhet të ndodhet në pjesën e shpinës me gjerësi rreth 54 cm, kurse hapja tjetër në anën e djathtë me gjerësi rreth 28 cm.

Përshkrimi i detajuar në skicë

Duhet të jetë rezistente në temperatura të larta sipas EN 469;
Penjtë të jenë prej materiali kundër lagështisë dhe rezistente ndaj zjarrit;
Gavaturre të gjerë të mëngëve, për veprime të rehatshme;
Me zinxhir të tipit të qëndrueshëm dhe rezistent ndaj zjarrit dhe i mbuluar me kapak;
Jaka dhe bërrylat të jenë me përforcues;
Të ketë xhep të kraharorit për radio, me kapak mbrojtës, si dhe dy xhepa anësorë me kapak.

MATERIALET

Përbërja e materialeve të shtresës së jashtme

Pesha e materialit të shtresës së jashtme duhet të jetë afro 195g/m², që përbën përzierje të fijeve aramidi 100% (me një përmbajtje prej së paku 23 % paraaramid dhe 2% fije karboni ngjyrë blu të errët e ngjashme me RAL 5004) ose ekuivalente.

Ngjyra: blu e errët.

Materiali për pengimin e depërtimit të fluideve.

Duhet të jetë membranë mikroporoze PTFE, me shtresa fine të polimereve të një performancë të lartë në materialin bartës me përbërje 50% aramid dhe 50 % melamin të mbyllur, shkumëzime silikonit për mbajtje distance ose ekuivalente.

Saldimi i qepjeve me shirit dyshtresor.

Materiali bartës për saldimin e qepjeve duhet të jetë membranë mikroporoze dykomponentëshe nga politetrafluoretileni i ekspanduar.

Testimi i papërshkueshmërisë në mbikalime të qepjeve duhet të bëhet pas 10 trajtimeve (larjeve në temp. 60 °C në harmoni me standardin EN 26330/2A dhe 10 cikleve të pastrimit kimik në harmoni me standardin DIN EN ISO 3175:2000 mm, në kohëzgjatje prej 2 min dhe presion 0,2 bar).

Astari (angl.: *Lining*):

Nomex 50%/viskoze FR 50%, 110 g/m²

Pengesat absorbuese (angl.: *Absorption barriers*)

Duhet të jenë nga një membranë ajrosëse (angl.: *breathable*) PTFE, e mbështjellë në të dyja anët nga aramid i petëzuar, i qëndrueshëm në larje dhe pastrim kimik.

Mbrojtëset (mbushjet ose jastëkët mbrojtës):

Mbushjet mbrojtëse mbi supe shërbejnë si amortizues dhe duhet të jenë të punuara nga materiale përherë të qëndrueshme në flakë, nga plastike joabsorbues që nuk thithin lagështi gjatë gjithë jetës së tyre dhe të jenë të lehta sa më shumë që është e mundur.

Duhet të jenë të testuar sipas standardit EN 532 dhe pas testimit nuk duhet të ketë formim vrimash, nuk duhet të ketë ndezje ose pika të shkrirjes, nuk duhet të ketë ndezje në krye apo në skajet. Rezistenca termike sipas EN 469; shtojca A: pa shkrirje, pa pikim apo ndezje.

Aksesorë të tjerë

Zinxhirët për mbyllje (Zippers)

Xhaketa: Zinxhiri i xhaketës duhet të jetë i pajisur me patentë paniku, si dhe dhëmbë metalik me madhësi prej 8mm.

Shiritat velcro për mbërthyerje (mbyllje)


Shiritat velcro duhet të jenë të rezistueshëm ndaj zjarrit, në larje dhe pastrim kimik.

Penjtë për qepje

Duhet të jenë rezistente ndaj flakës, 100% nga materiali meta aramid për të gjitha qepjet, kurse ngjyra duhet të jetë identike me ngjyrën e materialit të jashtëm.

Shiritat reflektues

Shiritat reflektues duhet të jenë një kombinim i ngjyrave verdhë/argjend/verdhë, kurse vetitë e tyre duhet të plotësojnë kërkesat e HuPF 09/99, pika 2.6, 2.5.1.1 dhe 2.6.1.2.



Jaka

Jaka, në pjesën e shpinës duhet të jetë e lartë afërsisht rreth 12 cm, kurse rreth 10 cm në pjesën e përparme. Mbyllja e jakës bëhet me ndihmën e shiritave (copëzave) nga materiali velcro të cilat janë të vendosura nën kapakët frontal për mbulimin e zinxhirit. Gjerësia e jakës duhet të rregullohet me ndihmën e një shiriti. Shiriti duhet të jetë i punuar nga materiali sikurse shtresa e jashtme e xhaketës, kurse në buzën e sipërme të brendshme të jakës duhet po ashtu të jetë i qepur një shirit që shërben për varjen e xhaketës.

Mëngët

Në mëngë duhet të jenë të qepura mansheta me gjerësi rreth 12 cm. Manshetat duhet të jenë të pajisura me struktura të papërshkueshme nga uji, në të cilat pjesa e brendshme e manshetës nga kyçi i dorës duhet të jetë nga një material i thurur dhe ndodhen brenda mëngës. Duhet të sigurohet pengimi i penetrimit të lagështisë në astarin e brendshëm, i cili duhet të bëhet përmes një inkorporimi funksional të pengesave të lagështisë, të punuara nga materiali sikur shtresa e jashtme e xhaketës.

Mansheta e brendshme nga materiali i thurur, duhet të jetë dyshtresor dhe ketë një hapje të rrumbullakët për vendosjen e gishtit të madh. Materiali i thurur duhet të jetë i punuar në atë mënyrë që të pengojë daljen e fijeve (shthurjen).

Gjatësia përfundimtare duhet të jetë përafërsisht rreth 18 cm, kurse diametri i përafërt rreth 6,5 cm. Materiali i përdorur duhet të jetë nga aramidi kualitativ (93% meta aramid, 5% para aramid, 2% fibra karboni ose të ngjashme). Ngjyra duhet të jetë blu e errët.

Pantallonat

Duhet të jenë të certifikuara në harmoni me standardet EN 469.

Pantallonat e mbrojtjes nga zjarri duhet të jenë me shtrat të lartë, penjtë të jenë prej materiali kundër lagështisë dhe rezistente ndaj zjarrit dhe qemerit të jetë i përshkruar nga brenda me llastik, i përshtatshëm të qëndrojë mirë në bel.

Pantallonat në pjesën e përparme përfundojnë me një brez të gjerë rreth 6 cm, i cila në pjesën e pasme shkon duke u zgjeruar deri në 12 cm për të mbrojtur veshkat.

Brezi duhet të jetë i punuar në të dy anët nga materiali i sipërm (i jashtëm). Të dyja anët duhet të jenë të pajisura me shirita elastikë, 4 cm të gjerë dhe 12 cm të gjatë. Në pjesën e përparme të brezit, djathtas dhe majtas palëve, duhet të jetë i qepur nga një shirit (qepja duhet të bëhet në formë zarfi).

Në skajin e majtë të palës së brezit duhet të jetë i vendosur një shirit me një kopsë që shërben si zgjatje dhe përforcim shtese. Dy shirita me mbërthim velcro janë qepur në mesin e brezit në një distancë prej përafërsisht 7 cm, të qepura në formë zarfi. Mekanizmat për mbërthim ("katramat") të gjera 5 cm, janë të fiksuara me kapëse plastike në shiritat e përparmë dhe të pasmë. Mekanizmat për mbërthim mbahen së bashku në anën e pasme me ndihmën e një kapëseje.

XHEPAT

Xhepat anësor


Pantallonat duhet të pajisen me xhepa ("të fryra"), majtas dhe djathtas mbi nivelin e gjurit. Xhepat janë të drejtë, thellësia e të cilëve arrin rreth 5 cm dhe mbyllen me kapakë me dimensione 6x18 cm dhe mbyllje velcro. Në xhepin e djathtë duhet të jetë shtesë e integruar edhe një xhep për thikë. Në të dy anët e pantallonave, xhepat duhet të jenë të pajisur me fileto në formë shiriti.

Pantallonat gjithashtu në pjesën e sipërme duhet të jenë të pajisur me xhepa.

Këmbët e pantallonave

Pjesa e përparme, e poshtme, e pantallonave, në zonën e gjunjëve duhet të jetë e pajisur me përforcime nga materiali me përbërje silikon/karbon.

Nën këtë material të përforcuar duhet të vendosen "jastëkë" të cilët duhet të kenë formë ergonomike dhe të jenë punuar nga material rezistent në flakë, jo thithës dhe të papërshkueshëm nga uji. Formësimi i jastëkut duhet të jetë në formë ergonomike dhe të mundësojë lëvizje të lehtë dhe të papenguar në të gjitha drejtimet. Diametri afërsisht 14 cm të larta, 22 cm të gjera dhe trashësia rreth 1 cm.



Shiritat reflektues (fosforeshent)

Pantallonat duhet të jenë të pajisura me nga një shirit të vazhdueshëm fosforeshent me gjerësi rreth 7,5 cm të cilët duhet të vendosen horizontalisht nën përforcimin e pjesës së gjurit dhe me nga një shirit të trefishtë reflektues me gjerësi 5 cm, të cilët vendosen anash këmbëve duke filluar nga buza e sipërme e shiritit horizontal që përfundon në pjesën e poshtme të xhepave anësorë.

Rripat mbajtës të pantallonave

Rripat e pantallonave duhet të jenë të prodhuara nga material gomë elastike e gjerë. Mbërthimi i pantallonave duhet të bëhet përmes mbërthyesve të posaçme nga një plastike rezistente në temperatura.

ÇIZMET MBROJTËSE NGA ZJARRI

Duhet të jenë të certifikuara sipas standardeve EN ISO 15090:2012 F2A HI3 P T CI AN SRC EN ISO.

Çizmet duhet të jenë të prodhuara nga materiali lëkurë e zezë me kualitet të lartë, si dhe duhet të jenë të pajisura me veqe anash për veshje më të lehtë dhe të shpejtë.

Në mes të astarit dhe të lëkurës së jashtme çizmet duhet të jenë të pajisura me një membranë të papërshkueshme nga uji dhe rezistente në flakë.

Të jenë të pajisur me shirit reflektues.

Çizmet duhet të jenë rezistente ndaj ujit, nxehsisë, vajrave, derivateve, si dhe të jenë antistatike.



DOREZAT PËR MBROJTJE NGA ZJARRI

Duhet të jenë të certifikuara në harmoni me standardet: EN 659:2003.

Struktura/përbërja:

Strukturë e papërshkueshme nga uji—liner, (angl: “*liner construction*”)

Duhet të jenë absolutisht të papërshkueshëm nga uji dhe të kenë aktivitet të lartë të ajrosjes të cilën duhet t’ia ofrojë membrana;

Duhet të jenë të punuara nga materiale të teknologjisë së lartë;

Mbrojtje ekstreme nga konsumimi në pjesën e brendshme të dorës;

Të garantojë mbrojtje nga të nxehtit dhe të ftohtit;

Pjesa e pasme e dorës të duhet të jetë e punuar në mënyrë të veçantë që të punë optimale pa tension;

Duhet të ketë izolim të dyfishtë në zonën e ekspozuar sidomos pjesën e pasme të dorës;

Mbrojtje shtesë të gishtave nga materiali kevlar të përforcuar me materiale shtesë.



III.5.3. Në shtojcën 6 “*Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit*”, të dokumenteve standarde të tenderit është parashikuar si vijon:

Shtojca 7.

(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

“BLERJE UNIFORMA DHE VESHJE SPECIALE PËR MZSH-NË” i ndarë në lote si më poshtë:

**Sasia e mallit / sasia orientuese që kërkohet:
LOTI 1 - “UNIFORMA ZJARRDURUESE”**

Artikulli	Përshkrimi	Shuma	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
1.	Uniforma Zjarrduruese	150	Bashkia Tiranë/ MZSH	Brenda 60 ditëve pune nga lidhja e minikontratës

III.5.4. Lidhur me pretendimin e mësipërm të operatorit ekonomik ankimues KSHA ka argumentuar si në vijim: “... Ky kriter është përcaktuar referuar VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, pika 5, ku citohet se: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit...”, si dhe pika 8: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Sqarojmë se, një numër minimal punonjësish tregon aftësinë e operatorit ekonomik për të përballuar me burime njerëzore të mjaftueshme kërkesat e kontratës, sidomos në projekte komplekse, si ajo e uniformave zjarrëfikëse.

Ky kriter garanton që operatori ekonomik ofertues ka kapacitete të mjaftueshme për të kryer furnizimin në kohë dhe në cilësinë e kërkuar për përmbushjen e kontratës.

Gjithashtu, numri i punonjësve është vendosur për të asistuar AK gjatë fazës së marrjes së masave, përgatitjen e uniformave sipas kërkesave të AK, konfeksionimi i tyre, transporti pranë magazinës së AK, etj.

Në seksionin 2, “Kriteret e vecanta për kualifikim”, pika 2.4 Kërkesa të tjera të vecanta për kualifikim, nënpika 2.4.5 Operatori ekonomik për të asistuar stafin e AK gjatë procesit të prodhimit/ qepjeve/ përmasave apo modifikimeve për realizimin e uniformës së punonjësit të shërbimit zjarrfikës, duhet të ketë në stafin e tij, jo më pak se 10 (dhjetë) punonjës për 3 muajt

e fundit të modifikohet në 7 punonjës për 3 muajt e fundit, në mënyrë që të krijohet mundësia për pjesëmarrje sa më të lartë në këtë procedurë prokurimi.”

III.5.5. Neni 2 “Qëllimi i ligjit” , të Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikon se:

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.5.6. Neni 3 Parime të përgjithshme, të Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikon se:

- 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III.5.7. Neni 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon shprehimisht se:

- 1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti 7 kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.*

III.5.8. Në nenin 77, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilanci të tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohej nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohej operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.5.9. Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 3, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”.

III.5.10. Neni 40, pika 5, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

“5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) *licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*
- b) *një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*
- c) *fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- ç) *mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit..”*

III.5.11. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.5.12. Bazuar në sa më sipër, KPP gjykon, se referuar vlerës së kontratës, natyrës së mallit, si dhe shpërndajës së tij, është e nevojshme që operatorët ekonomikë të disponojnë stafin e nevojshëm, për realizimin me sukses të kontratës. KPP gjykon, se përcaktimi i numrit të punonjësve, duhet të vijë pas një analize të hollësishme të të gjithë elementeve të procedurës së prokurimit, si volumi, natyra, grafiku i lëvrimit, afati i kontratës. Nga verifikimi i kthim - përgjigjes së KSHA-së konstatohet, se pretendimi i operatorit për uljen e numrit të punonjësve, nga ana e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës është trajtuar si vijon: “*të modifikohet në 7 punonjës për 3 muajt e fundit*”. Pra autoriteti kontraktor në kthim - përgjigje të operatorit

ekonomik ankimes ka trajtuar pretendimin e tij, dhe ka ulur numrin e punonjësve të kërkuar për realizimin e kontratës nga 10 në 7 punonjës. Vlen të theksojmë se, në ankesën e tij, operatori ekonomik ankimes ka kërkuar uljen e numrit të punonjësve të kërkuar, por në asnjë moment nuk është shprehur dhe nuk ka përcaktuar se sa duhet të jetë ky numër.

Sa më sipër, bazuar në të gjithë elementet e cituara më lart, Komisioni gjykon, se kërkesa për disponimin e 7 punonjësve, është një kërkesë e justifikuar nga autoriteti kontraktor, për shkak të specifikës së kësaj procedure prokurimi, specifikimeve teknike të kërkuara, sasisë, si dhe afatit të lëvrimin nga lidhja e minikontratave. Komisioni thekson, se për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet disponimi i numrit të nevojshëm të punonjësve nga ana e operatorëve ekonomikë, në mënyrë të arsyeshme, proporcionale, si dhe në përputhje me nevojat reale për ekzekutimin e kontratës në mënyrë të suksesshme, në respekt të nenit 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 4, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, i cili parashikon se: “3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. Për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet nga operatori ekonomik, që disponon kapacitetet teknike e profesionale në lidhje me stafin teknik, për sa kohë që mallrat objekt - prokurimi do të duhet të prodhohen në përputhje me standardet e miratuara. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi, ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Dokumentet e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik, në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin me sukses të kontratës, me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 2 të LPP-së.

III.5.13. Për sa i përket pretendimit të operatorit ekonomik se “Po në lidhje me këto argumentime të dhena, theksojmë paraprakisht se në kriterin e veçantë për kualifikim, pika 2.4.5 cuditerisht nga Autoriteti Kontraktor është kërkuar vetëm një numër prej 10 punonjësish, duke mos specifikuar në asnjë moment cilesinë të cilën duhet të disponojnë këta të fundit sic pretendohet në argumentimin e këtij kriteri, konkretisht ku deklarohet se:

Specialistet/punonjesit e kerkuar jane te nevojshem per procesin e prodhimit/ qepjeve apo modifikimeve ne rast se do te jete e nevojshme te mallrave objekt prokurimi. Kjo le shteg per nje interpretim te vete operateve ekonomike pasi ne listen e punonjesve perfshihet cdo lloj punonjesi si sanitar, punonjesit e sherbimit, shofere etj., duke sjelle konfuzion dhe paqartesi ne

hartimin e ofertes ekonomike. Pra kriteri i hartuar bie vete ndesh me argumentimin e dhene nga autoriteti kontraktor i cili i drejtohet nje kategorie te vecante punonjesisht.”, KPP nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, konstatohet se autoriteti kontraktor ka përcaktuar se “Operatori ekonomik për të asistuar stafin e AK gjatë procesit të prodhimit/ qepjeve/ përmasave apo modifikimeve për realizimin e uniformës së punonjësit të shërbimit zjarrfikës, duhet të ketë në stafin e tij, jo më pak se 10 (dhjetë) punonjës për 3 muajt e fundit.”

Sa më sipër, KPP gjykon, se ky në thelb ka të bëjë me shtim të kriterit të kualifikimit dhe jo me pretendim për modifikimin e kriterit, diskriminues, e cilat do të shkaktonte skualifikim të padrejtë nga procedura e prokurimit. KPP gjykon se ka një ndarje të qartë mes rolit të tij të paraparë nga ligji si organi më i lartë i shqyrtimit të ankesave në fushën e prokurimeve publike (neni 24 e vijues i LPP-së) dhe autoriteteve kontraktore si organ përgjegjës i zhvillimit të procedurave të prokurimit (neni 21 i LPP-së) dhe njëherazi përgjegjës për hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit publik. Në nenin 110 pika 1 të LPP-së, i ndryshuar parashikohet se “Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë”. KPP gjykon se, që të justifikohet ligjërisht kërkitimi për njohjen ose rivendosjen e një të drejte të shkelur ose të mohuar duhet që të bëhet vetëm prej atij që i përket, sipas ligjit, e drejta e mohuar ose e shkelur prej një të treti dhe vetëm kundër atij që me faktin ose me veprën e tij mohon ose shkel të drejtën e kërkuar (legjitimimi pasiv), duke justifikuar me këtë fakt ose veprim ndërhyrjen e organit administrativ për të ndaluar ose për të zhdukur dëmin e rrjedhur nga ky fakt, ose veprimeve, pra operatori ekonomik ankimues duhet të provojë se interesi i tij i ligjshëm është cenuar nga vendime dhe veprime konkrete (reale) të autoritetit kontraktor. Në rastin konkret, KPP gjykon se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar mekanizmat ligjorë për kundërshtimin e kriterëve për kualifikim pranë këtij të fundit, duke dhënë garanci të plota operatorëve ekonomikë ankimues se procedurave për fitimin e kontratave publike, do ti nënshtrohet kushteve specifike, të cilat duhet të përmbushin parakushtin të parashikuar nga neni 77 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

Në rastin konkret, KPP gjykon se njësia e prokurimit pranë autoritetit kontraktor ka parashikuar kriterin minimal, të gjykuar të nevojshëm për vërtetimin e plotësimin të kapacitetit teknik të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, lidhur me punonjësit, për realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi. Kuadri ligjor në fuqi, ka paraparë pozitën juridike të Komisionit të Prokurimit Publik, si organ i shqyrtimit të ankesave kundër vendimeve të shprehura me akte administrative (dokumentet e procedurës së prokurimit), duke i dhënë të drejtën ligjore të shprehet mbi kriteret kualifikuese dhe specifikimet teknike në rast se këto të fundit janë hartuar në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, dhe kuadrin ligjor sektorial në fuqi që rregullon kontratën objekt-prokurimi.

Kompetenca e mësipërme është shprehur në disa drejtime në ligjin për prokurimin publik në fuqi, ku nën nenin 118 pika 2 gërma “b” të lex specialis parashikohet se ndër kompetencat e

Komisionit të Prokurimit Publik, janë ato të anulimit, plotësisht ose pjesërisht, të një veprimi ose vendimi të autoritetit kontraktor, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha ato kritere kualifikimi ose llojet e tjera të specifikimeve që bien ndesh me këtë ligj. Në rastin konkret, KPP gjykon se objekti i ankesës së operatorit ekonomik ankimues nuk lidhet me kundërshtimin e një vendimi të shprehur nga ana e autoritetit kontraktor (verifikimin ligjor në rast se kriteri i kualifikimit është në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës, apo në rast se kriteret e kualifikimit janë hartuar në formën e kërkuar nga ligji), por mbi shtimin e kriterëve të kualifikimit në një procedurë prokurimi, pasi përcaktimi i kriterëve të kualifikimit sipas kërkesës nga ankimuesi, konsiderohen kritere të reja që do të rëndonin pozitativisht operatorëve ekonomik të interesuar. Sa më sipër, KPP gjykon, se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar se është në të drejtën e plotë të autoritetit kontraktor të parashikojë kriteret minimale në një procedurë prokurimi dhe në rast se këto të fundit, (vetëm kriteret të shprehura dhe jo ato hipotetike të kërkuara) nuk janë në përputhje me rregullimet ligjore në fuqi, jepet garancia procedurale e paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

Sa më sipër, për sa kohë që autoriteti kontraktor nuk ka gjykuar të vendosë kriteret e kualifikimit sipas propozimit të operatorit ekonomik ankimues, KPP në asnjë rast nuk mund të marrë kompetencat e autoritetit kontraktor (njësisë së prokurimit) të shtojë kritere kualifikimi në një procedurë të prokurimit publik.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.

III.6. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Victoria AL” ShPK, se: “[...] Mbeshtetur ne sa mesiper nga ana e Autoritetit Kontraktor kerkohet modifikim i kriterit kualifikues, lidhur me kerkesen per makineri, mbeshtetur ne argumentimet e dhena nga ana jone si dhe duke marre parasysh faktin e importimit te Uniformave Zjarrduruese nga operatore ekonomike qe operojne ne kete sektor te vecante te tregut dhe se asnje operator ekonomik nuk mund te nderhyje apo te kryeje modifikime te ketyre produkteve pasi cenohet drejtperdrejt VKM dhe certifikimi i tyre.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.6.1. Në shtojcën 8, për Lotin 1, “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.4.6 dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë:

2.4.6 Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qera këto pajisje:

- ❖ 1 (një) makineri qëndisje;
- ❖ 1 (një) linjë stampimi me serigrafi (makineri stampimi, furrë tharje stampimi dhe presë për ngjitjen e logove)

Për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentat që vertetojnë pronësinë e tyre ose marrjen me qera të tyre: (faturë tatimore të shitblerje/aktet e zhdoganimit, origjinale ose fotokopje të noterizuar, ose cdo lloj akti tjetër ligjor që vërteton pronësinë ose kontratë qeraje të noterizuar). Për makineritë me qera duhet të përgatitet kontrata e qerasë e lidhur para noterit, me afat për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt prokurimi, e

shoqëruar me dokumentacionin që vërteton pronësinë e qeradhënësit (fatura tatimore ose zhdoganimi ose cdo lloj tjetër ligjor që vërteton pronësinë e qeradhënësit).

Shënim: ***Kriteri 2.4.6 konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr.9. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentave provuese. Këto dokumenta duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

III.6.2. Lidhur me pretendimin e mësipërm, autoriteti kontraktor në aktin e trajtimit të ankesës pretendon se ka pranuar pretendimin e ankimesit duke argumentuar: “KSHA për sa më sipër, pas shqyrtimit dhe verifikimit të dokumentacionit, konstaton si më poshtë:

Në lidhje me këtë argumentim, KSHA sqaron se nuk mund të konsiderohet fakt i pakundërshtueshëm se të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës do të importojnë mallrat objekt prokurimi. Nga testimi i tregut që, grupi i punës/specialistët e fushës kanë realizuar rezulton se, një pjesë e konsiderueshme e operatorëve që kanë në objektin e veprimtarisë së tyre prodhimin e këtyre mallrave, i prodhojnë ato brenda vendit, si rrjedhojë nuk mund të merren në konsideratë vetëm operatorët ekonomikë që i importojnë këto produkte. Megjithatë, vendosja e këtij kriteri nuk çënon VKM-në përkatëse të përcaktimit të uniformës zjarrëdurruese apo certifikimin e mallrave, pasi nuk do të ndërhyhet në strukturën e uniformës por do të vendoset logo e AK, sic është kërkuar në DST.

Përfshirja e këtyre pajisjeve, si kusht në kriteret e vecanta të kualifikimit siguron që, operatorët ekonomik të kenë kapacitetin e nevojshëm prodhues për të përmbushur sasitë e kërkuara. Kjo shmang rreziqet e vonësive dhe garanton që prodhuesi ka mjetet për të përballuar me sukses realizimin dhe përmbushjen në kohë dhe sipas afateve të procedurës, objekt prokurimi.

Në mënyrë që t’i vijë në ndihmë OE pjesëmarrës që importojnë këto mallra, sic pretendon se është edhe operatori që ka paraqitur ankesën, KSHA vendos që, për kriterin e vendosur në seksionin 2, “Kriteret e vecanta për kualifikim”, pika 2.4.6 “Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qera këto pajisje:

- ☐ 1 (një) makineri qëndisje;
- ☐ 1 (një) linjë stampimi me serigrafi (makineri stampimi, furrë tharje stampimi dhe presë për ngjitjen e logove)

Për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre ose marrjen me qera të tyre: (faturë tatimore të shitblerje/aktet e zhdoganimit, origjinale ose fotokopje të noterizuar, ose cdo lloj akti tjetër ligjor që vërteton pronësinë ose kontratë qeraje të noterizuar). Për makineritë me qera duhet të përgatitet kontrata e qerasë e lidhur para noterit, me afat për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt prokurimi, e shoqëruar me dokumentacionin që vërteton pronësinë e qeradhënësit (fatura tatimore ose zhdoganimi ose cdo lloj tjetër ligjor që vërteton pronësinë e qeradhënësit)”, ta modifikojë për t’i dhënë mundësi cdo OE pjesëmarrës jo prodhues, si më poshtë:

“2.4.6 Operatori ekonomik ofertues/ prodhues i uniformave duhet të ketë në pronësi ose me qera këto pajisje:

- ☐ 1 (një) makineri qëndisje;
- ☐ 1 (një) linjë stampimi me serigrafi (makineri stampimi, furrë tharje stampimi dhe presë për ngjitjen e logove)

Për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentat që vertetojnë pronësinë e tyre ose marrjen me qera të tyre: (faturë tatimore të shitblerje/aktet e zhdoganimit, origjinale ose fotokopje të noterizuar, ose cdo lloj akti tjetër ligjor që vërteton pronësinë ose kontratë qeraje të noterizuar). Për makineritë me qera duhet të përgatitet kontrata e qerasë e lidhur para noterit, me afat për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt prokurimi, e shoqëruar me dokumentacionin që vërteton pronësinë e qeradhënësit (fatura tatimore ose zhdoganimi ose cdo lloj tjetër ligjor që vërteton pronësinë e qeradhënësit).

(Në rastin kur OE pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi nuk është prodhues i artikujve, atëherë duhet të paraqesë dokumentacionin për këto pajisje nga prodhuesi i cili ka marrë autorizimin përkatës për tregtimin e tyre).

Përsa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.”

III.6.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.6.4. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.*

III.6.5. Në neni 77, pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ndryshuar parashikon shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

[...]

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.6.6. Në nenin 40 “Kërkesat e veçanta për kontratat e mallrave”, pika 5/ç, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

[...]

5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit. [...]

III.6.7. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.6.8. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, konstatohet se në pikën pika 2.4.6 e “Kapacitetit teknik” autoriteti kontraktor ka kërkuar që *“Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qera këto pajisje 1 (një) makineri qëndisje; 1 (një) linjë stampimi me serigrafi (makineri stampimi, furrë tharje stampimi dhe presë për ngjritjen e logove)...”,* ndërsa pas ankesës së operatorit ekonomik ankimues, autoriteti kontraktor në aktin e trajtimit të ankesës deklaroi se do të modifikojë këtë kriter, si më poshtë: *“Operatori ekonomik ofertues/ prodhues i uniformave duhet të ketë në pronësi ose me qera këto pajisje:*

- ☐ 1 (një) makineri qëndisje;
- ☐ 1 (një) linjë stampimi me serigrafi (makineri stampimi, furrë tharje stampimi dhe presë për ngjritjen e logove)

[...]

(Në rastin kur OE pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi nuk është prodhues i artikujve, atëherë duhet të paraqesë dokumentacionin për këto pajisje nga prodhuesi i cili ka marrë autorizimin përkatës për tregtimin e tyre). ”

Sa më sipër, konstatohet se autoriteti kontraktor, ka pranuar të modifikojë kriterin si më sipër, por nisur nga pretendimet e ankimuesit në ankesën e tij, konstatohet se ky modifikim nuk është në përputhje me atë që operatori ekonomik ankimues ka kërkuar në ankesën e tij.

Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, gjykojmë se kërkesa e mësipërme është një kërkesë e ekzagjeruar e cila kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi, të cilët furnizohen me produkte të gatshme nga prodhues të tjerë të artikujve objekt prokurimi.

Referuar objektit të prokurimit, nga ana e autoritetit kontraktor kërkohet furnizimi me Uniforma Zjarrduruese, pra kërkohet furnizimi me një produkt të gatshëm i cili mund të ofrohet direkt nga një operator ekonomik i cili është prodhues i produktit të kërkuar, por edhe nga operatorë ekonomikë të cilët nuk janë prodhues të produkteve të kërkuara, por janë distributor të autorizuar, të cilët tregëtojnë produkte të gatshme.

Sa më sipër, gjykojmë se, autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt-prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës do të realizojnë me sukses kontratën, por nisur nga objekti i procedurës së prokurimit që kërkohet të realizohet gjykojmë se është një kërkesë kufizuese, kriteri që operatorët ekonomikë *“Në rastin kur OE pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi nuk është prodhues i artikujve, atëherë duhet të paraqesë dokumentacionin për këto pajisje nga prodhuesi i cili ka marrë autorizimin përkatës për tregtimin e tyre”*, pasi një kërkesë e tillë, është diskriminuese dhe që nuk i shërben qëllimit të procedurës së prokurimit, duke kërkuar dokumentacion provues për mjete, për kompani të cilat nuk janë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit si operatorë ekonomikë.

Pra, sa më sipër, operatorët ekonomikë kanë detyrimin për të siguruar cilësinë dhe origjinalitetin e produktit që ofrojnë për procedurën objekt-prokurimi, por nuk duhet kufizuar pjesëmarrja e operatorëve ekonomikë të cilët sigurojnë produktin e gatshëm tek prodhues apo distributori të autorizuar për tregtimin e tij.

Autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë qartë, kërkesën për kualifikim lidhur me disponimin e mjeteve, duke përcaktuar saktë dhe pa krijuar konfuzion, përmbushjen e këtij kriteri nga operatorë ekonomikë pjesëmarrës në procedurë të cilët janë prodhues të artikujve të kërkuar, si dhe nga operatorë ekonomikë që janë importues apo që sigurojnë produktin final tek prodhues të tjerë të autorizuar.

Sa më sipër, autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse, në përputhje me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik.

Për sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, *“Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”*, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Victoria AL” SHPK për procedurën e prokurimit *“Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”*, me Nr. REF-28211-11-05-2024, me objekt Loti 1 *“Uniformë zjarrduruese”*, me fond limit

27,880,050 lekë pa TVSH, parashikuar për t'u zhvilluar më datë 06.12.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.

2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në dokumentet e tenderit sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe sipas pjesës së pranuar nga autoriteti kontraktor në përputhje me vendimmarrjen e KSHA-së, për të cilat është vendosur mbyllja e çështjes, duke publikuar të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
 4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues "Victoria AL" SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fioorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaïd Myzyri